



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. _____/2024

Datë: _____/2024

RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE

Klinë, dhjetor 2024

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 11, 12.2 shkronja c), dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja a) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, dispozitat e nenit 2,3, 8 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-049 publikuar në Gazetën Zyrtare nr.27/2008, dispozitat e nenit 10 pika 1 të Statutit të Komunës së Klinës nr.01-110-1232/2010 i miratuar më dt. 31.03.2010, me rekomandimin e KPF-së si dhe dispozitat e Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për Procedurën, Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunës, si dhe sipas kërkesës për rishqyrtim- shkresa me Nr. VL 198-24 e Agjencionit Kadastral Kuvendi i Komunës në seancën XI-të të rregullt të mbajtur më datë: 20.12.2024, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Klinës (këtu e tutje “Komuna”), lartësinë e taksave komunale, përcaktimin e kategorive të liruara nga kjo taksë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdoruar në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. **Taksë komunale** – nënkupton shumën fikse dhe e pakthyeshme e pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridikë dhe fizikë autoriteteve të Komunës në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të:

1.1.1. Lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve tjera zyrtare të lëshuara nga Komuna;

1.1.2. Shërbimeve administrative të pranuar nga Komuna;

1.1.3. Ushtrimit të veprimtarisë afariste në territorin e Komunës;

1.1.4. Pronësisë së mjeteve motorike në territorin e Komunës;

1.1.5. Ndërtimit, rrënimit të objekteve dhe ndërhyrjeve në infrastrukturë komunale në territorin e Komunës; dhe

1.1.6. Shfrytëzimit të objekteve, hapësirës apo të mirave tjera publike në territorin e Komunës.

1.2. **Taksa qendrore** – nënkupton taksat që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës të cilat mbliidhen nga Komuna;

1.3. **Vit fiskal** - nënkupton periudhën nga data një (1) janar deri më datën tridhjetë e një (31) janar të të njëjtit vit.

1.4. **Gjobë** – nënkupton sanksionin kundërvajtës që i shqiptohet personave juridikë dhe fizikë për shkelje të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

1.5. **Person** – nënkupton personin fizik dhe juridik;

1.6. **Person fizik** – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi; dhe personi fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist.

1.7. **Person juridik** – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë.

1.8. **Pano reklamuese** – nënkupton tabelën apo shenjën reklamuese me qëllim të reklamimit të mallrave apo shërbimeve, i vendosur në një objekt statik apo lëvizës; dhe

1.9. **Shoqëri Tregtare** – nënkupton termin e përgjithshëm që përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo ndonjë ligji tjetër, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

KAPITULLI II

KORNIZAT E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE KOMUNALE

Neni 4

Parimet e përgjithshme të taksave komunale në Komunë

1. Të gjitha taksat komunale përcaktohen me këtë Rregullore dhe me ndonjë Rregullore tjetër komunale.

2. Të gjitha taksat komunale përcaktohen duke marrë parasysh parimin e jo diskriminimit dhe të proporcionalitetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Taksat komunale që rezultojnë si pasojë e ndonjë veprimi apo shërbimi të kryer nga organet e Komunës, bazohen në koston e atij veprimi që i është shkaktuar Komunës.
4. Asnjë taksë komunale që nuk është e përcaktuar me këtë Rregullore apo në ndonjë Rregullore tjetër komunale nuk mund të kërkohej që të paguhet.

Neni 5

Pagesa e taksave komunale

1. Të gjitha pagesat e taksave komunale që duhet të kryhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe paguhen në valutën euro (€).
2. Të gjitha pagesat mbi dhjetë (10 €) euro sipas kësaj Rregulloreje bëhen nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare të licencuara, nëpërmjet një urdhërpagese të pranuar nga zyrtari përkatës komunal, në xhirollogarinë e Komunës të përcaktuar vendimin e Kryetarit të Komunës.
3. Të gjitha pagesat deri në dhjetë (10 €) euro sipas kësaj Rregulloreje bëhen pranë institucioneve përkatëse komunale.
4. Për pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni, Komuna lëshon vërtetim përkatës.
5. Të gjitha pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni dhe pagesat e bëra nëpërmjet kioskave elektronike (e-kiosku), deponohen në xhirollogarinë e Komunës deri në fund të ditës së pranimit.

Neni 6

Lirimet nga taksat komunale

1. Të gjitha kategoritë e liruar nga pagesa e taksave komunale sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, përcaktohen me këtë Rregullore.
2. Për çdo lloj lirimi nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore, personat që përfitojnë nga ky lirim ofrojnë dokumentacionin përkatës që dëshmon përkatësinë e tyre për të përfituar nga lirimet.
3. Për çdo lloj lirimi nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore, zyrtari përgjegjës i Komunës ia bashkëngjit lëndës shkresën me bazën ligjore për lirim nga pagesa.
4. Nëse ndonjë procedurë ku kërkohej pagesa e taksave komunale është filluar me kërkesë të më shumë se një personi, ku jo të gjithë janë të liruar nga pagesa e taksave komunale, atëherë taksa komunale paguhet nga ai person i cili nuk është i liruar nga pagesa.

5. Dokumentacioni që lëshohet për përdorim në botën e jashtme nuk lirohet nga pagesa e ngarkesave, tarifave dhe taksave komunale nga kjo rregullore.

KAPITULLI III

DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 7

Dënimet mandatore, kundërvajtjet administrative, gjobat dhe masat tjera mbrojtëse

1. Disa nga veprimet në kundërshtim me ligjin dhe këtë rregullore, konsiderohen kundërvajtje, kjo në bazë të bazë të parimit ligjor-legalitetit: se askush nuk mund të jetë përgjegjës për kundërvajtje dhe as që mund t'i shqiptohet dënim përkatës nëse më parë vepra e kryer nuk ka qenë me ligj apo me akt tjetër normativ e paraparë si kundërvajtje.
2. Varësisht nga kundërvajtja e kryer të pandehurit do t'i shqiptohen ndëshkimet adekuate kundërvajtëse sipas Ligjit për Kundërvajtje.
3. Lidhur me kundërvajtjet e kryera, inspektori kompetent komunal apo organi tjetër i autorizuar komunal mund të iniciojë procedurën përkatëse kundërvajtëse, me paraqitjen e kërkesës përkatëse tek gjykata kompetente që shqyrton çështjet kundërvajtëse apo gjykata tjetër me kompetencë reale dhe territoriale.
4. Varësisht nga rastet konkrete subjekteve afariste dhe personave të tjerë mund t'iu shqiptohen ndëshkimet përkatëse kundërvajtëse, duke përfshirë ndëshkimet kundërvajtëse administrative dhe gjobat si dhe masat tjera mbrojtëse për shkeljen e dispozitave të ligjit dhe kësaj rregulloreje.

Neni 8

Dënimet mandatore

1. Dënimet mandatore, përkatësisht gjobat janë masa ndëshkimore, të cilat mund t'i shqiptojë inspektori kompetent komunal apo organi tjetër i autorizuar, varësisht nga rasti të cilat iu shqiptohen të gjithë obliguesve të ngarkesave, tarifave dhe taksës e të cilët nuk i përmbushin obligimet përkatëse rreth pagesës adekuate të përcaktuar sipas kësaj rregulloreje.
2. Për eksploatim të egër (të pa ligjshëm) të zhavorrit, eksploatuesi jolegal gjobitet prej 20 € deri në 30 € për Im^3 të zhavorrit të eksploatuar, varësisht nga recidivizmi.
3. Nëse personi fizik apo juridik haset nga inspekcioni duke eksploatuar pa leje apo eksportuar zhavorr apo rërë dhe i cili nuk posedon dokumentacionin përkatës, i shqiptohet dënimi mandator sipas paragrafit 2 të këtij neni ashtu që zhavorri-rëra i konfiskohet. Ndërkaq nëse personi i tillë nuk e paguan dënimin mandator, po ashtu, zhavorri-rëra i konfiskohet dhe lënda më tej me fletëparaqitje përkatëse i dërgohet Gjykatës Themelore kompetente për vendosje të mëtejme meritore gjyqësore.

4. Ndotësit e ujërave të lumenjve, subjektet juridike ose fizike gjobiten në shumën prej 20 € deri në 25 €, varësisht nga masa e ndotjes dhe recidivizmi.
5. Për shfrytëzimin e panevojshëm dhe ilegal të ujit të pijshëm që përdoret për qëllime të pastrimit, rrugëve, trotuareve, oborreve, për ujitje të kopshteve, fushave, pemëve etj., përcaktohet gjoba në lartësi prej 25€ .
6. Lartësia e gjobës është dyfishi i tarifës dhe ngarkesës së përcaktuar për kryerjen e shërbimit përkatës, nëse ndryshe nuk përcaktohet me ligjin e veçantë.
7. Të gjitha limitet e dënimeve mandatore apo gjobave nga kjo dispozitë zbatohen drejtpërsëdrejti, të ndryshuara nga të lartëcekurat, nëse ato janë të përcaktuara me ligjet e veçanta dhe aktet e tjera të veçanta të pushtetit qendror.
8. Afati për pagesën e të gjitha gjobave apo dënimeve të shqiptuara mandatore nga inspeksioni është 8 (tetë) ditë nga dita e shqiptimit apo në afatin tjetër ligjor të gjykatës nga dita e pranimi të vendimit gjyqësor.
9. Në rast se ndëshkimet apo dënimet nuk paguhen në afatin e paraparë, nga inspektori kompetent inicohet procedura përkatëse pranë gjykatës kompetente.

Neni 9

Dënimet tjera

1. Vazhdimi i ripërtëritjes së lejeve dhe licencave mund të jepet deri më 28 shkurt dhe atë me dënim 20 % në detyrimet dhe ngarkesat e caktuara për leje dhe licenca për veprimtari të cilën e zhvillon.
2. Licencat apo lejet e dërguara për vazhdim pas 28 shkurtit duhet të ngarkohen edhe me dënim shtesë për 5 % në muaj.
3. Shuma e përgjithshme e dënimit për vazhdimin e lejes, licencës nuk mund të kalojë vlerën e dyfishit të tarifës dhe ngarkesës të përcaktuar për kryerjen e atij shërbimi.

Neni 10

Mosrespektimi i afateve të pagesave

1. Në rast të mosrespektimit të afateve, direktivave dhe standardeve të paraqitura të lejeve të veprimtarisë do të zbatohen dispozitat ndëshkuese të ligjeve të veçanta që rregullojnë veprimtaritë e veçanta.
2. Përjashtim nga zbatimi i 3 alineve të kësaj dispozite bën zbatimi i drejtpërdrejtë i ligjeve dhe akteve të veçanta të pushtetit qendror që rregullojnë dënimet përkatëse.
3. Shqiptimi dhe inkasimi i gjobave në trafik si dhe gjobat tjera për shkeljen e rregulloreve komunale bëhet në pajtim me nenin 18 dhe 19 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Neni 11

Ndëshkimet kundërvajtëse

1. Ndëshkimet kundërvajtëse-gjobat i shqipton gjykata kompetente që shqyrton çështjet e kundërvajtjeve, për rastet e shkeljeve të dispozitave përkatëse ligjore të ligjeve të veçanta, që ndërlidhen me tarifa, ngarkesa dhe gjoba, si dhe për shkeljen e dispozitave që ndërlidhen me dispozitat e Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat komunale, krejt këtë mbi bazë të Ligjit për Kundërvajtjet.
2. Nëse shkelen dispozitat e Ligjit për Ndërtimin, shkeljet e tilla përcaktohen në nenin 70 të tij, apo ndryshimet dhe plotësimet e ardhshme. Ndërkaq, nëse shkelen rregullat e tregtisë së brendshme, që ndërlidhen me dispozitat e shitjes së mallrave në ambient të hapur të subjekteve të pa regjistruara, shqiptohen gjobat sipas nenit 12 të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Tregtinë e Brendshme nr.04/L-005.

Neni 12

Masat mbrojtëse

1. Për mosrespektimin e sigurisë publike, pastaj mosrespektimin e standardeve higjienike, si dhe të shkeljes së dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të ligjeve të tjera që përligjojnë çështjet e ngarkesave, tarifave dhe taksave komunale, mund të merren edhe masa mbrojtëse ndaj qytetarëve, personave fizikë dhe personave juridikë që ushtrojnë veprimtaritë përkatëse, krejt kjo në kuptim me ligjet përkatëse.
2. Komuna do të lëshojë një urdhër ndalimi të ushtrimit të veprimtarisë dhe do të bëjë mbylljen e përkohshme të veprimtarive (thertore, mishtore, shtëpi, ambulancë, dyqan ushqimor dhe të gjitha veprimtaritë tjera të kësaj natyre që paraqesin rrezik për shëndetin publik dhe sigurinë standarde) e që janë nën inspektim dhe deri sa testet e nevojshme laboratorike si dhe deri sa të konstatohet se nuk ka rrezik për shëndetin publik.
3. Mosrespektimi i higjienës, shëndetit publik dhe siguria standarde do të jetë arsye dënimi çdo herë dhe minimumi i dënimit do të jetë prej 100 € deri në maksimumin e dënimit prej 200 € varësisht nga shkalla e mosrespektimit.
4. Përfjashtim nga zbatimi i alineve të mëparshme të kësaj dispozite bënë zbatimi i drejtëpërdrejtë i ligjeve të veçanta dhe akteve tjera të veçanta të pushtetit qendror të cilat rregullojnë çështjen e ndëshkimeve kundërvajtëse dhe masave mbrojtëse.

Neni 13

Ankesat dhe mbrojtja juridike

1. Pala mund të ushtrojë ankesë ndaj vendimeve të lëshuara nga organet komunale kompetente, lidhur me tarifat dhe ngarkesat komunale sipas kësaj rregulloreje, krejt këtë në afatin e paraparë ligjor me dispozitat e Ligjit të veçantë dhe Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.
2. Procedura e ankesës duhet të jetë në përputhje me dispozitën e nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

KAPITULLI IV
DREJTORIA E ADMINISTRATËS
TAKSA KOMUNALE PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE DHE DOKUMENTEVE
ZYRTARE

Neni 14

Lartësia dhe pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

1. Të gjithë personat që pajisen me certifikata zyrtare dhe dokumente tjera zyrtare nga Komuna, paguajnë taksë komunale, si në vijim:

Nr. Rendor, tarifa, Përshkrime

Vlera e taksës

1.1.	Certifikata e lindjes	1 €
1.2.	Ekstrakt i lindjes	1 €
1.3.	Certifikata të martesës	1 €
1.4.	Certifikata e vdekjes	1 €
1.5.	Certifikata e shtetësisë	1 €
1.6.	Certifikata e vendbanimit	1 €
1.7.	Certifikata e bashkësisë familjare	2 €
1.8.	Certifikata e statusit martesor	1 €
1.9.	Vërtetim nga arkiva	2 €
1.10	Certifikata për lajmërim ç'lajmërim të vendbanimit	2 €
1.11.	Aktvdekje	3 €
1.12.	Vërtetimi që nuk është i regjistruar në R.TH.L	2 €
1.13,	Procesverbal mbi pranimin e atësisë\amësisë	2 €
1.14.	Deklarata me dy dëshmitarë	2 €
1.15.	Deklarata me kërkesë të autoriteteve të huaja	5 €
1.16.	Regjistrimi i martesave në mes të shtetasve të Kosovës	5 €
1.17.	Regjistrimi i martesave në mes të shtetasve të huaj	30 €

1.18.	Përkthimi gjatë Ceremonisë së martesës	0 €
1.19.	Aktvendim për regjistrim të mëvonshëm në LAL	5 €
1.20.	Aktvendim për korrigjim të emrit dhe mbiemrit	5 €
1.21.	Aktvendim për ndërrim të emrit dhe mbiemrit	20 €
1.22.	Dokumente për kalimin e kufirit vendosja e fotos në certifikatë	2 €
1.23.	Konfirmim dhe vërtetime tjera të Gjendjes Civile	3 €
1.24.	Konfirmim i nacionalitetit apo identitetit	4 €
1.25.	Ndërrimi i mbiemrit pas shkurorezimit të martesës	4 €
1.26.	Vërtetim për lirim nga shtetësia në Z.GJ.C	5 €
1.27.	Regjistrimi i mëvonshëm i lindjes sipas ligjit të Gj.C. neni 63	25€
1.28.	Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjes sipas ligjit të Gj.C. neni 63	55€
1.29.	Varrimi pa leje i organit kompetent	20 €
1.30.	Procedura e kurorëzimit në objekt të komunës, jashtë orarit të punës	20 €
1.31.	Procedura e kurorëzimit jashtë objektit të komunës, gjatë orarit të punës	40 €
1.32.	Procedura e kurorëzimit jashtë objektit të komunës dhe jashtë orarit të punës	50 €
1.33.	Vërtetim që personi nuk është banor i komunës	1 €
1.34.	Ndryshimi i emrit personal	5 €
1.35.	Korrigjimi emrit personal (germëzimi)	3 €
1.36.	Vërtetimi që personi nuk është në marrëdhënie pune	1 €
1.37.	Vërtetimi për gjendjen ekonomike	1 €
1.38.	Vërtetim për afërsinë familjare	1 €
1.39.	Vërtetim mbi marrëdhëniet familjare	1 €

2. Pagesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të certifikatës apo dokumenteve zyrtare.

2.1. Pa dëshmi të pagesës nuk mund të dorëzohet kërkesa apo të merret certifikata apo dokumenti zyrtar.

3. Për pagesat e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni, Komuna lëshon dëshmi përkatëse dhe kjo dëshmi është e vlefshme brenda gjithë vitit fiskal, në rast se kërkesa për marrje të certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nuk mund të dorëzohet pas pagesës së taksës.

Neni 15
Lartësia dhe pagesa e taksave komunale administrative

1. Të gjithë personat që pranojnë shërbime të caktuara komunale nga Komuna të paraparë në këtë nen, paguajnë taksë komunale administrative, si në vijim:

1.1.	Parashtresat dhe propozimet	0,0.€
2.	Certifikata për shtesa fëminore	5 €
3.	Vendqëndrimi	5 €
4.	Kërkesë për të gjitha veprimet administrative	1 €
5.	Vendime apo Aktvendime	2 €
6.	Pëlqimi	1.5 €
7.	Referencat për operatorët ekonomikë	5 €
8.	Certifikatat për gjendjen ekonomike	1.5 €
9.	Vërtetimi i përshkrimit nga Libri	5 €
10.	Vërtetimi i origjinalit për një faqe, formati A-4	1 €
11.	Vërtetimi i origjinalit për një faqe, formati A-3	1 €
12.	Vërtetimi i dorëshkrimit	1 €
13.	Certifikata mbi mjetet për jetesë, mbajtja e prindërve për një person	5 €
14.	Certifikata mbi mjetet për jetesë, mbajtja e prindërve për dy prindërit	10 €
15.	Vërtetim i deklaratës së dëshmitarëve	1 €
16.	Kërkesa për shpenzimet e varrimit	1 €
17.	Përpilimi i garancionit për ardhjen e mysafirëve	5 €
18.	Vërtetimi dhe dokumentet tjera zyrtare	1 €
19.	Certifikata që është në jetë, që vjinë nga bota e jashtme	5 €

2. Pagesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të shërbimit komunal dhe pa dëshmi të pagesës nuk ofrohet shërbimi.

3. Kërkesat në emër të Këshillave (kryetarëve) të Bashkësive Lokale, fshatrave apo lagjeve urbane lirohen nga pagesa e taksës administrative nga nënparagrafi 1.1. i nenit 10.

Neni 16 **Detyrimi lidhur me të dhënat**

1. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen me certifikatat e parapara nga neni 14 dhe 15 i kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë të dhënat lidhur me regjistrin civil me kohë dhe t'i përditësojnë ato brenda afatit të përcaktuar ligjor.
2. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen me vërtetimet e parapara nga neni 14 dhe 15 i kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë informata të sakta lidhur me gjendjen përkatëse për të cilën pajisen me vërtetim.

KAPITULLI V **TAKSAT KOMUNALE ADMINISTRATIVE**

Neni 17 **Lirimet nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare**

1. Nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare janë të liruar kategoritë si në vijim:
 - 1.1. Veteranët e luftës – bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së – bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.3. Familjarët e dëshmorëve të luftës – bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.4. Familjarët e të zhdukurve të luftës - bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.5. Familjarët e viktimave civile të luftës (martirëve) - bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.6. Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës;
 - 1.7. Personat e verbër;
 - 1.8. Personat paraplegjik dhe tetraplegjik (me aftësi të kufizuara); dhe
 - 1.9. Përfituesit e skemave sociale (dëshmi kartoni i socialit- valid).
2. Lirimi nga alineja e mësipërme bëhet vetëm sa i përket nxjerrjes dhe rregullimit të dokumentacionit që ka të bëjë me çështjet e invaliditetit dhe pensioneve përkatëse nga kategoria të cilës i takon parashtruesi i kërkesës apo anëtari i familjes së ngushtë të tij, si dhe dokumentacionit që ka të bëjë me shkollimin e obliguar prej atij parafillor dhe deri në shkallën IX (nëntë) të përgatitjes shkollore apo shkallës tjetër që lejohet sipas ligjit përkatës.

3. Dokumentacioni që lëshohet për përdorim në botën e jashtme nuk lirohet nga pagesa e ngarkesave, tarifave dhe taksave komunale nga kjo rregullore.

KAPITULLI VI

DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

TAKSA KOMUNALE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË AFARISTE

Neni 18

Lartësia dhe pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) që ndodhet brenda teritorit të Komunës, paguan taksë vjetore komunale në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste profesionale, për aktivitet ekonomike të zhvilluar si në vijim:

1. kategoria A:

	Kategoria A	
2.1.	Bankat	400 €
2.2.	Hotelet	400 €
2.3.	Shtëpitë	400 €
2.4.	Kompanitë e sigurimeve	400 €
2.5.	Minierat	400 €
2.6.	Përfaqësitë e ndërmarrjeve të jashtme	400 €
2.7.	Industria mekanike, metarulgjike dhe kimike	400 €
2.8.	PTK, KEK-u, kompanitë e rrjetit kabllovik dhe ajror të interneteve si dhe degët e tyre,	400 €
2.9.	Qendrat tregtare	400 €

1. Kategoria B

	Kategoria B	320 €
3.1.	Motelet	320 €
3.2.	Gurëthyesit	320 €
3.3.	Depot me shumicë	320 €
3.4.	Ndërmarrjet tregtare me shumicë	320 €
3.5.	Ndërmerrjet publike (ndërmarrjet e ujit dhe mbeturinave)	320 €
3.6.	Shpedicionet	320 €
3.7.	Ndërmarrjet prodhuese të llageve, ngjitësit	320 €
3.8.	Restorantet-pishina	320 €
3.9.	Veprimtaria për thyerje të gurit-dhënien e formës dhe finicionin	320 €
3.10.	Pompat e karburanteve në qytetin e Klinës	240 €
3.11.	Pompat e karburanteve në dalje të qytetit të Klinës në drejtim të Skenderajt	240 €
3.12.	Pompat e karburanteve në dalje të qytetit të Klinës në drejtim të Istogut	240 €
3.13.	Pompat e karburanteve prej qytetit të Klinës deri të magjistrallja Pejë-Prishtinë-Gjakovë	320 €

3.14.	Pompat e karburanteve në viset rurale	150 €
-------	---------------------------------------	-------

2. Kategoria C

	Kategoria C	
4.1.	Veprimtaria e shitjes së tepihëve dhe perdeve	160 €
4.2.	Agjencitë turistike	160 €
4.3.	Ndërmarrjet projektuese	160 €
4.4.	Ndërmarrjet botuese dhe grafike	160 €
4.5.	Vetëshërbimet e mëdha, supermarketet, shtëpitë e mallrave	160 €
4.6.	Ndërmarrjet ndërtimore	160 €
4.7.	Poliklinikat shëndetësore	160 €
4.8.	Fabrikat e përpunimit të miellit	160 €
4.9.	Ndërmarrjet turistike	160 €
4.10.	Ndërmarrjet që merren me përpunimin e drurit dhe plastikës (dyer, dritare, panove reklamuese)	160 €
4.11.	Ndërmarrjet për servisimin e automjeteve	160 €
4.12.	Restorantet	160 €
4.13.	Tregtia me pakicë e kompjuterëve dhe pajisjeve të TI	160 €
4.14.	Tregtia e pajisjeve sanitare	160 €
4.15.	Tregtia me pakicë e mobileve	160 €
4.16.	Veprimtaritë për dhënien e automobilitave me qira	160 €
4.17.	Tregtia me pakicë e teknikës së bardhë	160 €
4.18.	Tregtia me pakicë e artikujve të imtë e ngjyrave, llaqeve dhe materialeve të tjera të sanitarisë së ujit dhe të rrymës	160 €

3. Kategoria D

	Kategoria D	100 €
5.1.	Barnatoret bujqësore	100 €
	Barnatoret shëndetësore	100 €
	Dyqanet në qendër të qytetit (Zona e parë),	100 €
	Butikët	100 €
	Lokalet ushqimore, furrat e bukës	100 €
	Argjendaritë	100 €
	Mishshitësit	100 €
	Auto-transportuesit	100 €
	Filialet e agjencive turistike dhe njësitë e ndërmarrjeve turistike	100 €
	Auto-shkollat	100 €
	Bujtinat	100 €
	Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve të tjerë të lëkurës	100 €

4. Kategoria E

	Kategoria E	
6.1.	Rrobaqepësit	80 €
6.2.	Salduesit	80 €

6.3.	Floktaret, berberët	80 €
6.4.	Fotografët	80 €
6.5.	Orëtarët	80 €
6.6.	Internet-kafetë, video-klubet, RTV mekanikët, radiot private, dyqanet në periferi (Zona II)	80 €
6.7.	Kombibusët	80 €
6.8.	Auto-parkingjet	80 €
6.9.	Gjellëtoret, qebaptoret, çajtoret	80 €
6.10.	Autolarjet	80 €
6.11.	Tregtia me pakicë të mjeteve për traktorë dhe mjeteve tjera bujqësore, veprimtaritë e veterinars	80 €
6.12.	Bilardot	80 €
6.13.	Fotokopjet	80 €
6.14.	Servisimi i telefonave apo kompjuterëve	80 €

5. Kategoria F

	Kategoria F	
7.1.	Kioskat në qytet (Zona e parë dhe e dytë)	40 €
7.2.	Dyqanet në zonat rurale që nuk kanë qasje në rrugët regjionale	40 €
7.3.	Veprimtaritë e imëta të biznesit dhe auto-taksitë	40 €
7.4.	Veprimtaria për shitjen e kurorave, funeraleve dhe luleve	40 €
7.5.	Fitneset, veprimtaritë e ndryshme sportive	40 €
7.6.	Shërbimet postare-telefonike	40 €
7.7.	Shtypshkronja dhe shtypshkrime tjera	40 €

Neni 19

Pagesa e taksave, tarifave dhe ngarkesave komunale

1. Taksat tarifore vjetore sipas kategorive të veprimtarive paguhen lidhur me ushtrimin e veprimtarive afariste përkatëse.
2. Subjektet afariste të cilat veprimtarinë e tyre e zhvillojnë më tepër se në një lokal jashtë selisë paguajnë 50 % të taksës së përcaktuar të secilit lokal veç e veç.
3. Taksa për shërbime administrative me rastin e regjistrimit të bizneseve nuk paguhet. Nëse në ndërkohë këto veprime rregullohen me udhëzim të veçantë nga ministria kompetente, vlejnë drejtpërsëdrejti dispozitat e Udhëzimit të veçantë administrativ, (neni 8 i Ligjit nr.04/L-006 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare).
4. Bizneset dhe veprimtaritë e reja që regjistrohen për herë të parë, lidhur me ushtrimin e veprimtarive përkatëse, lirohen nga pagesa e ngarkesave, taksave tarifore në kohëzgjatje prej 18 muajve nga data e regjistrimit fillestar.
5. Ndërmarrjet prodhuese lirohen nga taksa për shërbime për 5 vitet e para të regjistrimit.

6. Afati i ushtrimit të ankesave ndaj aktvendimeve të këtyre taksave caktohet prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në përputhshmeri me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithëshme Administrative.
7. Si prova formale Drejtoria përkatëse duhet të pranojë vërtetimin e shlyerjes së biznesit.

Neni 20

Ushtrimi i veprimtarive intelektuale private dhe taksat tarifore vjetore

1. Për ushtrimin e veprimtarive intelektuale profesionale paguhet taksa tarifore vjetore sipas kategorive përkatëse.
2. Ushtrimi i veprimtarive intelektuale profesionale bëhet sipas standardeve të vërtetuara dhe dëshmive kualifikuese dhe përgatitjes profesionale të lëshuara dhe të legalizuara nga organet kompetente shtetërore.
3. Tarifat vjetore janë renditur sipas llojeve të veprimtarive private profesionale:

3.1.	Shkolla private	120 €
3.2.	Avokatët	120 €
3.3.	Stomatologët	120 €
3.4.	Mjekët e specializuar	160 €
3.5.	Mjeku i praktikës së përgjithshme	80 €
3.6.	Këmbimore e valutave	120 €
3.7.	Kontrollimi teknik i automjeteve	120 €
3.8.	Zyret projektuese	120 €
3.9.	Kontabilistët	100 €
3.10.	Auditorët	100 €
3.11.	Përkthyesit	80 €
3.12.	Veprimtaria e pavarur veterinerë	80 €
3.13.	Tregtia me pakicë e videove dhe CD	80 €
3.14.	Këngëtarët(live)	80 €
3.15.	Kurset profesionale	80 €
3.16.	Motrat medicinale	40 €
3.17.	Këngëtarët (Dj)	40 €
3.18.	Veprimtaritë tjera	80 €
3.19.	Noterët	120 €
3.20.	Përmbauesit privat	120 €
3.21.	Ueb -portalet	150 €
3.22.	Aktivitetet e programimit dhe transmetimit televiziv	200 €

4. Komuna i dërgon faturat për pagesën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste shoqërive tregtare më së largu deri më tridhjetenjë (31) mars të vitit aktual. Nëse komuna nuk ka arritur të dorëzojë faturën brenda këtij afati, obligohen shoqëritë tregtare ta kërkojnë faturën nga Komuna.

5. Shoqëritë tregtare e paguajnë taksën vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste deri më pesëmbëdhjetë (15) dhjetor të vitit aktual fiskal.

6. Taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste përcaktohet në bazë të aktivitetit kryesor të regjistruar në ARBK.

Neni 21

Pagesa e pjesshme e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Në qoftë se shoqëria tregtare është shuar gjatë vitit fiskal, pagesën e taksës komunale e bën si në vijim:

1.1. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data një (1) janar deri më datën tridhjetenjë (31) mars të vitit fiskal, paguan tridhjetë (30 %) për qind të vlerës së taksës;

1.2. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data (31) mars deri më datën tridhjetenjë (31) gusht të vitit fiskal, paguan shtatëdhjetë (70 %) për qind të vlerës së taksës; dhe

1.3. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data (31) gusht deri në datën tridhjetë (30) nëntor të vitit fiskal, paguan nëntëdhjetë (90 %) për qind të vlerës së taksës; dhe

1.4. Nëse shoqëria tregtare është shuar pas datës tridhjetë (30) nëntor të vitit fiskal, paguan taksën e plotë.

2. Shoqëritë tregtare të regjistruara në territorin e Komunës që kryejnë veprimtari në dy (2) apo më shumë njësi, për çdo njësi tjetër paguajnë vlerën prej pesëdhjetë (50%) për qind të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

3. Shoqëritë tregtare që gjatë vitit fiskal kanë qenë pasive dhe nuk kanë ushtruar veprimtari, paguajnë pesëdhjetë (50%) për qind të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

4. Me qëllim të zbatimit të paragrafëve 1 deri në 3 të këtij neni, përfaqësuesit e shoqërive tregtare duhet t'i ofrojnë Komunës dëshmi përkatëse Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe/apo nga institucionet tjera përkatëse.

5. Shoqëritë tregtare që janë të regjistruara jashtë territorit të Komunës, për çdo njësi që vepron në territorin e Komunës paguajnë vlerën e plotë të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

Neni 22

Të hyrat tjera vetanake komunale

Të hyrat tjera vetanake të autorizuar në bazë të kësaj Rregulloreje nuk janë gjithëpërfshirëse. Komuna mund të mbledhë edhe të hyra të tjera përmes tarifave dhe taksave përkatëse komunale,

të cilat mund të lejohen me ndonjë ligj tjetër apo edhe në bazë të marrëveshjes me autoritetet qendrore.

Neni 23

Lirimet nga taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare në vitin e parë të themelimit/regjistrimit të saj, pa marrë parasysh datën e regjistrimit/themelimit, lirohet nga pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

2. Nga pagesat e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste janë të liruara kategoritë si në vijim:

2.1. Bashkësitë fetare, në ushtrimin e aktivitetit ekonomik për vetëqëndrueshmëri financiare; dhe

2.2. Organizatat jo qeveritare të angazhuara në aktivitet ekonomik me qëllim të mbështetjes së aktivitetit të saj jofitimprurës.

2.3. Përfshihen nga pika 2.2 organizatat joqeveritare të cilat japin kredi me kamata fitimprurëse (institucionet mikrofinanciare).

KAPITULLI VII TAKSA KOMUNALE MBI MJETET MOTORIKE

Neni 24

Lartësia dhe pagesa e taksës komunale mbi mjetet motorike

1. Çdo person fizik i cili është banor i Komunës dhe **ka në pronësi** mjet motorik dhe çdo person juridik që ka seli në Komunë dhe ka në pronësi mjet motorik, paguan taksën vjetore mbi pronësinë e mjetit motorik, si në vijim :

1.2.	Mjete motorike me 2 deri në 4 rrota deri në 50 cmm	10 €
1.3.	Automobil për udhëtarë deri në 3 ton	10 €
1.4.	Automobil për udhëtarë mbi 3 ton	20 €
1.5.	Kamionët deri në 3.5 ton	10 €
1.6.	Kamionët mbi në 3.5 ton	20 €
1.7.	Kombibusë dhe autobusë për transportim të udhëtarëve deri në 30 ulëse	10 €
1.8.	Autobusë për transportim të udhëtarëve mbi 30 ulëse	35 €

2. Personat e përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij neni, taksën e paguajnë para regjistrimit të mjetit motorik sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 25

Lirimet nga taksa komunale mbi mjetet motorike

1. Nga pagesa e takës komunale mbi mjetet motorike janë të liruara mjetet motorike në pronësi të:

- 1.1. Institucioneve publike të Republikës së Kosovës;
- 1.2. Institucioneve ndërkombëtare dhe përfaqësitë diplomatike, përfshirë edhe stafin e huaj;
- 1.3. Kryqit të Kuq të Kosovës;
- 1.4. Emergjencës (makinat e zjarrfikësve, të ndihmës së shpejtë, si dhe makinat e komunitetit fetar për shërbesa fetare),
- 1.5. Të invalidëve të luftës, civilë dhe ushtarakë.
2. Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit apo dokumenti tjetër që dëshmon pronësinë.

Neni 26

Koha e ripërtëritjes së ngarkesave dhe taksave

1. Të gjitha ngarkesat dhe taksat për ushtrimin e veprimtarive komerciale, profesionale, duhet të ripërtërihen për çdo vit deri më 31 janar.
2. Lejet e automjeteve nëse janë në kompetencë të komunës ripërtërihen me rastin e regjistrimit, sipas ligjit përkatës pozitiv dhe urdhëresave përkatëse të ministrisë së linjës kompetente.
3. Afati i pagesës së taksave komunale caktohet 1(një) vit me të drejtë të ripërtëritjes.
4. Data e marrjes së taksës sipas aktvendimit të Drejtorisë kompetente vlenë deri në përmbushje të afatit njëvjeçar.

KAPITULLI VII

DREJTORIA E KADASTRËS, PRONËSISË DHE GJEODEZISË

Neni 27

Taksat në Drejtorinë e Kadastrës, Pronësisë dhe Gjeodezisë

1. Në Drejtorinë për Kadastrë, Pronësi dhe Gjeodezi aplikohen taksa dhe tarifa duke u bazuar në:
 1. Udhezimi Administrativ (Qrk)Nr.04/2024 për Tarifa, për Produkte Sherbime Kadastrale Gjeodezike dhe regjistrimin të Pronave.
 2. Vendimi i zv. Drejtor Ekzekutiv në AKK Avni Ahmeti, për Caktimin e Listes së Produkteve dhe sherbimve të cilat ofrohen Zyra Kadastrale Komunale Nr.53/2024 i dates 02.08.2024.

KAPITULLI VIII
DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Neni 28

Taksat komunale nga lëmi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

1. Për shfrytëzimin e objekteve të sportit paguhen taksat tarifore dhe atë siç vijon:

1.1.	Lirohen nga tarifa partit politike të cilat shfrytëzojnë sallën sportive për aktivitete politike.	0 €
1.2.	Hapësira e parkingut te Palestra Sportive që shfrytëzohet nga autoshkollat për praktikë me kandidatë, pagesë vjetore	150 €
1.3.	Shfrytëzimi i fushës së futbollit “18 Qershori” nga klubet sportive (shkollat private) që aktivitetet e tyre i ushtrojnë në Komunën e Klinës por kanë të hyra direkte, pagesë mujore	20 €
1.4.	Shfrytëzimi i fushës së futbollit “18 Qershori” dhe fushën ndihmëse nga klubet sportive (që nuk janë të Komunës së Klinës por për shkaqe të ndryshme janë të interesuar ta shfrytëzojnë stadiumin) pagesë për një ndeshje	15 €
1.5.	Organizimet e turneve sportive që nuk janë organizime të komunës – Tarifa ditore	15 €
	Klubet sportive publike që janë të regjistruara si të tilla në federatë lirohen nga pagesa	

2. Për shfrytëzimin e objekteve të kulturës, Bibliotekës komunale publike, si dhe anëtarësimin përkatës caktohen taksat tarifore vjetore, siç vijojnë:

2.1.	Anëtarësimi i nxënësve të shkollave fillore caktohet taksa tarifore vjetore	1.50 €
-------------	--	---------------

2.2.	Anëtarësimi i nxënësve të shkollave të mesme caktohet taksa tarifore vjetore	2 €
2.3.	Anëtarësimi për studentë caktohet taksa tarifore vjetore	3 €
2.4.	Anëtarësimi për qytetarë caktohet taksa tarifore vjetore	6 €

3. Për shfrytëzimin e objektit të Qendrës së Kulturës “Jehona e Dukagjinit” caktohen tarifatat dhe taksat si në vijim:

3.1.	Për tubime politike	0
3.2.	Për shfaqje të ndryshme si: filma, koncerte, shfaqje të tjera teatrale etj, caktohet tarifa 20% e çmimit të tërësishëm të biletave të shitura	20% e çmimit të tërësishëm të biletave të shitura
3.3.	Për aktivitete të tjera caktohet tarifa për një orë	20 €
	Holli i Galerisë që shfrytëzohet për ekspozita personale kur nuk janë bashkëpunim me komunën	20 €

3.4. Tarifatat e taksat e mësipërme nuk i referohen tubimeve përkatëse mortore, takimeve që organizohen nga kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, si dhe takimet tjera që organizohen për nevoja publike të Komunës.

Neni 29

Taksat tarifore për shfrytëzimin e shërbimeve nga Arkivi historik

4. Për kryerjen e shërbimeve administrative të fotokopjimit dhe ekstraktet e dokumenteve që nxirren nga arkivi historik caktohen tarifatat dhe taksat, si në vijim:

1.1. Lëshimi i certifikatave apo vërtetimeve të ndryshme.....2,00 €.

1.2. Tarifatat dhe taksat për shërbimet e fotokopjimit sipas faqeve dhe formatit caktohen si në vijim:

1.2.1. Fotokopjimi i dokumenteve:

4.2.2. Një faqe A4.....0.10 €;

4.2.3. Një faqe A3.....0.20 €;

4.2.4. Një faqe A0.....1.00 €.

1.3. Kërkesat për nevoja personale fizike:

1.3.1. Një faqe A4.....0.80 €;

1.3.2. Një faqe A3.....1.00 €;

1.3.3. Një faqe A0.....2.00 €.

1.4.Për institucionet:

- 1.4.1. Një faqe A4.....1.00 €;
- 1.4.2. Një faqe A3.....1.50;
- 1.4.3. Një faqe A0.....3.00 €.

1.5. Shtypja e dokumenteve aty ku nuk është i mundur kopjimi caktohet tarifa dhe taksa:

- 1.5.1. Për një faqe.....10.00 €.

- 1.6.Shfrytëzimi i materialit arkivor në procedurë të veçantë të sigurimit, me përcjellje të punëtorit arkivor jashtë arkivit për një ditë caktohet në vlerën prej 15.00 €.

Neni 30**Kategoritë e liruara nga pagesa e tarifave të shërbimeve të kryera nga ana e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport**

- 1. Kategoritë e personave që lirohen nga pagesa e tarifave dhe taksave për shërbimet që kryhen nga DKRS janë:

Familjet e dëshmorëve (paraardhësit apo pasardhësit e drejtpërdrejtë);

Invalidët e luftës;

Veteranët e luftës;

Familjet e viktimave civile (paraardhësit apo pasardhësit e drejtpërdrejtë);

Personat me aftësi të kufizuar, si dhe familjet në asistencë sociale;

Tubimet mortore (shfrytëzimi i sallës së kulturës)

**KAPITULLI IX
DREJTORIA E INSPEKTORATIT****Neni 31****Taksat dhe tarifat e Inspektimit**

- 1. Kërkesa për pëlqim për kushtet minimale teknike – sanitare – higjienike të shoqërive tregtare dhe subjekteve të tjera afariste:

Nr. rendor tarifar	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
1.1	Tarifa për lokalin deri 30 m ²	30 euro
1.2	Tarifa për lokalin mbi 30 m ² deri në 200 m ² nga	1 euro
1.3	Tarifa për lokalin mbi 201 m ² për çdo m ² nga	0.50 euro

Neni 32

Tarifat e inspektimeve tjera komunale në zonat rurale dhe zonat urbane

1. Tarifat e inspektimeve tjera komunale në zonat rurale dhe zonat urbane

Nr. rendor tarifar	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
1.1	Inspektimi i pishinave, autolarjeve dhe serviseve	5 euro
1.2	Inspektimi i furrave gëlqerore, pompave etj	10 euro
1.3	Inspektimi i ndotësve industrial dhe ndotësve të tjerë	10 euro
1.4	Inspektimi me kërkesë të palës jashtë qytetit	8 euro
1.5	Inspektimi me kërkesë të palës në qytet	4 euro
1.6	Lëshimi i vërtetimeve, certifikatave dhe dokumenteve të tjera	0 euro

Neni 33

Inspektimi nga lëmi i ndërtimtarisë

1. Në lëminë e ndërtimtarisë aplikohen këto taksa:

Nr. rendor tarifar	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
1.1	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qytetit për persona fizikë	8 euro
1.2	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për persona fizikë	4 euro

1.3	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qytetit për subjekte afariste dhe institucione të tjera	8 euro
1.4	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për subjekte afariste dhe institucione të tjera	4 euro

Neni 34

Inspektimi nga lëmi i tregut

1. Në lëmin e tregut aplikohen këto taksa:

Nr. rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
1.1	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qytetit për persona fizikë	8 euro
1.2	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për persona fizikë	4 euro
1.3	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qytetit për subjekte afariste dhe institucione të tjera	8 euro
1.4	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për subjekte afariste dhe institucione të tjera	4 euro
1.5	Kërkesa për leje punë	5 euro
1.6	Kërkesa për asgjësim mallrash deri në vlerën prej 10.000 euro	30 euro
1.7	Kërkesa për asgjësim mallrash mbi vlerën prej 10.000 euro	50 euro

Neni 35

Inspektimi nga lëmi i shërbimeve komunale dhe publike

1. Në lëmin e shërbimeve komunale dhe publike aplikohen këto taksa:

Nr. rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
-----------------------	------------	------------------------

1.1	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qytetit për persona fizikë	8 euro
1.2	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për persona fizikë	4 euro
1.3	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qytetit për subjekte afariste dhe institucione tjera	8 euro
1.4	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për subjekte afariste dhe institucione tjera.	4 euro
1.5	Kërkesa për ndalje në terren të PTK-së, KEDS-it jashtë qytetit	100 euro
1.6	Kërkesa për ndalje në terren të PTK-së, KEDS-it në qytet	50 euro

Inspektimi nga lëmi i bujqësisë dhe ambientit

Neni 36

1. Në lëmin e bujqësisë dhe ambientit aplikohen këto taksa:

Nr. rendor tarifor	Përshkrimi	Vlera e taksës në euro
1.1	Kërkesa për kontrollim dhe inspektim nga lëmi i bujqësisë jashtë qytetit për persona fizikë	10 euro
1.2	Kërkesa për kontrollim dhe inspektim nga lëmi i bujqësisë në qytet për persona fizikë	10 euro
1.3	Kërkesa për kontrollim inspektues jashtë qytetit për subjekte afariste dhe institucione të tjera	20 euro
1.4	Kërkesa për kontrollim inspektues në qytet për subjekte afariste dhe institucione të tjera	15 euro
1.5	Parashtresa të tjera	1 euro
1.6	Kërkesa për asgjësim mallrash nga lëmi i bujqësisë dhe ambientit deri në vlerën prej 10.000 euro caktohet taksa prej	30 euro
1.7	Kërkesa për asgjësim mallrash nga lëmi i bujqësisë dhe ambientit mbi vlerën prej 10.000 euro caktohet taksa prej	50 euro

KAPITULLI X DEJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Neni 37

Taksa administrative për dhënien e lejes së ndërtimit, rrënimit dhe taksat tjera në kuadër të DUMM Klinë.

1. Taksa administrative nga pika 1.2.3 dhe 4 është e rregulluar sipas nenit 22 të Ligjit për Ndërtim 04L/110 si dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/18.

1.	Taksa administrative për nxjerrjen e vendimit për leje ndërtimi, Inspektimin e ndërtimit dhe certifikatën e përdorimit për kategorinë II (dy)	3.00€ m ²
2	Taksa administrative për nxjerrjen e vendimit për leje ndërtimi, Inspektimin e ndërtimit dhe certifikatën e përdorimit për kategorinë I (një) brenda zonës Urbane ku mbulohet me plane Urbane :PZHK dhe HZK	2.50€ m ²
3	Taksa administrative për nxjerrjen e vendimit për leje rrënimi për kategorinë I (një) dhe II (dy)	0,70 € m ²
4	Taksa rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës aplikohet vetëm për kategorinë e dytë të ndërtimeve (hapësirat që nuk përdoren për banim përjashtohen nga kjo taksë). Tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform shtojcës 7 të UA Nr. 02/L-2018 – Kjo tarif llogaritet vetëm për njësit e reja të banimit.	198.73€
5	Taksa për shndërrimin e hapësirave të banimit në hapësirë afariste dhe anasjelltas për kategorinë II	3.00€ m ²
6	Taksa për shndërrimin e hapësirave të banimit në hapësirë afariste dhe anasjelltas për kategorinë I	2.40€ m ²
7	Taksa administrative për ndërtimet që maten me m(metër gjatësi) si: muret mbrojtëse, sigurimi i gropës ndërtimore, rrethojave, hapja e kanaleve infrastrukturore dhe të ngjashme.	0.50€ m'
8	Taksa për ndërtimet në formë të siloseve, rezervarëve të ndryshëm dhe të ngjashme	3.00 m ²
9	Taksa për ndërtimin e peizazheve si: ndërtimi i parqeve, kopshteve bulevardeve, shesheve , terreneve sportive, pishinat e hapura, kënde për lojëra të fëmijëve, parkingje të hapura dhe të ngjashme	3.00€ m ²

10	Taksa për rindërtim në objektet ekzistuese si: mbindërtimet, aneks ndërtimet, kulme të shfrytëzuara dhe të ngjashme për kategorinë II propozohet	3.00€ m ²
11	Taksa për rindërtim në objektet ekzistuese si: mbindërtimet, aneks ndërtimet, kulme të shfrytëzuara dhe të ngjashme për kategorinë I	2.40€ m ²
12	Taksa për ndërtimin e objekteve që nuk maten me metër katror do llogariten sipas Udhëzimit Administrativ 02/18 , në bazë të kostos investive	
13	Taksa për lëshimin e kushteve ndërtimore urbanistike aty ku aplikohen	25€ fikse
14	Taksa për dhënien e lejes mjedisore komunale sipas U.A 01/2017	
15	Taksa administrative për nxjerrjen e vendimit për leje ndërtimi, për kategorinë I (një) në fshatra, propozohet: Vërejtje: kjo taksë nuk vlen për objektet e banimit që ndërtohen për treg.	0,50€ m ²
16	Taksa për dhënien e lejes ndërtimore për objekte të përkohshme, Montazh –Kioskë, autolarje,tezka, tarraca dhe të ngjashme	2.40€ m ²
17	Taksa për vendosjen e kabinave telefonike, shkallëve, aparateve të bankave (Bankomatet) billborda, murale dhe të ngjashme mbi 2m ²	2.40 € m ²
18	Taksa për lëshimin e Vërtetimeve, Certifikatave, Konstatimeve dhe procesverbaleve dhe të ngjashme	10 € taks fikse
	Taksa për lëshimin e Vërtetimeve Urbanistike	50 € taks fikse
19	Taksa për lëshuarjen e pëlqimeve komunale	100€ taks fikse
20	Taksa për dhënien e lejes ndërtimore për ndërtimin e objekteve në themelet e vjetra të lirohen për:	50%
21	Taksa për lëshuarjen e referencave	25€ taks fikse
22	Taksa për rregullimin e pronës (parcelës) pas rrënimit të objektit pa leje nga organi kompetent për punët ndërtimore propozohet	0,60 €m ²
23	Taksa për dhënien e vërtetimit, procesverbalit dhe konstatimit mbi gjendjen e vjetërsisë, matjen e sipërfaqes të objekteve dhe të ngjashme	25€ fikse
24	Taksa për pranimin e lëndes, përcjellja e ankesës, prapsemi të lëndes	3€
25	Lirohen nga taksa për leje ndërtimore për: ndërtuesit e stallave për bagëti, objektet për shpezëtari, objektet për ruajtje dhe konservim të	

	frutave dhe perimeve, serrat e ndryshme të cilat ndërtohen me donacione me qëllim zhvillimi ekonomik.	
	Lirimi nga pagesa e taksës dhe tarifës trajtohet edhe me nenin 18 të UA 02/2018, nxjerrë nga MMPH.	
26	Lirohen nga taksa për leje ndërtimore kompanitë publike si “Hidrodrini” dhe kompania “Ambienti”	
27	Vendimi për vazhdimin e lejes së ndërtimit	50€ fikse
28	Vendimi për vazhdimin e kushteve të ndërtimit	25€ fikse

KAPITULLI XI DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 38

Taksat dhe ngarkesat për eksploatimin e resurseve natyrore

1. Veprimtaritë e minierave, gurthyesve dhe eksploatuesve të tjerë të burimeve natyrore, përveç lejes së lëshuar nga Autoriteti qendror kompetent, kërkohet leje e veprimit (operimit) brenda kufijve të Komunës.
2. Taksat e referuara në këtë seksion duhet t’ i paguhen Komunës për dhënien e kësaj leje, në bazë të ripërtëritjes vjetore.
3. Taksat e aplikueshme vjetore janë:

3.1.	Për zhavorr dhe rërë	1 € për m ³
3.2.	Për gurë gëlqerorë pa minim	0.25 € për m ³
3.3.	Për gurë gëlqerorë me minim	0.50 € për m ³
3.4.	Për gurë artizanalë	0.50 € për m ³

4. Sa i përket qirasë së shfrytëzimit të pasurive natyrore, Komuna do të grumbullojë, depozitojë dhe ndajë të hyra në përputhje me dispozitat dhe instruksionet administrative lokale dhe të AQF-së të përmendur më lartë.

Neni 39

Ndërrimi i destinimit dhe kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore

1. Shuma e kompensimit për ndërrimin e destinimit varet nga klasifikimi i tokës sipas klasave, dhe atë si vijon:

1.1.	Klasa I deri në klasën IV, kompensimi do të jetë	1 € për m ²
1.2.	Klasa V deri në klasën VI, kompensimi do të jetë	0.75euro për m ²
1.3.	Klasa VII deri në klasën VIII, kompensimi do të jetë	0.50 € për m ²

2. Taksat për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private:

- 1.1. Dru zjarri për m³ në shumën prej 1,50€
- 1.2. Dru zjarri për mbi 7 m³ në shumën prej 2,00€
- 1.3. Dru teknik për m³ në shumën prej 3,00€

3. Lartësia e taksës për shfrytëzimin e kullotave;

Lloji i Bagëtisë	NB/ kokë	EUR/ kokë
Gjdhët mbi një vjet	1	1.2
Viçat	0.45	0.54
Delet	0.18	0.22
Qengjat	0.1	0.12
Kuajt dhe Gomarët	1	1.20
Dosat	0.5	0.60
Derrat	0.3	0.36
Rosat	0.014	0.02

Neni 40

Taksat tjera tarifore të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

1. Taksat tarifore për qarkullimin e kafshëve të gjalla si dhe certifikatat përkatëse shëndetësore përcaktohen në Udhëzimin Administrativ të MBPZHR nr.17/2005 për Qarkullimin e Kafshëve të gjalla brenda territorit të Kosovës, i cili ka zbatim unik.
2. Taksat tarifore për shërbime të tjera caktohen siç vijojnë:

2.1.	Pëlqimi për licencim të shitjes së plehrave minerale, pesticideve, caktohet taksa tarifore në vlerë prej:	10€
2.2.	Vërtetimi për veprimtari bujqësore, caktohet taksa tarifore në vlerë prej:	5€
2.3.	Vërtetimi për fermerë, caktohet taksa tarifore në vlerë prej:	3€
2.4.	Certifikata e regjistrimit të fermerit në vlerë prej:	2€

3. Sa i përket të hyrave tjera nga lëmi i pylltarisë do të vlejnjë taksat tarifore të këtij lëmi të caktuar në bazë të Ligjit nr 03/L-153 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për

Pyjet e Kosovës nr.2003/3 si dhe në bazë të çmimoreve të përcaktuara me UA të veçanta nga kjo lëmi, të cilat kanë zbatim unik të drejtëpërdrejtë.

KAPITULLI XII DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Neni 41

Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor të QKMF-së dhe QMF-së

1. Çmimorja e bashkëpagesave është e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nr.04/2007 të Ministrisë së Shëndetësisë për mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetjake.
2. Sipas këtij akti ligjor caktohen tarifat dhe taksat e shëndetësisë primare, për shërbimet shëndetësore dhe ato stomatologjike.
3. **Shërbimet shëndetësore të nivelit primar-parësor:**

Nr.	Kategoria	Taksa
1.	Ekzaminimi mjekësor i mjekut të përgjithshëm në punkt, QMF ose në QKMF pa analiza laboratorike dhe pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00 €
2.	Ekzaminimi specialistik në QKM/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes	2.00 €
3.	Ekzaminimi specialistik në QKMF/QMF pa udhëzim të Mjekut të Familjes	5.00 €
4.	Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente	6.00 €
5.	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike	0.30 €
6.	Ultrazëri standard	2.00 €
7.	Radiografia	2.00 €
8.	EKG	0.50 €
9.	Analizat laboratorike-hemogrami dhe urina	1.00 €
10.	Analizat laboratorike (komplet)	3.00 €
11.	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve	1.00 €
12.	Audiograma	1.00 €
13.	Shpëlarja e veshit	1.00 €
14.	Dhënia e injeksionit intramuskulor në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.00 €
15.	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.00 €
16.	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë)	3.00 €
17.	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00 €
18.	Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve	18.00 €
19.	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore për punësim	18.00 €

19.	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	18.00 €
Neni 37 Iniciativat qytetare 1. Qytetarët mund të ndërmarrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës. 2. Iniciativa qytetare realizohet sipas standardeve të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe duhet të përfshijë 15 % të votuesve të komunës të regjistruar në KQZ. 3. Pas marrjes së nënshkrimeve iniciuesit dorëzojnë iniciativën në kuvendin e Komunës. 4. Kuvendi i komunës inicon procesin e verifikimit të nënshkrimeve të dorëzuara. 5. Pas verifikimit Kërkesat dhe iniciativat qytetare shqyrtohen nga kuvendi i komunës në afat prej 60 ditësh, siç përcaktohet me nenin 70 të LVL-së. 6. Të dhënat përfshirë nënshkrimet e përfaqësuesve të iniciativës ruhen dhe arkivohen konform ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.	Član 37. Građanska inicijativa 1.Građani mogu pokrenuti inicijativu za predlaganje propisa, iz nadležnosti opštine. 2. Građanska inicijativa se sprovodi u skladu sa standardima zakona o lokalnoj samoupravi i mora da obuhvati 15% birača opštine upisanih u CIK. 3. Nakon prijema potpisa, inicijatori podnose inicijativu Skupštini opštine. 4. Skupština opštine pokreće proces verifikacije predatih potpisa. 5. Nakon verifikacije, zahteve i inicijative građana razmatra Skupština opštine u roku od šezdeset (60) dana, kao što je utvrđeno članom 70. Zakona o lokalnoj samoupravi (ZLS). 6. Podaci, uključujući i potpise predstavnika inicijative, čuvaju se i arhiviraju u skladu sa zakonom o zaštiti podataka o ličnosti.

Neni 38
Nisma për bashkëpunim ndërkomunal

1. Procedura për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal fillohet përmes nismës.
2. Nisma për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal parashtrohet me shkrim nga:
 - 2.1. Kryetari i Komunës;
 - 2.2. 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
 - 2.3. së paku 5 % e qytetarëve të komunës me të drejtë vote;
 - 2.4. Qeveria e Republikës së Kosovës, kur themelimi i bashkëpunimit ndër-komunal konsiderohet të jetë me interes të veçantë publik dhe lokal.

KAPITULLI VII
QASJA NË DOKUMENTET PUBLIKE, INFORMATAT PËR
SHËRBIME DHE KOMUNIKIMI

Neni 39
Trajtimi dhe raportimi për kërkesat për qasje në dokumentet
publike

1. Komuna, garanton qasjen në dokumentet publike në pajtim me ligjin për qasje në dokumentet publike, ligji për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Komuna publikon kontaktet dhe të dhënat e zyrtarit përgjegjës si dhe raportin vjetor të qasjes në dokumente publike.

Član 38.
Inicijativa za međupštinsku saradnju

1. Procedura za uspostavljenje međupštinske saradnje počinje se kroz inicijativu.
2. Inicijativa o uspostavljenju međupštinske saradnje podnosi se pismenim putem od strane:
 - 2.1. gradonačelnika opštine;
 - 2.2. 1/3 članova Skupštine opštine;
 - 2.3. najmanje pet (5 %) građana opštine sa pravom glasa;
 - 2.4. Vlade Republike Kosovo, kada se uspostavljenje međupštinske saradnje smatra da je od posevnog i javnog interesa.

POGLAVLJE VII.
PRISTUP JAVNIM DOKUMENTIMA I INFORMACIJAMA ZA
USLUGE I KOMUNICIRANJE

Član 39.
Obrada (tretman) i izveštavanje o zahtevima za pristup javnim
dokumentima

1. Opština, garantuje pristup javnim dokumentima u skladu sa zakonom o pristupu javnim dokumentima, zakonom o zaštiti klasificirane informacije i zakonom o zaštiti ličnih podataka.
2. Opština, objavljuje kontakte, podatke službenika odgovornog za podatke kao i godišnji izveštaj o pristupu javnim dokumentima.

Neni 40
Informatat për shërbime

1. Komuna obligohet që informacionet për shërbimet të cilat i ofron të publikohen në hapësirat e institucioneve komunale dhe në ueb faqen zyrtare. Për informacione të rëndësishme komuna mund të përdorë edhe në hapësira të tjera publikimi përfshirë rrjetet sociale.
2. Për të lehtësuar qasjen e qytetarëve në shërbime, komuna publikon të dhënat për strukturën organizative të administratës, detyrat dhe përgjegjësitë e secilës njësi, adresat dhe numrat kontaktues.
3. Komuna publikon të dhënat e udhëheqësve të lartë të organeve të komunës, si dhe personave përgjegjës në njësitë e shërbimeve të administratës, adresat elektronike të tyre dhe numrat kontaktues.
4. Të dhënat për adresën dhe shërbimet e ofruara nga secila njësi organizative e komunës përfshirë: listën e shërbimeve të ofruara, licencat, lejet, autorizimet, certifikatat, vërtetimet, shërbimet e tjera, kohën e marrjes së shërbimit, procedurat, afatet dhe detajet e personave përgjegjës zyrtar të autorizuar për dhënien e shërbimit.
5. Komuna është e obliguar që informatat dhe dokumentet t'i publikoj në linkun adekuat duke përdorur emërtimin zyrtar.

Neni 41
Procedura e komunikimit

1. Në ueb faqen e komunës dhe kanalet e tjera të komunikimit komuna publikon e-mail adresa apo forma të tjera të pranimit të kërkesave, ankesave apo parashtrësive të tjera nga qytetarët.

Član 40.
Informacije o uslugama

1. Opština je dužna da informacije o uslugama koje nudi, objavi u prostorijama opštinskih institucija i na službenoj web stranici opštine. Za važne informacije, opština može koristiti i druge prostore za objavljivanje, uključujući i društvene mreže.
2. Da bi se građanima olakšao pristup uslugama, opština objavljuje podatke o organizacionoj strukturi uprave, dužnostima i odgovornostima svake jedinice, adresama i kontakt telefonima.
3. Opština objavljuje podatke rukovodstva organa opštine, kao i odgovornih lica u jedinicama službe uprave, njihove elektronske adrese i kontakt brojeve.
4. Podaci o adresi i uslugama koje pruža svaka organizaciona jedinica opštine, uključujući: spisak pruženih usluga, licence, dozvole, ovlašćenja, sertifikate, overe, druge usluge, vreme prijema usluge, procedure, rokove i detalje službenih odgovornih lica ovlašćenih za pružanje usluge.
5. Opština je dužna da informacije i dokumente objavi na odgovarajućem linku koristeći službeni oznaku.

Član 41.
Procedura komuniciranja

1. Na službenoj web stranici opštine i drugim komunikacionim kanalima, opština objavljuje e-mail adrese ili druge oblike prijema zahteva, žalbi i podnesaka od strane građana.

2. Komuna siguron që të gjitha kërkesat që adresohen në emailat zyrtarë të publikuar në faqet e komunës të marrin përgjigje brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. 3. Zyrtarët që menaxhojnë emailat zyrtar publik të komunës do të ofrojnë përgjigje përmes komuniukimit elektronik. 4. Në momentin kur emali vendoset në ueb faqe, zyrtari do të njoftohet për obligimin që të përgjigjet dhe të adresoj kërkesat e pranuar në emalin zyrtarë. 5. Nëse zyrtari publik nuk është përgjegjës apo nuk ka kompetencë për të ofruar përgjigje në kërkesat e pranuar me e-mail ai obligohet të njoftoj parashtruesin me adresën ku duhet të kërkohet përgjigje. 6. Në bashkëpunim me zyrtarët e IT-së zyrtarët që menaxhojnë e-maila do ndërmarrin hapa për të identifikuar dhe bllokuar adresa të cilat dërgojnë materiale promovuese apo e-maila të krijuar nga “bots”. 7. Me qëllim të informimit më të mirë të qytetarëve për çështje të caktuara komuna do të krijoj lista të e-mailave lista të numrave të telefonave dhe aplikacioneve të cilat përdoren për komunikim. 8. Të dhënat e e-mailave, kontakteve të telefonave apo aplikacioneve do të ruhen dhe mirëmbahen sipas dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. KAPITULLI VIII PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË NË KOMUNË Neni 42 Procedurat e hartimit të Planit të Veprimit për Transparencë	2. Opština obezbeđuje da se na sve zahteve koji su adresirani u službenim e-mailima objavljenim na službenoj web stranici opštine, odgovori u razumnom vremenskom periodu i u skladu sa zakonodavstvom na snazi. 3. Službenici koji upravljaju službenim javnim e-mailima opštine će davati odgovore putem elektronske komunikacije. 4. U trenutku kada se e-mail postavi na službenoj web stranici opštine, službenik će biti obavešten o obavezi da odgovori i uputi zahteve primljene u službenom e-mailu. 5. Ako javni službenik nije odgovoran ili nema nadležnost da daje odgovore na zahteve primljene putem e-maila, dužan je da obavesti podnosioca zahteva sa adresom na kojoj se traži odgovor. 6. U saradnji sa IT službenicima, službenici koji upravljaju e-mailovima će preduzeti korake da identifikuju i blokiraju adrese koje šalju promotivne materijale ili e-mailove kreirane od strane „botova“. (prikupljanje informacija i obično se nazivaju programi za indeksiranje web stranica). 7. U cilju boljeg informisanja građana o pojedinim pitanjima, opština će izraditi liste e-mailova, liste brojeva telefona i aplikacija koje se koriste za komunikaciju. 8. Podaci e-mailova, telefonskih kontakata ili aplikacija će se čuvati i održavati u skladu sa odredbama zakona o zaštiti podataka o ličnosti. POGLAVLJE VIII. AKCIONI PLAN ZA TRANSPARETNOST U OPŠTINI Član 42. Procedure izrade Akcionog plana za transparetnost
--	---

1. Komuna harton Planin e veprimit për transparencë në komunë, në pajtueshmëri me dispozitat Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur si dhe në pajtim me këtë Rregullore. 2. Plani i veprimit për transparencë hartohet për një periudhë katër (4) vjeçare. 3. Plani i veprimit për transparencë aprovohet nga kuvendi i komunës dhe publikohet në uebfaqen zyrtare. 4. Plani i veprimit për transparencë përfshinë veprime që promovojnë: Mbledhjet e Kuvendit të Komunës; Komiteteve; Takimet publike; Takimet konsultative për projektakte; Transparencën në planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit të komunë; Qasje të shpejtë në shërbime; Procedurat transparente të Prokurimit; Procedurat të punësimit; Përditësimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare; Përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes etj. KAPITULLI IX DISPOZITAT PËRFUNIDTARE Neni 43 Respektimi i gjuhëve zyrtare 1.Komuna gjatë publikimit të akteve normative, vendimeve, dokumenteve dhe informatave, obligohet të respektoj ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare si dhe Rregulloren komunale për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Komunën e Klinës. Neni 44 Funksionimi i faqes zyrtare elektronike të Komunës	1. Opština izrađuje Akcioni plan za transparentnost u skladu sa odredbama Administrativnog uputstva za otvoreno upravljanje kao i u skladu sa ovom uredbom. 2.Akcioni plan za transparentnost se izrađuje za period od četiri (4) godine. 3. Akcioni plan transparentnosti usvaja Skupština opštine i objavljuje na službenoj web stranici opštine. 4. Akcioni plan za transparentnost obuhvata akcije koje promovišu: Sednice Skupštine opštine; odbori; javni skupovi; konsultativni sastanci za projekte; transparentnost u planiranju i korišćenju opštinskog budžeta; brz pristup uslugama; transparentne procedure za nabavke; procedure zapošljavanja; ažuriranje dnevnih aktivnosti na službenoj web stranici; aktivno uključivanje građana u procese donošenja odluka itd. POGLAVLJE IX. ZAVRŠNE ODREDBE Član 43. Poštovanje službenih jezika 1.Opština prilikom objavljivanja normativnih akata, odluka, dokumenata i informacija, obavezuje se da poštuje zakon o službenim jezicima kao i opštinsku uredbu za upotrebu službenih jezika u opštini Klina. Član 44. Funkcionisanje elektronske web stranice opštine
---	---

1. Komuna duhet të përditësojë dhe mirëmbajë faqen zyrtare elektronike të saj, ashtu siç është e përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2015 për Ueb Faqet e Institucioneve Publike. 2. Të gjitha dokumentet publike të komunës vendosen në faqen zyrtare, në bazë të fushës përkatëse, në mënyrë që të lehtësohet qasja e shpejtë e qytetarit dhe grupeve tjera të interesit. 3. Arritja deri tek informacioni në ueb faqet zyrtare të jetë me sa më pak hapa-klikime. Neni 45 Përgjegjësia për zbatim 1. Për zbatimin e kësaj Rregullore është përgjegjësi e Kuvendit Komunal dhe Kryetarit të Komunës përmes organeve kompetente të autorizuara me ligj. Neni 46 Shfuqizimi 1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Transparencë, e datës 26.12.2014, me numër protokolli; 01 Nr. 031-5713/2014._____. Neni 47 Hyrja në fuqi 1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ueb-faqen e Komunës.	1. Opština treba da ažurira i održava svoju elektrosnku web stranicu prema Administrativnom uputstvu br. 01/2015 za web stranice javnih institucija. 2. Svi javni dokumenti opštine se objavljuju na službenoj web stranici, na osnovu relevantne oblasti kako bi se olakšao pristup građanima i drugim zainteresovanim grupama (stranama). 3. Dolazak do informacija na službenim web stranicama trebalo bi da bude što je moguće manje koraka-klikova. Član 45. Odgovornost za sprovođenje 1. Za sprovođenje ove uredbe, odgovorna je Skupština opštine i gradonačelnik opštine putem nadležnih organa, ovlašćeni sa zakonom. Član 46. Ukidanje 1. Stupanjem na snagu ove uredbe, ukida se uredba o transparentnosti, od 26.12.2014. godine, sa brojem protokola; 01 br. 031-5713/2014. Član 47. Stupanje na snagu 1. Ova uredba stupa na snagu petnaest (15) dana, nakon upisa u Kancelariji za protokol u Ministarstvu administracije lokalne samouprave kao i objavljivanja na službenim jezicima u Službenom glasniku Republike Kosovo i na službenoj web stranici opštine.
--	--

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Predsedavajući Skupštine opštine



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org



KOMUNA E KLINËS

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË 2025 - 2029

Shkurt, 2025

DEKLARATA E TRANSPARENCËS

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një pikëpamje gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me transparencën, gjithëpërfshirjen, kulturën organizative dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale rregullative.

Plani i Veprimit për transparencë synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale llogaridhënëse dhe transparente, të hapur për qytetarë dhe shoqërinë civile në të gjitha proceset vendimmarrëse. Përmes Planit, do të promovohet koncepti i demokracisë së drejtpërdrejtë lokale, në mënyrë që politikbërja të bazohet në argumente, fakte dhe të dhëna reale. Plani është dokument strategjik komunal, i hartuar në pajtim me orientimet e përcaktuara nga Strategjinë për Vetëqeverisje lokale dhe aktet juridike përcjellëse të nivelit qendror që promovojnë qeverisjen transparente.

Llogaridhënia dhe transparenca janë parime që përtej informimit, synojnë mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes komunale. Për këtë arsye, zotohemi që Komuna e Klinës me gjithë sinjeritetin dhe përkushtimin do të rris gatishmërinë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha kërkesave të qytetarëve për të qenë të angazhuar aktivisht në planifikimin dhe zhvillimin e politikave, për të siguruar që efektet e zbatimit të tyre të japin rezultatet e dëshiruara dhe afektojnë direkt interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

Me plan të transparencës, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standardet, parimet, objektivat, metodat dhe mjetet efektive për rritjen e llogaridhënies, inkurajimin e qytetarëve për t'u bërë pjesë e qeverisjes, si dhe të ndikojmë tek punonjësit për të promovuar sjellje të mirë dhe të përgjegjshme.

Ne vlerësojmë se planifikimi i bazuar në informacion është metoda më e mirë e ndërtimit të qëndrueshëm të vizionit zhvillimor. Në funksion të kësaj, shërbimet cilësore komunale dhe administrimi i kërkesave të qytetarëve varet drejtpërdrejtë nga mënyra e shpërndarjes së informatave, sistemet e aplikuara të informacionit, teknikat e konsultimit dhe veprime të tjera përcjellëse të organeve të administratës.

Prandaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e ndërlidhura me informim, por të bëjmë përpjekje për të siguruar praninë e vazhdueshme të qytetarëve dhe grupeve të interesit, me theks të veçantë organizatave të shoqërisë civile, duke përvijuar konceptin qytetarisë aktive dhe ndërtimit të qeverisjes së opinionit publik. Besojmë që ky plan veprimit për transparencë do të jetë një ndihmesë në rritjen e efikasitetit të shërbimeve, në krijimin e një ambienti më transparent të punës në administratë, rritjen e besimit të qytetarëve ndaj të zgjedhurve të tyre publike, gatishmërisë dhe përkushtimit më të madh, si dhe përpjekjeve për të fuqizuar e përmirësuar sistemin e menaxhimit brenda komunal.

Kryetari i Komunës së Klinës

HYRJE

Transparenca dhe llogaridhënia janë elementet thelbësore të qeverisjes së mirë në nivelin lokal. Rruga drejt informimit publik efikas duhet të jetë baza e qeverisjes së mirë, ndërkaq, komunikimi efektiv me qytetarët dhe pjesëmarrja e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të komunës është aspekti kyç që siguron vendimmarrje me bazë të gjerë. Fryma e institucioneve komunale duhet të adoptoj modelet më të avancuara të qeverisjes transparente brenda kornizës ligjore në fuqi.

Transparenca komunale është njëra nga segmentet e qeverisjes e cila monitorohet në vazhdimësi nga qeveria qendrore, por edhe nga akterë të tjerë ndërkombëtar, Komisioni Evropian, organizatat ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare. Marrë parasysh nivelin e përgjegjësi dhe shkallën e decentralizimit të pushtetit lokal në Kosovë, Kushtetuta dhe legjislacioni kanë paraparë të drejtën e autoriteteve qendrore për të ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje në faza të caktuara të procesit të avancimit të transparencës dhe zhvillimit të politikave për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje lokale.

Komunat si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale janë të obliguara t'i krijojnë mekanizmat e përshtatshëm të informimit publik. Tani, struktura e ueb-faqeve zyrtare të komunave është unike. Përmes tyre është krijuar mundësia për qasje në të gjitha dokumentet me rëndësi publike. Përveç karakterit informues, ato mundësojnë edhe procese administrative dhe linja me ndërfaqe të tjera të cilat shërbejnë për procesin e konsultimit publik. Ndërlidhja e tyre me sistemin e intranetit në komunë, mundëson që qytetarët të parashtrojnë online të gjitha kërkesat e tyre ndaj drejtorive përkatëse në komunë.

Fusha e transparencës komunale ka një strukturë të mirë organizuar të rregullave juridike ligjore dhe nënligjore. Plani i Veprimit për Transparencë synon t'i grupoj përgjegjësitë kryesore të komunave bazuar në rregullat juridike për administratë të hapur, për të shërbyer si dokument kornizë në një periudhë afatgjatë.

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

Plani i Veprimit për Transparencë Komunale ka për qëllim t'i ofrojnë publikut qasje të lehtë në monitorimin dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikim të të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) NR. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, në nenin 42 përcakton obligimin e komunave për të hartuar planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë. Ky plan, kërkohet të përfshijë veprime që promovojnë: Mbledhjet e Kuvendit të Komunës; Komiteteve; Takimet publike; Takimet konsultative për projektakte;

Transparencën në planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit të komunë; Qasje të shpejtë në shërbime; Procedurat transparente të Prokurimit; Procedurat të punësimit; Përditësimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare; Përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje etj.

Plani i Veprimit për Transparencë mundëson:

- Ndërlidhjen e planifikimit me sistemet e informacionit në mënyrë që supozimet e organeve të administratës gjatë zhvillimit të politikave të vërtetohen dhe legjitimohen;
- Përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme në vendimmarrje dhe politikbërje;
- Rezultatet e punës së komunave të jenë të matshme, cilësore dhe në funksion të interesave të përgjithshme të qytetarëve.

Plani i veprimit për transparencë në mënyrë specifike kontribuon që:

- Komuna të identifikoj me kohë prioritetet për të cilat kërkohet informimi, si dhe përfshirja e qytetarëve apo grupeve të interesit;
- Të identifikoj metodat, mjetet dhe teknikat për konsultimin e qytetarëve dhe përfshirjen e tyre;
- T'i evitoj praktikatat e zhvillimit të dokumenteve pa informacion të qartë dhe me kosto të papërbalueshme;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm transparent dhe llogaridhënës, duke inkurajuar bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave;
- Mbajtjen e një sistemi koherent me të gjitha palët e interesit për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet ligjore;
- Ndikimin në sjelljet e punonjësve komunal në mënyrë që veprimet e ndërmarra të demonstrojnë ligjshmëri dhe integritet;

Zbatimi i Planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me aktivitetet e komunës. Plani do të përmbledh në mënyrë të qartë transparencën e organeve komunale, publikimin e akteve nënligjore, rregulloret komunale, dokumentet strategjike, vendimet e kryetarit, njoftimet për aktivitetet e kuvendit komunal, takimet publike, transparencës buxhetore, prokurimin publik, zbatimin e standardeve të konsultimit, qasjen në dokumentet publike, etj.

TRANSPARENCA SI PARIM I QEVERISJES SË MIRË

Në një sistem demokratik funksional, informimi dhe përfshirja duhet të jenë segment vital i administrimit publik. Transparenca është komponentë kryesore e qeverisjes demokratike, e cila kërkon një hallkë të gjerë të veprimeve institucionale, si në procesin e hartimit të politikave ashtu edhe në fazën e zbatimit dhe raportimit. Rëndësia e transparencës ndikon në aspekte të shumta duke përfshirë qëndrueshmërinë ekonomike, financiare, qeverisjen e mirë, si dhe në sistemin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Parimi i publicitetit dhe transparencës supozojnë se çdo kush ka të drejtë të dijë arsyet e nxjerrjes së një vendimi të caktuar apo veprimi të administratës. Përmes këtij parimi mundësohet hapja e administratës para shoqërisë, informimi për punën e saj mund të bëhet në mënyrë të ndryshme dhe në vëllim të ndryshëm, parim që mund të kufizohet vetëm në rastet e caktuara në legjislacionin e secilit vend. Të qenit i hapur dhe transparent janë gjithashtu instrumente të nevojshme për shtetin e së drejtës, barazinë para ligjit, dhe përgjegjshmërinë. Si rregull i përgjithshëm, sjellja e administratës publike duhet të jetë transparente dhe e hapur, megjithëse të dhënat personale nuk duhet t'i lejohen palëve të treta.

Transparenca është një nga çështjet më me peshë në procesin e demokratizimit të shteteve dhe qeverisjes së mirë. Këtë e mundësojnë mekanizmat dhe iniciativat e qeverisjes së hapur, të cilat bëjnë që përfitimet e transparencës të jenë në shumë aspekte, përfshirë: qeverisje më e mirë, vendimmarrje më cilësore, besim më të madh publik, ulje të korrupsionit dhe shërbime publike më efektive. Transparenca përfshin rregullat mbi të drejtat e krijimit, ruajtjes, qasjes dhe përpunimit të informacionit, të cilat mund të shfrytëzohen gjatë proceseve të vendimmarrjes, por edhe për nevojat e informimit të përgjithshëm. Për më tepër, në kuptim më të gjerë transparenca nuk është vetëm informim, por përfshinë një varg procesesh dhe veprimesh të bazuara në: informacion, komunikim, pjesëmarrje, angazhim, ndërtim të konsensusit për zgjidhjen e problemeve, raportim dhe llogaridhënie.

KORNIZA LIGJORE PËR TRANSPARENCË

Në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës janë miratuar një numër i madh i ligjeve dhe akteve nënligjore, që rregullojnë fushën e transparencës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale është aprovuar në vitin 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe bën pjesë në grupin e ligjeve me karakter vital për shtetin. Përmbajtja e këtij ligji reflekton parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, duke paraparë mekanizma të veçantë të informimit, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të drejtave të qytetarëve, e në veçanti të drejtave të komuniteteve joshumicë. Me këtë ligj është përcaktuar që kuvendi i komunës të miratojë rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunë. Përveç kësaj, me anë të një numri të konsiderueshëm të akteve nënligjore janë definuar edhe procedurat e zbatimit të instituteve të shumta juridike për transparencë, janë përcaktuar zyrtarët përgjegjës, format dhe teknikat për transparencë, si dhe afatet procedurale. Në përgjithësi, kuadri juridik normon obligime për organet e administratës shtetërore në fushën e transparencës, ndërsa në veçanti për organet e pushtetit, përmes akteve si në vijim:

1. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;
2. Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;
3. Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
4. Ligji Nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar
5. Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;

Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të hapur;

Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 01/2021 për Funkcionimin e Qendrave të Shërbimeve

Të Qytetarëve në Komunë;

1. Udhëzim Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike
2. Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.03/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës;
3. Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna;

Aktet komunale:

1. Statuti i komunës së Klinës;
2. Rregullore komunale për transparencë;
3. Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që ndërlidhen me fushën e transparencës.

QASJA STRATEGJIKE PËR FUQIZIMIN E TRANSPARENCËS

Në nivel qendror janë zhvilluar një numër strategjish të cilat parashohin objektiva me synim reformën e administratës shtetërore. Ndër strategjitë kryesore në fushën e qeverisjes së mirë, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në institucionet e administratës janë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030;
- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Strategjia për Rregullim më të Mire 2017-2021;
- Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2017-2021;
- Strategjia për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023;
- Agjenda për Reforma Evropiane;
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKMSA)
- Strategjitë e tjera sektoriale.

Dokument me rëndësi të veçantë për transparencën komunale është Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Kjo strategji ka 5 objektiva kryesore përmes së cilave përcaktohen caqet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të pushtetit lokal në Kosovë. Në objektin e tretë të saj, strategjia parasheh forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive. Bazuar në problemet e identifikuara, në planin e veprimit të kësaj strategjie

parashihen aktivitetet konkrete të masave, që përfshijnë zhvillimin e politikave efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve, respektivisht:

- Politikat lokale për nxitjen e aktivizimit qytetar;
- Politikat për nxitjen e punës vullnetare të studentëve dhe nxënësve;
- Politikat për funksionalizimin e qendrave rinore nëpër fshatra;
- Politikat për funksionalizimin e këshillave të fshatrave;
- Politikat për përfshirjen dhe angazhimin e pensionistëve në jetën publike;
- Politikat për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Politikat për nxitjen e pjesëmarrjes së grave si dhe kategorive sociale të pambrojtura;
- Politikat lokale për trajtimin e fëmijëve të rrugës;
- Politikat lokale për krijimin e rrjeteve sociale, ekonomike, rinore, sportive dhe kulturore.

Strategjia parasheh po ashtu masa konkrete në krijimin e platformave që fuqizojnë transparencën, e në veçanti përmes qeverisjes elektronike. Qeveria elektronike sigurisht që lehtëson komunikimin në mes të grupeve të interesit me autoritetet publike, derisa ajo forcon administratën përmes: kursimit të kohës në ofrimin e shërbimeve, uljes së kostos operative, rritjes së efikasitetit, ruajtjes së memories institucionale dhe rritjes së llogaridhënies. Edhe strategji të tjera në nivel vendi ofrojnë qasje shumëdimensionale për ndërhyrje në politikat e transparencës.

Andaj, masat e tilla të ndërhyrjes janë të rëndësishme, për faktin se përmirësojnë komunikimin me qytetarë, krijojnë hapësirë për politikbërje të qëndrueshme, zbatim efikas të tyre, si dhe plotësojnë obligimet e Kosovës në raport me kriteret e kërkuara nga Bashkimi Evropian.

MEKANIZMAT LIGJORË PËR PJESËMARRJE DHE ZBATIM TË PARIMIT TË TRANSPARENCËS

Qeverisja lokale në Kosovë promovon fuqishëm parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Mënyra e parë dhe më e thjeshtë në të cilën transparenca mund të ndihmojë në ofrimin e paanësisë është duke lejuar publikun të luajë një rol të rëndësishëm në garantimin që rregullat të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe korrekte. Qytetarët nuk mund të jenë askund më afër me shtetin se përmes organeve të pushtetit lokal. Komunat janë adresa më e afërt për të kërkuar që shërbimet dhe resurset shpërndahen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe në pajtim me nevojat sistematike të tyre.

Numri më i madh i taksave dhe tatimeve që mblidhen nga shteti, u shpërndahen komunave për ushtrimin e kompetencave ligjore. Taksat për të cilat qytetarët paguajnë në baza periodike janë burime vetanake të komunave, të cilat shpenzohen për shërbimet e ofruara. Planifikimi i shpenzimit të tyre bëhet me anë të buxhetit komunal, që është dokument kryesor vjetor që mbledh të gjitha projektet investive me interes publik. Gjatë përgatitjes së buxhetit, komunat ligjërisht obligohen të mbajnë konsultime me qytetarët, bizneset, grupet e

interesit dhe shoqërinë civile. Prandaj, qeverisja e mirë komunale do të zinte vend vetëm nëse planifikimi i mjeteve buxhetore, politikave të tjera, shpenzimet e tyre dhe mënyra e shpërndarjes së investimeve publike do të mbështetej në opinionin e qytetarëve, përmes formave të shumta të përfshirjes direkte të tyre.

Në mënyrë që transparenca të jetë pjesë përbërëse e politikbërjes në nivel lokal, Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar një numër të shumtë të instrumenteve juridike për pjesëmarrje të qytetarëve në jetën publike ku bëjnë pjesë:

- Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë;
- Konsultimet për projektakte dhe dokumente të politikave;
- Informimi dhe konsultimi përmes e-qeverisjes;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile;
- E drejta për qasje në dokumentet publike.
- Komitetet konsultative;

Iniciativat qytetare, peticionet dhe referendumet lokale;

Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komunë ka përcaktuar buxhetimin me pjesëmarrje si një instrument të cilin komunat mund të shfrytëzojnë për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, dhe për të avancuar transparencën e procesit të buxhetimit. Të gjitha këto forma kanë bazën e tyre juridike, procedurale, mjetet dhe format e zbatimit të tyre. Efekti i tyre në përmirësimin e qeverisjes lokale vërehet përmes rritjes së transparencës, krijimit të qytetarisë aktive dhe forcimit të dialogut social. Edhe pse të shumta, aplikimi i tyre ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, për çka tregojnë statistikatat e shumta të dala nga raportet e monitorimit të institucioneve të ndryshme publike dhe jopublike. Gjithashtu, jo të gjitha janë të zbatueshme për shkaqe juridike, por edhe praktike.

OBJEKTIVAT E PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

Objektivi kryesor i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale është “të siguroj qeverisje të hapur për qytetarë, gjithëpërfshirje në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të politikave, si dhe qeverisje transparente dhe llogaridhënëse”.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një kornize të qartë të planifikimit të organizuar, ku përcaktohen rolet e të gjithë pjesëmarrësve përgjegjës për transparencë komunale.
- Fuqizimi i mekanizmave lokal të demokracisë direkte, për të krijuar një publik të interesuar për çështje publike;
- Avancimi i mekanizmave të informimit në mënyrë që qytetarët të dëgjohen dhe të inkurajohen për të qenë aktiv në proceset vendimmarrëse.

- Krijimi i një sistemi efektiv qeverisës, në të cilin parim kryesor i hartimit të politikave është baza e informacionit.
- Ndërtimi i partneritetit të mirëfilltë me shoqërinë civile, në të gjitha fazat e menaxhimit të organeve komunale.

FAZAT E ZHVILLIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË KOMUNALE

Zhvillimi i Model – Planit të veprimit për transparencë përbëhet prej disa faza si në vijim:

- 1. Faza Paraprake** – Kryetari i komunës themelon grupin e punues. Përbërja e grupit punues duhet të jetë shumësektoriale dhe të udhëhiqet nga Zyra për Komunikim Publik në bashkëpunim me zyrën ligjore të komunës. Procedurat e hartimit zhvillohen në pajtim me rregullat në fuqi për procedurat e hartimit të akteve komunale.
- 2. Faza e vlerësimit të prioritetëve** – gjatë kësaj faze, kryesuesi së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionet e mbledhura (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së komunës; dokumentet strategjike të komunës mbi bazën e të cilave priten të zhvillohen aktet juridike të komunës, planet komunale, dokumentet e tjera të politikave për të cilat duhet të zhvillohen konsultime publike dhe të sigurohet prania e qytetarëve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale dhe planeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate, duhet të përcaktohen prioritetet dhe të bëhet renditja e veprimeve për secilin aktivitet.
- 3. Faza e përcaktimit të aktiviteteve dhe propozimit të masave** – kjo fazë përfshin kategorizimin e prioritetëve sipas periudhave të zhvillimit, renditjen e aktiviteteve, metodave dhe mjeteve të veprimit, afatet kohore, organet/zyrtarët përgjegjës, koston financiare.
- 4. Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të veprimit për transparencë** - përfshin monitorimin, regjistrimin dhe raportimin e rregullt të aktiviteteve që zhvillohen sipas Planit të veprimit për transparencë. Raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirësojnë zbatimin e objektivave të Planit të Transparencës Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË AKTIVITETEVE TË TRANSPARENCËS

Vlerësimi i aktiviteteve të transparencës do të thotë renditja e veprimeve në Plan sipas prioritetëve, duke mundësuar që komuna të jetë e hapur dhe bashkëpunuese me qytetarë në të tri fazat kyçe të menaxhimit: **1) Planifikim; 2) Zbatim; 3) Raportim.**

Prioritetet përcaktohen duke marrë për bazë rëndësinë e proceseve, përkatësisht: Natyrës së veprimtarisë që do të ndërmerret nga organi përkatës i komunës; Llojeve të dokumenteve të politikave për të cilat kërkohet përfshirja e qytetarëve; Fushëveprimi të akteve juridike të planifikuara për hartim; Ndikimit të tyre ekonomik dhe social; Peshës financiare të politikës së propozuar; Periudhës kohore të veprimit; Shtrirjes gjeografike; etj.

Pas përcaktimit të aktiviteteve, grupi punues cakton prioritetet dhe metodat e veprimit si pjesë përbërëse të planit të veprimit, që janë të ndryshme varësisht se për cilën fazë të menaxhimit bëhet fjalë.

MONITORIMIT I ZBATIMIT TË PLANIT TË TRANSPARENCËS

Zbatimi i Planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se masat e parapara janë efektive dhe ndikojnë në cilësinë e politikbërjes, si parakusht i ligjshmërisë së procesit vendimmarrës.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë sjellë vendimmarrje cilësore, efikase dhe efektive, me kosto reale dhe të përballueshme.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Me qëllimi të sigurimit të zbatimit të planit të veprimit për transparencë, krijohet mekanizmi për monitorimin dhe raportimin për këtë plani, si në vijim:

Grupi punues - emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:

- Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale;
- Grupi është njëherësh sigures i zbatimit të planit dhe garanton që në baza periodike Planin Vjetor i Punës së Komunës të ndërlidhet me aktivitetet dhe masat e përcaktuara në Planin Vjetor të Veprimit për Transparencë;
- Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.
- Propozon masa të nevojshme për zbatimin e plotë të masave të propozuara në Planin e Veprimit për Transparencë;
- Monitoron zbatimin e masave për përmirësimin e transparencës;
- Raporton tek kryetari për zbatimin e planit të veprimit për transparencë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr prot. _____ *2025*

Datë: _____ *2025*



PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2025 – 2029

Përmbajtja

Fjala e kryetarit të komunës

Falënderim

Grupi punues për hartimin e PLVM-së

Indeksi i shkurtesave

Indeksi i tabelave

Indeksi i figurave

1. Hyrje

- 1.1. Baza ligjore për hartimin e PLVM-së
- 1.2. Qëllimi dhe objektivat e PLVM-së
- 1.3. Procesi për përgatitjen e PLVM-së
- 1.4. Metodologjia për hartimin e PLVM-së

2. Profili i komunës

- 2.1. Pozita gjeografike dhe organizimi administrativ
- 2.2. Kushtet klimatike dhe relievi
- 2.3. Infrastruktura
- 2.4. Shëndetësia
- 2.5. Arsimi
- 2.6. Trashëgimia kulturore

3. Presionet në mjedis

- 3.1. Popullsia dhe vendbanimet
- 3.2. Industria dhe bizneset
- 3.3. Sektori minerar
- 3.4. Transporti
- 3.5. Bujqësia
- 3.6. Pylltaria
- 3.7. Turizmi

4. Gjendja e mjedisit

- 4.1. Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre
- 4.2. Ajri dhe zhurma
- 4.3. Menaxhimi i mbeturinave
- 4.4. Shfrytëzimi, ndotja dhe erozioni i tokave
- 4.5. Natyra dhe biodiversiteti

5. Problemet kryesore mjedisore

6. Prioritetet mjedisore për periudhën 2025-2029

7. Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2025-2029

8. Plani i monitorimit për zbatimin e PLVM-së

9. Referencat dhe burimet e informatave

FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Të nderuar qytetarë të komunës së Klinës,

Kam kënaqësinë dhe nderin e veçantë që sot ndaj me ju Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2025-2029, një dokument strategjik dhe gjithëpërfshirës, i cili synon adresimin e sfidave mjedisore në komunën tonë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mjedisit në të gjithë territorin e Klinës.

Për vite me radhë, janë ndërmarrë përpjekje të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit, falë bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve lokale, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve të ndërgjegjshëm. Por, përkundër progresit të arritur, ndotja dhe degradimi i mjedisit mbeten sfida që kërkojnë angazhim të vazhdueshëm. Për këtë arsye, miratimi dhe zbatimi i këtij plani është një hap jetik për të siguruar një të ardhme më të gjelbër dhe më të shëndetshme për brezat e ardhshëm.

Ky dokument është hartuar në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe përmbush obligimet tona si qeverisje lokale për ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive natyrore. Ai reflekton analizën e detajuar të gjendjes aktuale të mjedisit në Klinë, përcakton prioritetet kryesore dhe parasheh aktivitete konkrete për menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e burimeve ujore, gjelbërimin dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është plotësisht i harmonizuar me Planin Zhvillimor Komunal dhe me dokumentet strategjike të zhvillimit të komunës, duke siguruar një qasje të integruar dhe të qëndrueshme për zhvillimin e territorit tonë.

Me këtë rast, dua të shpreh mirënjohjen për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e këtij plani. Falënderoj zyrtarët komunalë, ekspertët e mjedisit dhe të gjitha palët e interesit që ofruan mbështetjen e tyre në këtë proces të rëndësishëm.

Ju ftoj të gjithëve, qytetarë, institucione dhe organizata, që të bashkohemi për zbatimin e këtij plani, sepse një mjedis i pastër dhe i shëndetshëm është një përfitim i përbashkët për të gjithë ne. Së bashku, mund të ndërtojmë një Klinë më të pastër, më të gjelbër dhe më të mirë për të gjithë.

Prof. Dr. Zenun Elezaj

Kryetar i Komunës së Klinës

GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PLVM-SË

Përbërja e Grupit punues për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, është përcaktuar me vendimin 01Nr.112-37128/2024, për Formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) të datës 01.11.2024, të kryetarit të komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj.

Grupi punues ka këtë përbërje:

1. Marqe Selmanaj, kryesuese - Nënkryetare e Komunës
2. Enver Berisha, anëtar- Drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
3. Xhezide Trepça-Gashi, anëtare- Zyrtare për Mbrojtje të Mjedisit
4. Antonije Selmani, anëtare- Zyrtare e Lartë për Projekte
5. Dardan Bashota, anëtar - Inspektor i Shërbimeve Publike
6. Melihate Behrami, anëtare- Zyrtare kryesore financiare
7. Idriz Beqiri, anëtar- Menaxher i NJO-Ambienti-Klinë
8. Altin Mujaj, anëtar - Udhëheqës i Sektorit për Gjeodezi
9. Rexhep Rexhepi, anëtar- Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi
10. Driton Raci, anëtar- Zyrtar Ligjor
11. Vitore Zefi, anëtare- OJQ “Ardhmëria”.

Pjesë e grupit punues, si bashkëpunuese, do të jetë edhe zyrtarja për Informim, njëherësh edhe zyrtare përgjegjëse për Konsultim Publik, Vlora Tafili, e cila do të bëjë informimin e qytetarëve të Komunës së Klinës e po ashtu do të menaxhojë aktivitetet dhe procedurat e konsultimit publik të këtij plani.

INDEKSI I SHKURTESAVE

AMF	Ambulanca e Mjekësisë Familjare
AMMK	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
ARRU	Autoriteti Rregullativ për Ujësjellës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DSHP	Drejtoria për Shërbime Publike
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
FAO	Organizata Botërore e Ushqimit
GIZ	Organizata Gjermane për Shoqëri të Hapur
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
KDSH	Kujdesi Dytësor Shëndetësor
KRU	Kompania Regjionale e Ujësjellësit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ME	Ministria e Ekonomisë
NERA	New Environment Revitalization Approach
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare

PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVB	Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendrat e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
QRTK	Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Indeksi i tabelave

Tabela 1. Ligjet, qëllimi dhe fushëveprimi i tyre

Tabela 2. Sipërfaqja e komunës së Klinës sipas lartësisë mbidetare

Tabela 3. Klasifikimi i terrenit në komunën e Klinës sipas pjerrtësisë së terrenit

Tabela 4. Të dhëna sipas ARBK-së në Klinë

Tabela 5. Të dhëna sipas ARBK-së në Klinë

Tabela 6. Emetimet në ajër - Klinë, 2021-2022

Tabela 7. Sasia e mbeturinave të grumbulluara dhe deponuara në 2021 në Komunën e Klinës

Tabela 8. Mbulimi me shërbim për gumbullimin e mbeturinave në territorin e komunës

Tabela 9. Shfrytëzimi i tokës

Tabela 10. Problemet kryesore mjedisore

Tabela 11. Prioritetet mjedisore për periudhën 2025-2029

Tabela 12. Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2025-2029

Tabela.13. Plani i monitorimit

Indeksi i figurave

Figura 1. Pozita gjeografike e komunës së Klinës në hartën e Republikës së Kosovës

Figura 2. Lartësia mbidetare e Komunës së Klinës

Figura 3. Harta e reshjeve në komunën e Klinës

Figura 4. Ekspozicioni i terrenit në komunën e Klinës

Figura 5. Pjerrtësia e terrenit në komunën e Klinës

Figura 6. Harta gjeologjike e komunës së Klinës

Figura 7. Harta pedologjike e komunës së Klinës

Figura 8. Lokaliteti arkeologjik i Dresnikut- Qyteti Antik

Figura 9. Asetet e trashëgimisë kulturore

Figura 10. Harta e minierave dhe burimeve minerale

Figura 11. Hidrogjeologjia

Figura 12. Harta e erozionit

Figura 13. Ujëvara e Mirushës

1.1 HYRJE

Baza ligjore për hartimin e PLVM-së

Plani Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) është dokument planifikues - strategjik, për të adresuar zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal. Hartimi dhe miratimi i tij është paraparë me Ligjin për Mjedis (2009/03-L-025), neni 5, pika 3.2 e këtij ligji, ua përshkruan komunave përgjegjësinë, në bashkëpunim me MMPHI, për përgatitjen e planit, për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të tyre. Kurse, pika 3.5 udhëzon: “Planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës, e aprovon Kuvendi komunal përkatës”. Ndërkaq, në mënyrë më specifike, Neni 24 flet për “Planet e Veprimit Lokal në Mjedis dhe Programet Mjedisore” ku pika 1. Specifikon “Komunat miratojnë planet e veprimit lokal në mjedis ose programe mjedisore për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis sipas interesave specifike të saj”. Gjatë hartimit të këtij Plani janë marrë për bazë edhe kërkesat e Strategjive Nacionale që adresojnë çështjet e mbrojtjes së mjedisit në Kosovë dhe të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, që paraqesin bazën për hartimin e Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis, orientimet strategjike dhe kornizën e veprimeve për mbrojtjen e mjedisit në nivel nacional. Në hartimin e dokumentit janë marrë në konsideratë edhe ligjet e fushës së mjedisit që prekin interesat në nivelin lokal. Një përshkrim i këtyre ligjeve është prezantuar në tabelën 1.

Në hartimin e dokumentit janë marrë në konsideratë edhe ligjet e fushës së mjedisit që prekin interesat në nivelin lokal. Një përshkrim i këtyre ligjeve është prezantuar në tabelën 1.

Shtojcë; Tabela 1. Ligjet, qëllimi dhe fushëveprimi i tyre,

Ligji	Qëllimi dhe fushëveprimi
-------	--------------------------

Ligji nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës	Me këtë ligj rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin, mbrojtjen dhe menaxhimin, planifikimin, mbrojtjen dhe përgjegjësitë institucionale në lidhje me ujërat dhe burimet ujore, duke përfshirë edhe kompetencat e komunave për ujërat.
Ligji nr. 03/L-233 mbi Mbrojtjen e Natyrës	Me këtë ligj përcaktohet sistemi i mbrojtjes dhe ruajtjes së përgjithshme të natyrës (e tërë laramanisë biologjike dhe peisazhore) dhe vlerave të saj, duke përfshirë edhe kompetencat e komunave për mbrojtjen e natyrës.
Ligji nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja	Ky ligj ka për qëllim të rregulloj dhe garantoj të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit. Po ashtu përcakton edhe kompetencat e komunave për menaxhimin e cilësisë së ajrit.
Ligji nr. 02 / L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma	Ky ligj i definon pyjet e Kosovës si resurse kombëtare, andaj ka për qëllim që ato të udhëhiqen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme.
Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale	Ky ligj përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.
Ligji nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike	Ky ligji ka për qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësiave të autoriteteve shtetërore lidhur me marrjen e masave që synojnë zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike, koordinimin dhe monitorimin e rezultateve të tyre, si dhe përmbushjen e detyrimeve sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të detyrueshme për Kosovën.

Ligji nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	Mbrojtja dhe shpëtimi i njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Menaxhimi i fatkeqësive, zvogëlimi i numrit të tyre, parandalimi si dhe zvogëlimi i numrit të viktimave dhe pasojave tjera.
Ligji nr. 08/L-137 për Pyjet	Rregullimi i planifikimit, mbrojtjes, silvikulturës, shfrytëzimin e produkteve drunore dhe jo drunore, pronësinë, shpronësimin, përgjegjësinë organizative dhe detyrat e institucioneve pyjore, financimin publik, hulumtimet në pylltari, mbikëqyrjen, inspektimin dhe sanksionet.
Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina-Shtojca dhe Ligji nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060	Rregullimi i menaxhimit të mbeturinave, planeve për menaxhimin e mjedisit, të drejtat dhe detyrimet e personave të licencuar të cilët merren me menaxhimin e mbeturinave, mënyrat dhe kushtet e mbledhjes së mbeturinave, transportit, trajtimit, përpunimit, magazinimit dhe deponimit përfundimtar, importin, eksportin dhe transitin e mbeturinave, monitorimin, sistemin informativ dhe financimin. Ligji definon edhe kompetencat e komunave për menaxhimin e mbeturinave.

Shtojcë; Tabela 2. Dokumentet Komunale.

Dokumenti	Qëllimi dhe fushëveprimi
Plani Zhvillimor Komunal për Komunën e Klinës 2015-2023	Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Klinës, dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësinore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2010-2015 Komuna e Klinës	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, është dokument planifikimi që rregullon menaxhimin e mjedisit në nivel lokal. Plani synon përmirësimin e gjendjes së mjedisit përmes masave dhe aktiviteteve. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për komunën e Klinës, ka përcaktuar masat dhe aktivitetet në territorin e komunës për periudhën 2010-2015.
Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, Komuna e Klinës	Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave është dokument planifikimi që rregullon Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal. Plani synon shtrirjen e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale në të gjithë territorin e komunës.
Plani Komunal i Veprimit për Eficiência të Energjisë 2019-2021 për Komunën e Klinës	Objekti i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë në objektet publike, transport dhe ndriçim publik, rritja e nivelit të komoditetit, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë si dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Klinës.
Plani Regjional i Trashëgimisë 2012-2015 (Pejë, Klinë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë)	Ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në territorin e Komunave Pejë, Klinë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë.
Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 për komunën e Klinës	Korniza Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale e cila siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Po ashtu, ky dokument siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të Komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.
Harta zonale e komunës së Klinës 2020-2028	Harta Zonale e komunës së Klinës për qëllim kryesor ka trajtimin e zonave për nga aspekti hapësinor. - Të përcaktojë kushtet e përgjithshme për zhvillim për të gjitha zonat, zonat e destinuar

	dhe kushtet zhvillimore përfshirë kushtet ndërtimore, zonat mbishtresore dhe kushtet zhvillimore, rregullat për shfrytëzim dhe zhvillim që ofron mundësi të zhvillimit dhe kufizimeve për qytetarët, pronarët, investitorët dhe institucionet qeveritare. Zbatimi i projekteve kapitale nga: infrastruktura teknike, publike dhe sociale në përgjegjësi të autoriteteve qeverisëse qendrore dhe lokale, në harmoni me buxhetin dhe afatet kohore të dokumenteve të planifikimit hapësinor.
Statuti i Komunës së Klinës	Rregullon organizimin e brendshëm të komunës dhe përcakton përgjegjësitë vetanake të organeve komunale.

1.2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLVM-SË

Qëllimi i përgjithshëm i Planit Lokal për Veprim në Mjedis për komunën e Klinës është që të identifikojë problemet mjedisore, të përcaktojë prirotetet në sektorin e mjedisit dhe të ofrojë zgjidhje për problemet prioritare mjedisore, duke synuar një menaxhim sa më efikas të tyre, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse.

Objektivat specifike të planit janë:

- Të bëjë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm zhvillimor;
- Të identifikojë dhe përcaktojë problemet kryesore mjedisore në territorin e komunës së Klinës;
- Të identifikohen dhe përcaktohen prioritetet kryesore që do të adresohen në kuadër të PLVM-së për periudhën 5 vjeçare;
- Të planifikohen dhe përcaktohen afatet, aktivitetet dhe projektet që do të ndërmerren për adresimin e prioriteteve të identifikuara.

1.3 PROCESI I HARTIMIT TË PLVM-SË

Kryetari i komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, më datë 01.11.2024 ka miratuar vendim për caktimin e Grupit punues për hartimin e PLVM-së, me qëllim që të koordinojë aktivitetet për hartimin dhe miratimin e tij. Si pjesë e aktiviteteve për hartimin e PLVM-së, Grupi Punues nga Komuna e Klinës ka mbajtur disa takime. Takimi i parë i grupit punues është mbajtur më datën 04.11.2024, ndërsa më datën 20.11.2024 është mbajtur takimi i dytë i grupit punues për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.

Gjatë periudhës kohore nëntor-dhjetor 2024, janë mbledhur informatat dhe të dhënat e nevojshme për hartimin e PLVM-së për Komunën e Klinës dhe është përgatitur drafti fillestar i dokumentit.

Më datën 09.12.2024 është mbajtur punëtorja për PLVM të Komunës së Klinës ku është prezantuar gjendja e mjedisit janë identifikuar problemet kryesore mjedisore dhe janë përcaktuar objektivat, prioritetet dhe veprimet për PLVM.

Diskutimet dhe puna në grupe e realizuar gjatë punëtorisë kanë shërbyer për përgatitjen e draftit final të dokumentit të PLVM-së që do të shërbejë për konsultim publik.

1.4.METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PLVM-SË

Metodologjia e hartimit të PLVM-së dhe përcaktimit të prioriteteve të tij është orientuar duke u bazuar në proceset si vijon:

- Identifikimin e presioneve kryesore në mjedisin e komunës së Klinës, që vijnë nga sektorët e ndryshëm zhvillimorë bazuar në të dhënat ekzistuese dhe trendet e tyre.
- Analizën e gjendjes ekszituese të mjedisit në Komunën e Klinës ku është bërë prezantimi i gjendjes aktuale mjedisore bazuar në të dhënat në dispozicion. Në kuadër të analizës së gjendjes është prezantuar gjendja e sektorëve zhvillimorë të komunës dhe gjendja e mjedisit në komunë. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore që ka komuna dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm.
- Identifikimi i problemeve kryesore mjedisore të cilat do të trajtohen për zgjidhje në kuadër të PLVM-së duke marrë për bazë kapacitetet financiare dhe zhvillimore të komunës dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre.
- Duke u bazuar në këto probleme mjedisore janë përcaktuar prioritetet mjedisore për periudhën 5 vjeçare dhe janë grupuar ato sipas tematikave përkatëse mjedisore.
- Bazuar në prioritetet kryesore mjedisore është propozuar edhe plani i veprimeve për përmbushjen e këtyre prioriteteve, që do t'i shërbejnë komunës për të hartuar projektet konkrete të mbështetura nga buxheti i komunës apo nga sigurimi i fondeve nga donatorët.
- Për të siguruar një implementim më efikas të PLVM-së është propozuar Planin e monitorimit për zbatimin e tij.

“VIZIONI PËR KLINËN”

Një komunë e gjelbër, e qëndrueshme dhe e zhvilluar, ku turizmi, biodiversiteti dhe burimet natyrore mbrohen, ndotja minimizohet dhe komuniteti angazhohet vazhdimisht për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.”

2.PROFILI I KOMUNËS

2.1.Pozita gjeografike dhe organizimi administrativ

Komuna e Klinës shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës apo në pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit. Ka një sipërfaqe prej 308.8 km² dhe përbëhet nga zona urbane e Klinës dhe 54 fshatra. Gjendet rreth 55 km në perëndim të Prishtinës dhe kufizohet me shtatë komuna: në veri kufizohet me Istogun, në lindje me Skenderajn dhe Drenasin, në jug me Malishevën, Rahovecin dhe Gjakovën, ndërsa në perëndim me Pejën. Pozita e mirë gjeografike në të cilën shtrihet komuna e Klinës i mundëson lidhje të mira me qendrat e tjera të Kosovës.

Pozita natyrore dhe konfiguracioni mundësojnë që Klina të ketë lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore. Nëpër Klinë kalon rruga magjistrale Prishtinë-Klinë-Pejë, rruga Klinë-Skenderaj, Mitrovicë, Klinë-Istog-Pejë, si dhe vijat hekurudhore Fushë Kosovë-Klinë-Pejë dhe Fushë Kosovë-Klinë-Prizren. Qendra komunale e Klinës ka një specifikë të veçantë, sepse ndodhet në mesin e të gjitha fshatrave të saj dhe distanca më e largët nga qendra komunale është vetëm 12 km. Gjithashtu, struktura e qendrave institucionale është e rregulluar me qasje të mirë dhe të shpejtë. Magjistrerja Prishtinë – Pejë kalon pranë këtij qyteti. Me Prishtinën (55 km) dhe Pejën (30 km) lidhet përmes kësaj rruge. Gjithashtu, kjo rrugë e lidh edhe me aeroportin e Prishtinës në një largësi prej 48 km. Relievi i komunës së Klinës ndryshon mes pjesës lindore dhe asaj perëndimore. Në pjesën perëndimore dhe qendrore të komunës dominon terren më i rrafshët (deri 500 m lartësi mbidetare), ndërsa pjesa veriore dhe verilindore është më e lartë (500-700 m të lartësisë mbidetare). Dominon kryesisht klima e butë kontinentale me ndikimin dhe depërtimin e klimës mesdhetare përmes luginës së Drinit, me temperatura mesatare vjetore 10.8 °C. Nëpër territorin e komunës së Klinës rrjedhin gjashtë lumenj: Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Klina, Mirusha, Lumi i Istogut dhe lumëbardhi i Deçanit. Prej tyre katër kanë rrjedhë fushore dhe me ndërtimin e

ujënxënieve (pendave) përgjatë rrjedhës së tyre do të mund të ujiteshin deri në 2.000 ha toka bujqësore. Me realizimin e projekteve për ndërtimin e kanaleve të ujitjes dhe pendave deri më tani ujiten rreth 1200 ha tokë bujqësore. Në territorin e komunës së Klinës janë hulumtuar rezerva të nevojshme për zhvillimin e mihjeve të mëdha të thëngjillit, të rezervave të boksitit, zhavorrit dhe argjilës për prodhim të tullave.

Sipas organizimit administrativ në komunën e Klinës, ekzistojnë 54 vendbanime gjithsej, të cilat shtrihen në 43 zona kadastrale.

Në kontekst të madhësisë së vendbanimeve në raport me numrin e banorëve, në komunën e Klinës kemi këto grupe të vendbanimeve:

- Vendbanime shumë të vogla rurale (0-199 banorë) janë gjithsej 8 vendbanime,
- Vendbanime të vogla rurale (200-499 banorë) janë gjithsej 21 vendbanime,
- Vendbanime të mesme të vogla rurale (500-999 banorë) janë gjithsej 15 vendbanime,
- Vendbanime të mesme të mëdha rurale (1,000-2,499 banorë) janë 9 vendbanime,
- Vendbanime të mëdha rurale (2,500-4,999 banorë) nuk ka në komunën e Klinës.
- Vendbanime me mbi 5,000 banorë: vetëm Klina me 5,542 banorë.

Në komunën e Klinës ekzistojnë 54 vendbanime gjithsej e të cilat shtrihen në 43 zona kadastrale.

Nr.	Zona Kadastrale	Shifra	Ha	Ari	m ²
1	Berkovë	71006004	490	59	69
2	Binqë	71006005	1143	94	53
3	Bokshiq	71011007	539	93	81
4	Budisalc	71011011	428	65	22
5	Çabiç	71010080	873	34	15
6	Caravik	71010077	579	39	63
7	Çeshkovë	71011089	336	77	29
8	Çupevë	71010082	352	93	73
9	Deis	71011065	97	73	86
10	Ujmirë/ Dobrovodë	71010019	331	45	92
11	Dobërdol	71010020	454	33	73
12	Dollc	71010022	475	17	61
13	Dollovë	71011026	352	93	47
14	Poterq I poshtem/ Petriq i Ultë	71011027	612	58	54
15	Drenoc	71011030	807	20	14
16	Dranashiq	71006011	976	85	19
17	Dresnik	71010027	1523	75	79
18	Dugajevë	71011034	576	39	63
19	Dush	71006015	1604	93	39
20	Dushi I vogel/ Dusheviq	71010028	413	63	41
21	Poterq I eperm/ Petriq i Epërm	71011021	395	59	44
22	Grabanicë	71011023	550	75	72
23	Gremnik	71010017	758	59	65

24	Gllarevë	71010034	1561	96	18
25	Jagodë	71011040	222	54	72
26	Jashanicë	71006021	1491	13	46
27	Klinë	71006024	591	48	72
28	Klinavc/ Klinafc	71006025	1051	11	40
29	Kpuz	71011046	1160	88	23
30	Nagllavë	71011062	386	76	21
31	Perçevë /Prçevë	71010065	993	38	71
32	Rudicë	71006043	241	10	75
33	Siqevë	71006045	785	89	41
34	Stupë	71011082	232	67	81
35	Shtupel	71006059	1161	81	00
36	Sverkë	71010072	1594	28	74
37	Krushevë	71011049	643	17	21
38	Gjurgjevik	71010029	1217	69	87
39	Videjë	71010014	849	39	34
40	Volljak	71010010	695	86	96
41	Zabërgjë	71010030	236	89	70
42	Zajm	71011066	482	23	31
43	Zllakuqan	71006019	625	59	01
	GJITHSEJ		30880	50	55




Figura 1. Pozita Gjeografike e Komunës së Klinës në Hartën e Republikës së Kosovës

2.2 Kushtet klimatike dhe relievi

Territori i komunës së Klinës ka një relievi mjaft të përshtatshëm pasi që shtrihet në një hapësirë relativisht të rrafshët. Në pjesën qendrore të komunës dominojnë rrafshirat me lartësi deri në 400 m, ndërsa pjesët më të ngritura të relievit janë të pozicionuara në anën juglindore me lartësi mbi 700 m. Komuna e Klinës si hapësirë gjeografike në kuadër të territor të saj, lartësitë deri në 600 m janë afro 90% e territorit.

Klina shtrihet në kuadër të basenit të Dukagjinit dhe në territorin e saj ka mjaftë tokë pjellore e sipërfaqe pyjore (si pjesa e maleve të Grebnikut). Në kuadër të pjesës ultësinore janë formuar dhe terrene aluviale të lumenjëve që rrjedhin në këtë hapësirë si Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Lumëbardhi i Deçanit, lumi Mirusha, lumi Klina.

Tabela 2. Sipërfaqja e Komunës së Klinës sipas Lartësisë Mbidetare

Klinës kryesisht merren nga stacioni meteorologjik në Pejë dhe Gjakovë, pasi në territorin e komunës së Klinës nuk ka stacion meteorologjik.

Temperatura e ajrit – Sipas të dhënave për vitin 2020, temperatura mesatare vjetore në komunën e Klinës është 12.2°C. Nëse krahasohet me temperaturat para 10 viteve, arrijmë në konkludim se nuk kemi ndonjë ndryshim të theksuar të temperaturave mesatare vjetore, pasi që temperatura në vitin 2010 ishte 12°C, në vitet 1990 ishte 11.7 °C. Në kuadër të komunës së Klinës sipas të dhënave të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, kalojnë izotermat 10°C dhe 9°C.

Temperaturat më të ulëta janë gjatë muajit dhjetor dhe janar, ku gjatë vitit 2020 temperaturat ishin -7.6°C. Muajt më të nxehtë janë qershori dhe korriku, në të cilët gjatë vitit 2020 temperaturat maksimale që janë regjistruar ishin 33.9°C

Dielllosja ose Insolacioni – Është element klimatik që ka ndikim në veprimtaritë e ndryshme ekonomike (bujqësi, turizëm, mjekësi) etj. Zgjatja e dielllosjes varet nga faktorët astronomikë, meteorologjikë dhe nga relievi. Dielllosja është më e vogël në luginat të ngushta dhe grykat lumore si dhe në viset malore për shkak të rritjes së vranësirave me rritjen e lartësisë mbidetare. Në bazë të vrojtimeve të diellzimit në katër stacionet meteorologjike (Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Pejë), Kosova ka mesatarisht 2066 orë me diell gjatë vitit ose mesatarisht 5.7 orë në ditë. Vlerën më të madhe të dielllosjes e ka Prishtina me 2140 orë në vit, Peja me 1958 orë, Ferizaj 2067 orë dhe Prizreni me 2099 orë me diell gjatë vitit. Gjatë vitit në muajin korrik ka më së shumti dielllosje, kurse në dhjetor më së paku.

Erërat – Pozita gjeografike e komunës së Klinës, konsiston më një hapësirë e cila përballet kryesisht me erëra që kanë drejtim dominues nga veriu dhe veriperëndimi. Nga kuadranti verior dhe veriperëndimor, shpejtësia e erërave është prej 4 – 10 m/s ndërsa nga kuadranti juglindor dhe lindor shpejtësia e erërave arrin prej 2 – 8 m/s. Pra, konstatohet që drejtimet dominuese të erërave janë kryesisht nga ai verior, veriperëndimor, lindor e juglindor.

Bazuar në vjetarin hidrometeorologjik të Kosovës, konstatohet që drejtimi i erërave gjatë muajve janar, shkurt, mars, prill e qershor kanë pasur drejtim lindje e juglindje, ndërsa gjatë muajve korrik, gusht kanë pasur drejtim perëndim, ndërsa në muajt gusht, shtator, tetor, nëntor e dhjetor drejtimi i erërave ishte veri, veri-verilindje dhe veri-veriperëndim.

Reshjet – Sipas të dhënave për vitin 2020, në komunën e Klinës janë regjistruar gjithsej 954.2 mm reshje. Numri i ditëve me reshje ishte 99 ditë. Sasia më e madhe e reshjeve është regjistruar në muajt shtator, nëntor dhe dhjetor. Shpërndarja e reshjeve në komunën e Klinës është pothuajse e njëtrajtshme, pasi konfiguracioni i terrenit nuk është shumë i theksuar.

Në pjesën më të madhe të territorit të Klinës diminojnë izohijet me vlera 700 mm. Ndërsa në drejtim të veriut dhe perëndimit sasia e reshjeve rritet deri në 800 mm.




Figura 3. Harta e reshjeve në Komunën e Klinës




Figura 4. Ekspozicioni i terrenit në komunën e Klinës

Nga harta e paraqitur më lartë, evidentohet se në komunën e Klinës dominojnë territore me ekspozicion lindje, juglindje, jug e jugperëndim. Këto ekspozicione përfshijnë afro 60% të territorit të komunës. Pjesa tjetër ka kryesisht ekspozicion verior e veriperëndimor. Pjesët e rrafshëta kryesisht janë të evidentuara në pjesën veriperëndimore të komunës dhe pjesën qendrore të saj.

Element shumë i rëndësishëm i relievit është edhe pjerrësia e terrenit. Në kuadër të territorit të Klinës, terrenet e buta deri në 5 shkallë janë të evidentuara në pjesën qendrore të komunës afër rrjedhave lumore, ndërsa pjesët periferike të komunës, si mali Gremnik, janë territore më pjerrësi të theksuar të terrenit.

Shtrirja e komunës së Klinës sipas pjerrtësisë së terrenit

Rol të rëndësishëm në shfrytëzimin e terrenit për nevoja të ndryshme, si bujqësi, turizëm, ndërtim, ka edhe valorizimi i terrenit sipas pjerrtësisë. Bazuar në analizat morfologjike të terrenit, rezulton

që ka afro 70% të sipërfaqeve (242.28 km²) të komunës së Klinës janë terrene të rrafshëta, apo hapësira deri në 8°. Hapësirat në të cilat gjenden këto terrene janë në shtratin e lumit Drini i Bardhë (zonat kadastrale Stupë, Budisalc, Jagodë, Deiq), pjesën fundore të lumit Klina (zonat kadastrale Dresnik – perëndim), hapësirat përgjat shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës (Zonat kadastrale Dugajevë, Grabanicë).

Tabela 3. Klasifikimi i terrenit në Komunën e Klinës sipas pjerrtësisë së terrenit.

Pjerrësia	Sipërfaqja (km ²)	Përqindja	Tipi I relievit
<1°	17.71	5.74	Rrafshirë (fushë)
1 - 3°	79.57	25.78	Terren shumë pak i pjerrët
3 - 5°	68.77	22.28	Terren pak i pjerrët
5 - 8°	82.28	26.66	Terren relativisht i pjerrët
8 - 12°	46.55	15.08	Terren dukshëm i pjerrët
12 - 16°	9.6	3.11	Terren shumë i pjerrët
16 - 20°	2.41	0.78	Terren i rrëpirët
20 - 30°	1.56	0.51	Terren mesatarisht i rrëpirët
30 - 40°	0.142	0.05	Terren shumë i rrëpirët
>40°	0.017	0.01	
	308.60	100.00	

Terren dukshëm të pjerrët (8-12°) deri në terrene mesatarisht të rrëpirët (30°) janë 19.29% e territorit të komunës, të cilat përfshijnë terrenet në zonat kadastrale Dresnik, Dollc, Gremnik, Qupevë, Volljakë. Terrenet të cilat konsiderohen si shumë të pjerrëta përfshijnë disa zona ndërmjet zonës kadastrale Klinafç dhe Dresnik, Ujmirë etj. Këto terrene kanë sipërfaqe afro 1 km² apo 0.06% të territorit të komunës së Klinës.




Figura 5. Pjerrtësia e terrenit në komunën e Klinës.

2.3. Struktura gjeologjike dhe formacionet pedologjike.

Gjeologjia: Territori i Komunës së Klinës në aspektin gjeologjik është mjaft kompleks. Në ndërtimin gjeologjik të hapësirës së saj janë të pranishme formacione gjeologjike të moshave të ndryshme, kryesisht nga ato më të reja të periudhës së Kuaternarit (përfaqësohen nga avluvionet e rërës dhe argjilës) dhe atyre me moshë më të vjetër, kryesisht të përfaqësuara nga shkëmbinjë e triasikut dhe jurasikut të mesëm (piroksenite pjesërisht të serpentizuara). Hulumtimet gjeologjike në territorin e komunës së Klinës janë kryer në kuadër të hulumtimeve për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të territorit të komunës së Klinës janë zhvilluar procese të ndryshme gjeologjike, të cilat kanë krijuar mineralizime të ndryshme, si ajo e gëlqerës në Volljakë.

Përbërja pedologjike: Sipas përbërjes pedologjike, tokat në territorin e Komunës së Klinës janë të përfaqësuara si në vijim: Tokat minerale moqalore, Tokat aluviale, Tokat delivuale, Tokat e mesme të kuqërremta, Tokat e murrme në shtresa kompakte, Tokat e murrme argjilore, Rankeri, Smonica etj.




Figura 6.Harta gjeologjike e Komunës së Klinës.




Figura 7. Harta Pedologjike e komunës së Klinës.

2.4. Infrastruktura

Infrastruktura e ujësjellësit

Skema e furnizimit me ujë në komunën e Klinës përbëhet nga katër sisteme si më poshtë: • Nga fabrika e përpunimit të ujit në qytetin e Klinës furnizohen qyteti i Klinës (rreth 70%) dhe fshatrat Zajm, Videjë, Jagodë (70%) dhe Deiq-Polce.

- Nga burimi e Jarinës furnizohet një pjesë e qytetit (rreth 30%) dhe fshatrat e anës veriore: Klinafç, Pograxhë, Dresnik, Dollc, Gjurgjevik i Madh (50%), Ujmirë, Dush-Jelloç, Siqevë, Jashanicë, Shtupel, Kërrnicë dhe Binxhë-Grapiç.
- Nga burimi i Garabilit furnizohen fshatrat: Sferkë, Volljakë, Qupevë e Lartë dhe Dush i Vogël. Një pjesë e fshatrave të komunës së Klinës furnizohen me puse vetanake dhe ato janë si më poshtë:

Pusi i Këpuzit që furnizon fshatrat Këpuz dhe Qeskovë.

- Pusi Berkovës që furnizon fshatin Berkovë.
- Pusi i Dollovës që furnizon fshatin Dollovë.

Disa fshatra tjera janë të lidhura në sistemet e ujësjellësit të Pejës dhe të Istogut, si më poshtë:

- Nga sistemi i Pejës furnizohen fshatrat Stupë dhe Pjetërq i Epërm
- Nga sistemi i Istogut furnizohet fshati Rudicë
- Jarina 2, që do të furnizojë fshatrat: Caravik, Gllarevë, Stapanicë-Rixhevë, Zabërgjë, Çabiq, Gjurgjevik i Madh, Përçevë, Dobërdol dhe Gjurgjevik i Vogël.
- Nga pusi i Budisalcit i cili aktualisht është në prag të funksionalizimit dhe i cili do të furnizojë fshatrat: Budisalc, Nagllavë, Krushevë e Madhe dhe një pjesë e fshatit Jagodë (30%). Bazuar në statistikën e raportit të performancës komunale, rreth 75% e vendbanimeve, përfshirë edhe qytetin e Klinës furnizohen me ujë nga KRU “Hidrodrini” dhe nga sistemet e pompimit, ndërsa 25% nga puset individuale. Gjatë vitit 2020 është investuar në sigurimin e burimit të ujit dhe instalimin e rrjetit dhe pompave në Qupevën e Lartë dhe Ulët, Volljakë, ndërsa banorët kanë investuar në ndërtimin e rezervuarit të ujit. Ky investim do të ndikojë edhe në stabilizimin me furnizim me ujë gjatë gjithë vitit në fshatin Dush dhe Sferkë. Në vitin 2019 është hartuar projekti i ujit të pijshëm. Ky projekt, pas përfundimit të studimeve të fizibilitetit, vlerëson se burimi i ujit në rrjedhën e shtratit të lumit “Drini i Bardhë” siguron 300 litra ujë të pijshëm për sekondë, i cili do të jetë i mjaftueshëm për banorët e komunës së Klinës, si dhe për 20,000 banorët jo rezidentë,

të cilët kalojnë kohë të caktuar gjatë vitit në vendlindje. Kostoja e projektit sipas studimit do të arrijë deri në 3.5 milionë euro dhe është aprovuar në Asamblenë Komunale.

Në vitin 2020 ka filluar implementimi i fazës së parë: “Ndërtimi i Liqenit Akumulues dhe hapja e puseve për ujë të pijes”. Punimet janë realizuar sipas projektit, mirëpo rezultatet e pritura nuk ishin të kënaqshme. Është vazhduar me fazën e dytë: “Ndërtimi i basenit Filtrues për shtimin e kapaciteteve të ujit në fabrikën e ujit në Klinë” Qyteti dhe territori i Klinës mund të cilësohen si zonë me resurse të pakta ujore dhe me probleme të vazhdueshme të mbulimit të nevojave në rritje të qytetarëve të saj. Sistemet ekzistuese janë sisteme që kryesisht shfrytëzojnë pompat për furnizimin e banorëve dhe rrjedhimisht edhe kostoja e prodhimit të ujit është më e lartë në raport me vendet tjera që furnizohen me gravitet. Gjendja e stacioneve të pompimit dhe e rezervuarëve ekzistuese, përgjithësisht mund të konsiderohet e mirë, mirëpo këto janë objekte që vazhdimisht kërkojnë mirëmbajtje cilësore si dhe investime në rehabilitimin e tyre. Pompat furnizuese, si dhe filtrat e teknologjisë së lartë, janë pajisje që kërkojnë kujdes profesional dhe në baza ditore nga ekspertët e KRU “Hidrodrini”.

Infrastruktura e kanalizimit

Pothuajse si të gjitha komunat e Kosovës, edhe komuna e Klinës përballlet me një situatë të vështirë të menaxhimit të ujërave të zeza dhe trajtimit të tyre. Objektivi i përgjithshëm i heqjes/depozitimit higjienik dhe adekuat mjedisor të ujërave të zeza në Klinë mund të arrihet në mënyrë të qëndrueshme vetëm nëse KRU përkatëse do të jetë në gjendje të operojë dhe mirëmbajë objektet dhe pajisjet në mënyrë të duhur dhe afatgjatë. Ujërat e zeza shtëpiake në shumicën e qyteteve të mëdha të Kosovës grumbullohen përmes amvisërive dhe shkarkohet jashtë qyteteve - në një distancë të caktuar nga shtëpitë në lumin më të afërt. Shumica e ujërave të zeza në qytetin e Klinës barten përmes tre kolektorëve kryesorë: Dy prej tyre shtrihen përgjatë rrugës kryesore të qytetit (në të dy anët e tij) duke mbledhur ujërat e zeza nga pjesa më e madhe e qytetit. Kolektori i tretë është ndërtuar në pjesën perëndimore të qytetit i cili më pas bashkohet me pjesën e poshtme të qytetit. Këta tre kolektorë rrjedhin nga graviteti drejt lumit Klina dhe shkarkohen aty në tre pika shkarkimi pa asnjë trajtim paraprak. Kolektorët kryesorë në zonën e qendrës së qytetit janë me diametër DN 250 mm, ndërsa një masë e konsiderueshme kërkohet ndërhyrja në riparimin e tyre. Shumica e objekteve të banimit kolektiv, objekte publike dhe shtëpitë individuale përfshihen në kolektor. Ana perëndimore e qytetit ka gjithashtu një kolektor të rregulluar përgjatë pjesës së

urbanizuar. Kolektorët (tubat) janë me diametër DN 160; DN 200 dhe DN 250. Cilësia e ndërtimit është e kënaqshme dhe gjithashtu ujërat atmosferike ndahen dhe mblidhen përmes kolektorit me diametri DN 500 dhe DN 600. Të gjitha ujërat e ndotura të zonës urbane derdhen në lumin Klina në 3 pika shkarkimi, dhe ndotja ekologjike është një shqetësim i vazhdueshëm për atë zonë. Përveç këtyre kolektorëve, në pjesën jugore të qytetit është ndërtuar një kolektor tjetër (DN 200 dhe DN 250) dhe mbledh ujërat e zeza nga zona në anën e djathtë në hyrje të qytetit. Pika e shkarkimit të këtij kolektori është gjithashtu pa asnjë trajtim dhe derdhet në lumin Drini i Bardhë.

Sipas analizave që kanë dalë nga dokumenti i studimit “Situata aktuale dhe propozimet për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Klinës”, i realizuar në bashkëpunim ndërmjet Komunës së Klinës me KRU “Hidrodrini”, njësia në Klinë, janë identifikuar disa probleme me rrjetin e kolektorëve në të cilin është një ndërhyrje në rehabilitim dhe nevojiten të zgjerohen dhe veçojnë ujërat e zeza nga ato atmosferike. Kolektorët nuk janë ndërtuar në cilësi më të mirë, për rrjedhojë ka edhe depërtim të ujit në puse. Në shumë raste të kolektorëve të ujërave të zeza nuk janë të ndarë nga ata atmosferikë. Përveç kësaj, në mënyrë të paligjshme ose të pakontrolluara janë bërë lidhje, gjë që ka dëmtuar më tej infrastrukturën në qytet. Një tjetër problem shqetësues është hedhja e mbeturinave inerte të ndryshme në rrjetin e kanalizimeve nga banorë të papërgjegjshëm, gjë që shpesh shkakton mbylljen e kolektorëve, ku ndërhyrja e KRU “Hidrodrini” nevojitet për zhblokimin dhe vënien në funksion të tyre. Një problem tjetër është shkaktuar në rastet kur ka përmytje; në disa zona uji del nga puset dhe shkakton ndotje dhe problem higjienik në atë zonë.

Ujitja dhe drenazhimi

Sistemi i shkarkimit të ujërave atmosferike duhet të jetë i ndarë nga ai i kanalizimit të ujërave të zeza. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në zonat e varrezave. Për mbrojtjen e rrjedhave natyrore të lumenjve, është e nevojshme të kontrollohen të gjitha shkarkimet dhe të bëhet një inventar i ndotësve. Në zona ku nuk ka ujë sipërfaqësor apo nëntokësor (si rrafshnaltat dhe majat e maleve), uji atmosferik mund të shfrytëzohet për furnizimin e amvisërive. Ky ujë, megjithëse shumë i butë dhe jo i përshtatshëm për konsum si pije, është i mjaftueshëm për përdorime të tjera të përditshme. Uji nga shiu dhe bora mund të grumbullohet nga kulmet e ndërtesave ose nga sipërfaqet e specializuara, dhe përmes rezervuarëve mund të përdoret për qëllime të ndryshme. Trasa e rrjetit të kanalizimit atmosferik duhet të ndërtohet më e cekët se ajo e kanalizimit të ujërave të zeza dhe industriale. Me qëllim të ruajtjes së burimeve të

ujit të pijshëm dhe rritjes së kapaciteteve ujore brenda zonës komunale, Komuna e Klinës do të duhet të vendosë kushte të reja zhvillimore për ndërtimin e rezervuarëve grumbullues të ujit atmosferik (ujë teknik) në planifikimet e saj urbane. Uji i grumbulluar nga çatitë e ndërtesave do të drejtohet në rezervuarët brenda parcelës ndërtuese, dhe do të mund të shfrytëzohet për ujitjen e parqeve, larjen e rrugëve dhe trotuareve, shuarjen e zjarreve, si dhe për nevoja të tjera komunale.

Furnizimi me energji elektrike

Klina me rrethinë furnizohet nga nënstacioni KLINA 110/10 kV/kV me fuqi instaluese prej 31.5 MVA. Trafostacionet të cilat furnizohen nga e njëjta kyqje e nënstacionit KLINA vazhdojnë të furnizohen nga TS 35/10 kV/kV me fuqi 2x8 MVA me furnizime të linjave 10(20)kV në drejtimet e fshatrave: Budisalc, Zllakuqan, Jagodë, Drenoc, Grabanicë, Këpuz, Dolc, Volljakë, Sferkë, Caravik, Ujmirë, Jashanicë dhe Shtupel. Rrjeti elektrik i përçuesve ajror dhe kabllor për nivelin e tensionit 10(20)/04 kV/kV i Komunës së Klinës është i shtrirë në të gjitha vendbanimet e Komunës.

Klina me fshatrat e afërta posedon 12,988 Konsumatorë Rezidencialë dhe Komercialë. Linjat Furnizuese janë nga nënstacioni i Linjës së TS 220/110 kV/kV Nashec nëpërmjet Gjakovës në nivelin 110kV. Në Klinë ekziston nënstacioni i KOSTIT TS 110/10kV/kV me fuqi transformatorike 31.5MVA dhe 12 dalje në nivelin 10KV, ndërsa në nivelin e DS KLINA ekziston TS 35/10 kV në punë paralele me dy transformatorë energjetik me fuqi instaluese 8 MVA dhe 5 dalje të nivelit 10 kV.

Transporti

Transporti publik me autobus është mjeti kryesor i udhëtimit për qytetarët e Klinës, veçanërisht për ata që udhëtojnë në qytete të tjera për punë apo shërbime. Ekzistojnë linja të rregullta autobusësh që lidhin Klinën me Prishtinën, Pejën dhe qytete të tjera kryesore. Megjithatë, frekuenca dhe cilësia e këtyre shërbimeve mund të përmirësohen, duke rritur përballueshmërinë dhe komoditetin për udhëtarët.

Sa i përket Transportit Urban, Klina nuk ka një sistem të zhvilluar të transportit urban brenda qytetit. Lëvizjet brenda qytetit kryhen kryesisht me automjete private ose taksi, ndërsa transporti publik brenda qytetit është i kufizuar.

Klina ka lidhje të mira edhe përmes hekurudhës, duke qenë se në Klinë gjendet nyja e dytë hekurudhore e Kosovës, pas asaj në Fushë Kosovë. Në këtë nyje degëzohen drejtimet për Pejë dhe Prizren të cilat përmes Klinës lidhen me Fushë Kosovën për t'u degëzuar më tej për Shkup, Nish apo Beograd.

2.5.Shëndeti Publik dhe Mirëqenia Sociale

Në komunën e Klinës, shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, si dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lëmive të specializuara mjekësore. Në sektorin publik, kujdesi shëndetësor është i organizuar në 14 institucione shëndetësore të mjekësisë familjare:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në qytetin e Klinës;
- 3 Qendra të Mjekësisë Familjare në Ujmirë (objekti i ri dhe ai i vjetër), Zllakuqan dhe Sferkë;
- 10 Ambulanta të Mjekësisë familjare të organizuara në vendbanimet Jashanicë e Ulët, Jashanicë e Epërme, Shtupel (objekti i vjetër dhe objekti i ri), Leskoc, Budisalc, Jagodë, Drenoc, Grabanicë, Gllarevë dhe Caravik;
- Ekzistojnë edhe dy ambulanta të tjera në fashtrat Dranashiq dhe Berkovë por ato nuk janë funksionale.

Për problemet e shumta sociale në Komunën e Klinës, kryesisht përkujdesen Qendra për Punë Sociale dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. QPS merret me: Mbrojtjen Sociale të Fëmijëve dhe Rinisë, përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, mbrojtjen e

fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta dhe atyre me sjellje të çrregulluara, mbrojtjen sociale të të rriturve në nevojë për kujdes social etj.

2.6.Arsimi

Niveli i shkollimit të popullsisë është një faktor mjaft i rëndësishëm që ndikon në zhvillimin e shumë fushave socio-ekonomike. Është analizuar niveli i shkollimit të popullsisë mbi 10 vjeç ku numri i përgjithshëm i tyre është 34,560 banorë.

Sipas të dhënave nga PZHK, vërehet se pjesa më e madhe e popullsisë së komunës së Klinës është me shkollim të mesëm të ulët dhe shkollim të mesëm të lartë. Me këtë nivel të shkollimit janë gjithsej 19,821 banorë apo rreth 57 %. Vetëm me shkollim të mesëm të ulët janë 12,704 persona apo rreth 36%, ndërsa me shkollim të mesëm të lartë janë 7,117 persona apo rreth 20%. Është me rëndësi të theksohet se në komunë kemi një numër të konsiderueshëm edhe të personave që janë të diplomuar dhe me diploma pasuniversitare. Numri i tyre është gjithsej 1831 apo mbi 5%.

2.7.Trashëgimia kulturore

Komuna e Klinës karakterizohet me një trashëgimi të pasur arkeologjike dhe arkitekturore. Kjo trashëgimi kulturore është pjesë integrale e peizazhit në të gjitha vendbanimet urbane dhe rurale dhe formëson një mozaik të pasur të kulturës tradicionale të praktikuar ndër breza e mileniume.

Bazuar në shënimet e Zyrës për Trashëgimi Kulturore në Klinë, si dhe Listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (për periudhën 06.10.2023-06.10.2024) e aprovuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 06.10.2023, kjo përfshin këto Asete të Trashëgimisë Kulturore nga Komuna e Klinës:

- Trashëgimi arkitekturore - 18 asete;
- Trashëgimi Lokalitete arkeologjike - 13 asete;
- Trashëgimi arkeologjike -10 asete;
- Zona të veçanta të mbrojtura, 2 asete.




Figura 8. Lokaliteti arkeologjik i Dresnikut-Qyteti Antik



Figura 9. Asetet e Trashëgimisë Kulturore

3.Presionet në mjedis

3.1.Popullsia dhe vendbanimet

Komuna e Klinës ka pasur rritje të numrit të popullsisë dhe ekonomive familjare nga viti 1948 deri në vitin 2011. Në vitin 1948 kishte 20,665 banorë dhe 2,980 ekonomi familjare. Ndërsa në vitin 2011 kishte 38,496 banorë dhe 5,843 ekonomi familjare. Gjatë kësaj periudhe 63 vjeçare, popullsia e komunës së Klinës është rritur për 17,831 banorë dhe 2,863 ekonomi familjare. Qyteti i Klinës ka shënuar një rritje të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe, ku popullsia gati është nëntëfishuar. Në qytet jetojnë rreth 14% e popullsisë dhe rreth 17 % e ekonomive familjare të gjithë komunës. Madhësia mesatare e familjes është më e madhe në vendbanimet rurale se në qytetin e Klinës. Në qytet është 5.4 anëtarë për familje dhe në vendbanimet rurale është 6.5 anëtarë.

Sipas organizimit administrativ, në komunën e Klinës ekzistojnë 54 vendbanime gjithsej, të cilat shtrihen në 43 zona kadastrale.

Shërbimet arsimore: Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Klinës përbëhet nga katër nivele: arsimi parashkollor (për fëmijët 5-6 vjeç), arsimi fillor (klasat I – V), arsimi i mesëm i ulët (klasat VI – IX) dhe arsimi i mesëm i lartë (klasat X – XII). Në komunë ekzistojnë gjithsej 26 shkolla fillore të mesme të ulëta. Po ashtu, janë edhe dy objekte shkollore që përfshijnë shkollat e mesme publike dhe private, si dhe një çerdhe publike dhe një private. Nga 26 shkolla fillore, 18 janë shkolla amë dhe 8 janë shkolla satelite (paralele të ndara). Në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar gjithsej 409 mësime, ndërsa numri total i nxënësve në të gjitha nivelet është 6,096, që i bie mesatarisht 14.9 nxënës për mësime.

3.2. Industria dhe Bizneset

Sipas të dhënave të ARBK-së për vitin 2023, në Komunën e Klinës aktualisht operojnë 1,510 ndërmarrje biznesore aktive. Nga ky total i ndërmarrjeve aktive, 1,500 (apo 99.4%) ndërmarrje janë në pronësi private, 5 ndërmarrje (0.3 %) janë në pronësi komunale, si dhe 5 ndërmarrje janë në pronësi publike.

Sa i përket numrit të punësuarve, ndërmarrjet private në komunën e Klinës punësojnë 13,568 punëtorë, apo 89.4 % të totalit të punëtorëve në komunë (16,663). Ndërmarrjet Publike-Komunale punësojnë 1,415 punëtorë, apo 8 % të totalit të punëtorëve në komunë. Ndërsam ndërmarrjet Publike Shoqërore punësojnë vetëm 265 punëtorë, apo 1.6 % të totalit të punëtorëve në komunën e Klinës.

Spektori me pjesëmarrjen më të madhe të bizneseve është sektori i Tregtisë me Shumicë dhe Pakicë. Në këtë sektor operojnë gjithsej 343 biznese, apo 23 % e numrit total të bizneseve aktive në vitin 2023. Spektori i dytë me numrin më të madh të bizneseve është sektori i Akomodimit dhe Aktiviteteve të Shërbimit të Ushqimit me 262 biznese aktive, apo 17 % të të gjitha bizneseve aktive në vitin 2023. Ky sektor përcjellet nga sektori i Aktiviteteve Shërbyese me 212 biznese, apo 14 % të të gjitha bizneseve aktive. Në këtë sektor punojnë 853 punëtorë, apo 5.1 % e numrit total të punësuarve në komunën e Klinës.

Duke u bazuar në sistemin për Regjistrimin e Bizneseve në Komunën e Klinës në vitin 2024 operojnë këto lloje të bizneseve të paraqitura në tabelat 3 dhe 4.

Tabela 4. Të dhëna sipas ARBK-së në Klinë

Nr.	Lloji i biznesit	Nr.i Bizneseve %	
1	Biznes Individual B.I.	972	57.9%
2	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar SH.P.K	687	40.9%
3	Ortakëri të Përgjithshme O.P.	10	0.59%
4	Kooperativa Bujqësore K.B	7	0.41%
5	Ndërmarrje Shoqërore N.SH.	1	0.059%

Numri total i Bizneseve aktive që operojnë në Komunën e Klinës është 1677.

Ndërsa 10 aktivitetet që shërbehen më së shumti nga Bizneset në Komunën e Klinës janë:

Tabela 5. Të dhëna sipas ARBK-së në Klinë

Totali 1372

Nr.	Lloji i Aktivitetit	Nr.i bizneseve	%
1	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore	206	15.01
2	Aktivitetet shërbyese të pijeve	158	23.0
3	Aktivitetet e tjera të specializuara ndërtimi p.k.t	142	10.34
4	Përfundimi dhe finalizimi i punëve të tjera të ndërtesave	140	10.20
5	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani	128	9.32
6	Transporti rrugor i mallrave	128	9.32
7	Punime suvatimi	118	8.60
8	Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit	118	8.60
9	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	117	8.52
10	Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit	117	8.52

Në komunën e Klinës, aktivitete të ndryshme humane ndikojnë drejtpërsëdrejti në degradimin e mjedisit, përfshirë këtu ndikimin negativ në ekosisteme. Ky degradim shkakton ulje të kualitetit në mjedis, zvogëlim të mundësisë së përdorimit të biodiversitetit për zhvillim ekonomik, si dhe zvogëlim të mirëqenies së popullatës humane. Faktorët që më së shumti kanë ndikuar në uljen e cilësisë së mjedisit në Komunën e Klinës janë:

Zënia e tokës- zgjerimi i zonave të banimit, ndërtimet pa leje, ndërtimi i rrugëve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese, ndërtimet për qëllime komerciale etj.

Degradimi i lumenjve për shkak të aktivitetit të ndërtimit, devijimit të shtretërve të lumenjve, nxjerrjes së rërës, etj. Kjo shpesh rezulton me daljen e lumenjve nga shtrati dhe vërshime, sidomos në stinën e pranverës dhe vjeshtës kur ka më shumë reshje.

3.3.Sektori minerar

Territori i Komunës së Klinës shquhet për pasuri natyrore. Hapësira karakterizohet me pyje dhe tokë kualitative bujqësore, pasuri nëntokësore, trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore. Komuna ka resurse natyrore minerale dhe jo minerale, të tilla si: rezerva të linjitit (2 miliardë tonë), të xehes së boksitit (2 milionë tonë), të argjilës (6.5 milionë tonë), të rërës dhe zhavorrit (3.5 milionë tonë) etj. Nga totali i bizneseve aktive të regjistruara në Klinë (1,510), vetëm 23 nga to, apo 1.5 % e totalit të bizneseve, aktivitet primar i kanë xeheroret dhe gurëthyesit. Kjo përqindje e vogël e bizneseve të orientuara në këtë sektor tregon një disproporcion mes potencialit real të sektorit për zhvillim të gjithëmbarshtëm ekonomik dhe aktivitetit të realizuar aktualisht.

Eksplotimi i gurit dhe gurëthyesit është një faktor tjetër shqetësues në Komunën e Klinës, i cili ndikon në mjedis, sidomos në peizazhin e zonës, por edhe në shëndetin e njerëzve.




Figura 10.Harta e minierave dhe burimeve minerale

3.4.Transporti

Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore në komunën e Klinës duhet të planifikohet dhe realizohet me kujdes të veçantë për të minimizuar ndikimet mjedisore negative dhe për të promovuar një zhvillim të qëndrueshëm. Procesi përfshin identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore që mund të rezultojnë nga ndërtimi dhe operimi i rrugëve dhe hekurudhave, si dhe përcaktimin e masave për të zvogëluar këto ndikime.

Në territorin e Komunës së Klinës shtrihen rrugët nacionale N9 (Prishtinë-Pejë) dhe N9.1 (Klinë-Gjakovë) si dhe rrugët rajonale R104, R105 dhe R122, të cilat janë nën juridiksionin e Ministrisë së Infrastrukturës. Pjesa tjetër e rrugëve dhe infrastrukturës rrugore janë në juridiksionin e komunës së Klinës. Përveç kësaj, në territorin e Klinës kalon edhe hekurudha në kuadër të linjave Prishtinë-Pejë dhe Prishtinë-Prizren, duke përmirësuar ndjeshëm lidhjet transportuese dhe logjistike të komunës. Për rrugët nacionale dhe rajonale, është e rëndësishme të merren parasysh efektet e mundshme mbi ekosistemet lokale, biodiversitetin dhe zonat e mbrojtura. Ndërtimi i

rrugëve të reja ose zgjerimi i atyre ekzistuese duhet të kryhet duke respektuar ligjet mjedisore dhe duke zbatuar praktikat më të mira për të ruajtur natyrën dhe për të parandaluar fragmentimin e habitatit. Kjo mund të përfshijë krijimin e korridoreve ekologjike dhe vendosjen e strukturave për kalimin e faunës.

Hekurudha, si një alternativë më miqësore për mjedisin krahasuar me transportin rrugor, duhet të inkurajohet për të reduktuar ndotjen dhe emetimet e gazrave serë. Përmirësimi i linjave ekzistuese dhe ndërtimi i stacioneve të reja duhet të realizohen duke pasur parasysh ndikimet mjedisore, si dhe duke promovuar përdorimin e energjive të rinovueshme dhe teknologjive të gjelbra në operacionet hekurudhore.

Komuna duhet të hartojë dhe të miratojë një plan të mobilitetit ku duhet të merren në konsideratë edhe masa për reduktimin e ndotjes së ajrit nga sektori i transportit.

3.5.Bujqësia

Pozita e volitshme gjeografike, toka pjellore, kushtet klimatike, resurset humane dhe natyrore si dhe relievi në rajonin e komunës së Klinës kanë krijuar kushte optimale për zhvillimin e bujqësisë. Nëpër territorin e Klinës kalojnë gjashtë lumenjë: Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Klina, Mirusha, Lumi i Istogut dhe Lumëbardhi i Deçanit. Prej tyre, katër kanë rrjedhë fushore dhe me ndërtimin e pendave përgjatë rrjedhës së tyre do të mund të ujiteshin deri në 2,000 ha toka bujqësore. Me realizimin e projekteve për ndërtimin e kanaleve të ujitjes dhe pendave, deri më tani ujiten rreth 1,200 ha tokë bujqësore. Sipas të dhënave nga ASK-ja, komuna e Klinës disponon me 14,948 ha sipërfaqe me tokë bujqësore, ndërsa Klina hyn në zonën intensive për nga mundësitë e zhvillimit të bujqësisë, pasi që 87.7% e sipërfaqes është nën 600 metra të lartësisë mbidetare. Tokë bujqësore është 95%, vetëm 4.9% janë toka jopjellore. Në strukturën e tokave bujqësore dominojnë arat me 12,734 ha, pyjet me 12,735 ha, livadhet me 2,184 ha, kullosat me 2,043 ha etj. Kulturat e drithërave zënë sipërfaqe totale prej 7,551 ha, ku kultura e grurit dominon me sipërfaqe prej 5,557 ha, pas saj vjen kultura e misrit me 1,767 ha. Elbi, thekra dhe tërshëra kultivohen më pak. Ndërsa, nga kulturat bishtajore dominon bizelja me sipërfaqe prej 130 ha, pas saj vjen fasulja me 76 ha. Kulturat e pemëve dhe perimeve shtrihen në sipërfaqe prej 72.8 ha. Prej tyre dominon kultura e specit me 29 ha, pastaj qepa me 9.5 ha, domatja me 8.5 ha, shalqiri me 8 ha, lakra me 5.7 ha,

trangulli me 3.5 ha, hudhra me 3.3 ha etj. (ASK, 2014). Në komunën e Klinës ka vetëm 4.7 ha sipërfaqe me vreshta (ASK, 2014). Sipas aplikimeve për subvencione në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillit Rural në vitin 2023- numri i atyre që aktualisht merren me bujqësi është vetëm 1,090. Në komunën e Klinës, sipërfaqja e tokës punuese për kokë banori llogaritet të jetë rreth 0.33 ha (Drejtoria e Bujqësisë, 2023). Sa i përket prodhimtarisë bujqësore, toka në mbjelljet vjeshtore mbillet kryesisht me grurë, përderisa në mbjelljet pranverore mbillet me misër dhe bimë foragjere për blegtori. Kulturat tjera të rëndësishme janë perimet, patatet, shalqiri etj. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare, dhe vetëm 1,090 prodhues janë të organizuar në ndërmarrje bujqësore. Pas luftës është vërejtur dukuria e shpërndarjes së pa kontrolluar urbane, e cila e degradon tokën bujqësore. Ky fenomen, Komunës së Klinës i ka kushtuar me humbjen e disa hektarë tokë bujqësore vetëm gjatë periudhës 2015-2020.

Komuna e Klinës ka një sipërfaqe të madhe në të cilën kultivohen produkte bujqësore, për rritjen e të cilave përdoren plehra artificiale si dhe pesticide të ndryshme. Ndikimi i plehrave dhe pesticideve është i shumëfishtë, duke filluar nga ndotja e ujërave nëntokësore, ujërave sipërfaqësore, tokës, florës dhe faunës. Ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe indirekt edhe në shëndetin e njeriut.

Promovimi i bujqësisë organike dhe përdorimi i qëndrueshëm i plehrave kimike dhe organike, do të ndihmonin edhe në reduktimin e emetimeve në ajër nga ky sektor.

3.6.Pylltaria

Sipas vlerësimit të shfrytëzimit të tokës në Komunën e Klinës, nga 30,869.01 ha sa është sipërfaqe totale e komunës, 10,787.76 ha, apo 34.94% e sipërfaqes totale janë Pyje dhe Kullosa; 14,582.55 ha, apo 47.24 % e sipërfaqes totale janë Tokë Bujqësore; 3,288.30 ha, apo 10.65% e sipërfaqes totale janë Sipërfaqe e Ndërtuar, ndërsa 2,210.4 ha, apo 7.16 % e sipërfaqes totale të komunës së Klinës i takojnë kategorisë “sipërfaqe tjera”.

Prerja ilegale e pyjeve: në një pjesë të madhe të sipërfaqes pyjore të Komunës së Klinës hasen aktivitete të prerjes ilegale të pyjeve. Edhe ky aktivitet degradoes ndikon negativisht në mjedis, me pasoja direkte për ekosistemin, biodiversitetin si dhe shëndetin e njeriut.

3.7.Turizmi

Komuna e Klinës ofron një potencial të larmishëm turistik falë burimeve të saj të pasura natyrore dhe trashëgimisë kulturore. Ndër format e identifikuar të turizmit që mund të zhvillohen në këtë zonë janë turizmi shëndetësor, turizmi natyror, agroturizmi, turizmi rural dhe turizmi kulturor. Gryka e lumit Klina ofron mundësi për ndërtimin e një qendre rehabilituese për sëmundjet e frymëmarrjes, duke i dhënë rëndësi turizmit shëndetësor. Në aspektin natyror, komuna përmban atraksione si: Monumenti i Natyrës Mirusha dhe Kanioni i lumit Klina, të cilat tërheqin vizitorë për bukurinë e tyre unike dhe aktivitetet në natyrë, duke përfshirë speleoturizmin.

Parku “Ujëvarat e Mirushës” është një ndër zonat më të bukura dhe interesante të natyrës së Republikës së Kosovës. Ky park shtrihet në territorin e komunave Klinë, Malishevë dhe Rahovec. Saktësisht, gjendet në jug të maleve Gremnik, në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha. Sipërfaqja e këtij parku është 598.4 ha. Lartësia mbidetare e parkut është 340-600 m. Në këtë park, lumi Mirusha në pjesën e fundit të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanioni i lumit Mirusha dhe krijon 12 ujëvara dhe 16 liqene, që paraqesin një fenomen të rrallë morfohidrologjik. Pa dyshim, është një nga peizazhet më atraktive për vizitorë. Ky park zbukurohet edhe më tej me florën dhe faunën e saj. Ndërkohë, trashëgimia kulturore përfaqësohet nga monumentet e shumta historike, të cilat përbëjnë një pasuri të çmuar për turizmin kulturor në këtë komunë. Sa i përket të dhënave mbi numrin e turistëve dhe shifrave të ngjashme, nuk ka ndonjë të dhënë mbi të cilën mund të pasqyrohet gjendja aktuale, e as mbi bazën e së cilës do të mund të bëhej planifikimi për të ardhmen.

4.Gjendja e mjedisit

4.1.Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre

Komuna e Klinës është e pasur me rrjet hidrografik sipërfaqësor dhe nëntokësor. Ujërat sipërfaqësore në komunën e Klinës ndahen në lumenj kryesor që kanë gjatësi 68,543 m. Rrjetin kryesor hidrografik të komunës së Klinës e përbëjnë Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Lumëbardhi i Deçanit, Lumi i Klinës, dhe Mirusha. Lumi kryesor është Drini i Bardhë, që njëkohësisht është lum i cili mbledh të gjitha degët lumore që kalojnë në komunën e Klinës. Drini i Bardhë buron në malet e Bjeshkëve të Nemuna, rrëzë malit të Rusolisë në lartësi 586 metra. Një

tjetër lumë me rëndësi në këtë pjesë është edhe lumi i Klinës i cili buron në shpatet verilindore të Malit të Thatë, në jug të liqenit të Ujmanit. Drini i Bardhë, si lumë kryesor i kësaj komune, ka sipërfaqe të pellgut 4649 km², ndërsa sasia e rrjedhjes është 61 m³/s.

Ujërat nëntokësorë janë elemente që varen nga karakteristikat gjeomorfologjike e gjeologjike të komunës së Klinës. Për të shqyrtuar potencialin e ujërave nëntokësore, qarkullimin e tyre dhe, mbi të gjitha, furnizimin me ujë ose vlerësimin e marrjes së ujit në vende të caktuara, të gjitha masat shkëmbore janë të ndara në bazë të kriterëve të mëposhtme: Përbërjes litologjike; Shkallës së shkatërrimit mekanik dhe tipit të porozitetit, ujë përshkueshmërisë dhe koeficientit të filtrimit.

Uji ka një rol shumë të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe sigurimi i tij është kthyer në një nga sfidat më të mëdha botërore. Gjithmonë uji ka qenë faktor vendimtar në zhvendosjen e popullsisë nga një vend në një tjetër, sepse ai është kushti themelor për një jetë të sigurt e të shëndetshme. Prandaj, bazuar në planin zhvillimor komunal, qëllimi është të orientojë institucionet në procesin e përmirësimit të shërbimeve të ujit dhe largimit të ujërave të ndotura, duke synuar:

1. Përfshirjen e të gjithë banorëve me shërbime të kontrolluara të ujit të pijes,
2. Rritjen e kualitetit të shërbimeve dhe
3. Largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Furnizimi me ujë të pijes dhe largimi i ujërave të ndotura paraqesin një shërbim të veçantë për banorët, me ndikim të drejtpërdrejtë në kualitetin e jetës dhe reflektim në shëndetin e popullatës. Të gjitha shkarkimet e ujërave të ndotura krijojnë probleme mjedisore në lumenjtë dhe liqenet; prandaj zhvillimi i këtij projekti do të sillte ndikime pozitive në mjedis duke krijuar një impiant të trajtimit të këtyre ujërave të ndotur dhe më pas derdhjen e tyre në liqen dhe më tej në det.




Figura 11. Hidrogeologjia

4.2. Ajri dhe zhurma

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi mjedisit që na rrethon. Ajri është vazhdimisht nën ndikim të ndotjes nga shumë burime. Edhe pse ndotja e ajrit vjen kryesisht nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet natyrore. Ndotja e ajrit ndodh kur ajri përmban substanca në sasi që mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve ose mund të shkaktojnë dëme materiale.

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Komunën e Klinës është realizuar me anë të pajisjes Aeroqual nga studentët e Universitetit “Haxhi Zeka” dhe “Fehmi Agani” dhe atë gjatë muajit qershor. Lokacionet në të cilat janë bërë matjet janë: sheshi “Ndue Perlleshi”, sheshi “Mujë Krasniqi”, tek hekurudhat dhe sheshi “Faruk Elezi”. Parametrat të cilët janë matur janë: PM2.5, PM10, NO2, SO2, O3, CO, temperatura si dhe lagështia e ajrit.

Tabela 6: Emetimet në ajër - Klinë, 2021-2022¹

	Djegjet e vogla	Transporti rrugor	Industria	Bujqësia	Guroret	Pyjet	Total
PM 10	493,46	100.39	0	73.75	1.63	0	699.24
PM 2.5	480.66	44.98	0	9.37	0.16	0	535.17
NOx	44.08	371.65	0.038	223.17	0	0	638.94
SO2	15.59	0.16	0.02	0.15	0	0	15.90
CO	2663.34	160.08	0.019	17.50	0	0	2840.93

Duke u bazuar në Indeksin e Cilësisë së Ajrit (tab.6) gjendja e cilësisë së ajrit në Komunën e Klinës është e pranueshme për parametrat PM10 dhe PM2.5, ndërsa e mirë për parametrat e tjerë në të gjitha lokacionet. Ndotja e ajrit në komunën e Klinës kryesisht shkaktohet nga trafiku dhe gurëthyesit. Sa i përket trafikut, rrjeti i propozuar i trafikut në territorin e Komunës ka paraparë shkurtimin e distancave në mes të vendbanimeve dhe përmirësimin e kualitetit të rrugëve, gjë që ndikon edhe në zvogëlimin e ndotjes. Ndikim të madh në zvogëlimin e nivelit të ndotjes së ajrit kanë edhe brezat e gjelbërimit përgjatë rrugëve. Në mënyrë që të mbrohet ajri, është e nevojshme që të kontrollohet lokacioni për prodhimin e pajisjeve dhe llojin e teknologjisë, llojin e energjisë dhe të stimulohet energjia e pastër dhe energjia ripërtëritëse.

Zhurma

Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga tejkalimi i nivelit të zhurmës së lejuar, është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve të automjeteve motorike dhe vendbanimeve. Shfrytëzuesi i pajisjeve të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion mund të vënë në qarkullim ose të përdorin pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse, për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bëjë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e lejuar me ligj të veçantë.

¹ Raporti për gjendjen e cilësisë së ajrit në komunën e Pejës dhe Klinës 2021-2022, LDIP 2022

4.3.Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Klinës është një proces që mbulon të gjithë territorin e komunës, duke përfshirë grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave nga ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet. Komuna ka një marrëveshje për shërbime me KRM "Ambienti", njësi në Klinë, e cila është përgjegjëse për këtë shërbim.

KRM "Ambienti" grumbullon mbeturinat në të gjithë territorin e komunës, duke shërbyer:

-6,411 amvisëri

-744 biznese

-64 institucione

Mbeturinat e grumbulluara transportohen për deponim në deponinë sanitare rajonale në Sferkë, e cila ndodhet në Komunën e Pejës. Ky proces siguron që mbeturinat të trajtohen në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.

Përveç mbeturinave të zakonshme të amvisërisë, KRM "Ambienti" kryen edhe shërbimin e grumbullimit të mbeturinave masive dhe të ndërtim-rrënimit. Megjithatë, ky operator nuk posedon një licencë valide për këtë veprimtari specifike, gjë që përbën një sfidë për menaxhimin e mbeturinave të këtij lloji.

Në Komunën e Klinës operojnë edhe disa operatorë të riciklimit, të cilët nuk janë të formalizuar dhe veprojnë jashtë sistemit legal. Këta operatorë përpiqen të mbledhin dhe riciklojnë materiale të ndryshme, por mungesa e formalizimit dhe integritetit në sistemin legal krijon sfida për monitorimin dhe menaxhimin efektiv të procesit të riciklimit.

Tabela 7. Sasia e mbeturinave të grumbulluara dhe deponuara në 2021 në Komunën e Klinës

Viti	Mbeturina të grumbulluar (ton)	Mbeturina të grumbulluara nga deponitë ilegale (ton)	Totali i sasisë së mbeturinave të deponuara nga Ambienti (ton)
2021 ¹³	9,758.70	-	9758.70
2018 ¹⁴	10,067.60	-	10067.60

Mbulimi me shërbim për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës për ekonomitë familjare është 97.9%. Prej numrit të përgjithshëm të EF që është 5843, shërbehen 5,721 EF.

Tabela 8: Mbulimi me shërbim për grumbullimin e mbeturinave në territorin e komunës

Emri i operatorit	Numri i EF	Numri i EF të shërbyera	Numri i bizneseve aktive	Numri i bizneseve të shërbyera	Numri i institucioneve	Numri i institucioneve të shërbyera
KRM Ambienti	5,843	5,721	-	699	-	70

4.4.Shfrytëzimi, ndotja dhe erozioni i tokave

Komuna e Klinës shtrihet në një sipërfaqe totale prej 30,869.01 hektarësh. Nga kjo sipërfaqe, 34.94% janë pyje dhe kullosa, 47.02% përbëhet nga toka bujqësore, 10.65% është banim i përhershëm, 3.05% mbulohet nga rrjetet e transportit, 0.13% është zonë industriale, dhe pjesa e mbetur e territorit përdoret për kategori të tjera.

Tabela 9.Shfrytëzimi i tokës

LLOJI I SHFRYTËZIMIT	SIP.(Ha)	%
Zonë Bujqësore	14582.55	47.02%
Zonë Pyjore	10787.76	34.94%
Zonë e mbrojtur arkeologjike historike	16.70	0.05%
Zonë e mbrojtur	192.40	0.62
Zonë e veçantë e mbrojtur	11.86	0.03
Zonë për shfrytëzim të përzier	101.29	0.32
Zonë industriale	34.08	0.13%
Zonë minierë sipërfaqësore	338.99	0.11
Zonë komerciale	27.79	0.09%
Zonë e Shërbimeve të komunitetit	117.44	0.38%
Zonë recreative-turistike	147.78	0.47%
Zonë e komunikacionit transportit	942.91	3.05%
Zonë Banim	3288.30	10.65%
Sipërfaqe Ujore	279.15	0.90%
TOTALI	30869.01	100%
	Ha	

Ndotja e tokës

Gjatë viteve të fundit, Komuna e Klinës ka bërë përpertime të dukshme, por sfidat si degradimi i tokës në zonat rurale dhe përreth zonave urbane mbeten ende të pranishme. Këto probleme kanë ardhur si pasojë e zgjerimit të pakontrolluar urban, ndotjes mjedisore dhe shfrytëzimit të pakujdesshëm të burimeve natyrore. Për një menaxhim të qëndrueshëm të këtij resursi jetik, është e nevojshme që toka të trajtohet në mënyrë të integruar duke u mbështetur në politika të koordinuara ekonomike, sociale dhe mjedisore. Për të ruajtur ekuilibrin midis shfrytëzimit të tokës dhe mbrojtjes së mjedisit, duhet të parandalohet shfrytëzimi i tepruar i resurseve natyrore dhe urbanizimi i pa kontrolluar. Zgjatja e veprimtarive që dëmtojnë mjedisin rrezikon shëndetin publik, ul cilësinë e jetës dhe rrit ndjeshëm koston e zhvillimit ekonomik. Në Klinë, si në pjesën më të madhe të Kosovës, tokat përreth zonave urbane përdoren kryesisht për ndërtim, ndërsa zonat rurale mbeten të fokusuara në aktivitetet bujqësore.

Shkaqet kryesore të degradimit të tokës në Klinë përfshijnë shfrytëzimin e pa kontrolluar të burimeve natyrore, ndërrimin e destinimit të tokës, përdorimin e tepruar të pesticideve dhe

plehrave kimike, ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe mbeturinat e depozituara jashtë zonave të përcaktuara. Gjithashtu, ndotja e lumenjve dhe burimeve ujore, së bashku me krijimin e deponive ilegale, kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në degradimin e tokës në komunë. Në Klinë sikur edhe në disa raste tjera në Kosovë është dyshuar për ndotje të tokës dhe ujit nga materie radioaktive (Uranium, Cesium, Tritium) në ish-kazermën e ushtrisë dhe disa vendbanime. Për këtë qëllim, komuna ka hulumtuar rastin duke marrë dhe analizuar mostra të dheut dhe ujit në qytet, tek ish kazerma e ushtrisë, dhe në fshatin Zllakuqan. Pas analizave laboratorike të akredituara, ka rezultuar se të gjitha vlerat e ndotjeve/rrezatimeve në ujë dhe tokë janë nën vlerat e lejuara.

Erozioni

Duke ju falënderuar gjendjes së përgjithshme të vegjetacionit, bazës gjeologjike, pjerrtësisë së terrenit, ndikimit të pavolitivshëm të kushteve klimatiko-meteorologjike dhe hidraulike e sidomos ndikimit të njeriut, proceset e erozionit kanë marrë përpjesa shqetësuese sepse një pjesë e madhe e territorit është nën ndikimin shkatërrues të erozionit për shkak të ujërave vërshuese. Me erozionin e kategorisë II, III dhe IV, është përfshirë afër 50% e territorit të komunës së Klinës.




Figura 12.Harta e erozionit

4.5.Natyra dhe biodiversiteti

Komuna e Klinës përmban shumë monumente dhe tërësi natyrore të mbrojtura nga Ligji për Konservimin e Natyrës, i cili parashikon mbrojtjen e biodiversitetit dhe peisazheve të larmishme me vlerë të veçantë.

Një ndër monumentet më të rëndësishme natyrore në këtë komunë është "Mirusha", një zonë me interes të veçantë.

Elaborimi më i hollësishëm për zhvillimin e turizmit në Monumentin natyror "Mirusha" është dhënë në Planin Hapësinor për zonën e veçantë "Monumenti natyror Mirusha" të hartuar nga IPH – si zonë e veçantë nën kompetencën e MMPH. Kanioni i Mirushës, i cili gjendet në rrjedhën e poshtme të lumit Mirusha, është i njohur për format e tij imponuese morfologjike, të cilat përfshijnë 16 liqene dhe 12 ujëvara, me forma, sipërfaqe dhe lartësi të ndryshme.

Plani Hapësinor i Monumentit të Natyrës "Mirusha" ka përcaktuar mundësitë e zhvillimit të turizmit dhe aktiviteteve të tjera ekonomike, si dhe përgjegjësitë e komunës për mbrojtjen e vlerave natyrore dhe kulturore të identifikuara.

Përveç Mirushës, në territorin e komunës së Klinës ekzistojnë vendbanime të tjera ku ndodhen monumente natyrore me veçori specifike dhe vlera unike. Këto monumente kanë rëndësi të veçantë për natyrën, rekreacionin, estetikën dhe kulturën lokale.

Në komunën e Klinës gjenden dy lloje monumentesh natyrore: hidrologjike dhe botanike.

-Monumentet natyrore me veçori hidrologjike të rëndësishme të veçantë që janë në listën e zonave të mbrojtura natyrore përfshijnë burimet e ujit mineral në Dresnik dhe Rudicë, grykën e lumit Klina, dhe disa trupa të veçantë të drunjve të llojeve *Quercus robur*, *Quercus cerris* dhe *Quercus pubescens* në vendbanime si Gllarevë, Zllakuqan, Deiq dhe Ujmirë. Burimet e ujërave minerale në Klinë janë të kategorizuara si zona të mbrojtura të kategorisë së tretë, sipas Nenit 4 të Udhëzimit Administrativ për Kriteret e Zonave të Mbrojtura Ujore.

Shpellat janë një tjetër veçori e rëndësishme natyrore në komunën e Klinës, me shumicën e tyre të vendosura në kanionin e Mirushës dhe në Dush. Këto përfshijnë Shpellën e Kishës së Madhe, Shpellën e Kishës së Vogël, Shpellën pranë liqenit të dhjetë dhe të nëntë, shpellat karstike, Shpellën e Madhe dhe Shpellën e Dushit.

Asetet e trashëgimisë natyore në Komunën e Klinës janë të listuara si më poshtë:

- Parku rajonal i Mirushës - kanioni, ujëvarat dhe peisazhet specifike;
- Burimi i ujit mineral në Dresnik, Klinë – monument natyror me karakter hidrologjik;
- Gryka e lumit Klina, Klinë– monumenti natyrës me vlera geomorfologjike, hidrologjike dhe botanike;
- Trungu i qarrit në Zllakuqan, Klinë – monument natyror me karakter botanik dhe turistik;
- Trungu i rrënjës në Deiq- monument natyror me karakter botanik;
- Kompleksi i trungjeve të rrënjës në Gllarevë- monument natyror me karakter botanik;
- Trungu i qarrit në Nagllavë- monument natyror me karakter botanik;
- Burimi i ujit mineral në Rudicë- monument natyror me karakter hidrologjik;
- Trungu i bungut në Ujmirë- monument natyror me karakter botanik;
- Trungu i qarrit në Poterq të Ulët, Klinë – ish monument natyror me karakter botanik;
- Trungu i qarrit në Berkovë, Klinë - ish monument natyror me karakter botanik.

Figura 13.Ujëvara e Mirushës



4.6.Shëndeti publik

- Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës, qasja e kufizuar në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe mbeturinave ndërlidhen me shëndetin e popullatës.
- Fatkeqësitë natyrore si vërshimet, erozioni natyror, orteqet, thatësi, stuhitë dhe ato të shkaktuara nga njeriu (zjarret, erozioni i shkaktuar nga aktivitetet njezërore-nxjerrja e zhavorrit, prerja e pyjeve, mosmirëmbajtja e lumenjve) sjellin pasiguri dhe ndikojnë në shëndetin e popullsisë.
- Depot ilegale dhe depot e ndërtuara dhe të menaxhuara në mënyrë jo të duhur gjithashtu ndikojnë në shëndetin e popullatës.
- Mungesa e infrastrukturës publike (arsimi, shëndetësia) dhe sociale (sport, kulturë, rekreacion) gjithashtu ndikon në mirëqenien sociale të popullatës.

5.Problemet kryesore mjedisore

Tabela 10. Problemet kryesore mjedisore

Ajri dhe klima
- Mungesa e sistemit për monitorim të kualitetit të ajrit. - Sektori i transportit kontribuon dukshëm në ulje të kualitetit të ajrit. Numri i automjeteve (edhe të vjetruara) sa vie e shtohet në komunë. Nuk ka rrugë transite për mjetet e rënda transportuese. - Djegia e pakontrolluar e mbeturinave si metodë e menaxhimit të tyre. - Zvogëlimi i hapësirave të gjelbërta nga prerja dhe mosmirëmbajtja e tyre.

Uji

- Mos-kompletimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit për të gjitha vendbanimet.
- Sistemi ekzistues i ujësjellësit jo adekuat, i vjetëruar dhe dëmtuar.
- Ndotja e ujërave vjen nga derdhja e ujërave të zeza, hedhja e mbeturinave dhe përdorimi i pesticideve.
- Mungesa e sistemit për menaxhim dhe trajtim të ujërave të zeza.
- Pakësimi i ujit të ujërrjedhave lumore si pasojë e shfrytëzimit të ujit për veprimtari ekonomike (hidrocentrale, agrikulturë, etj.), por edhe si pasojë e varësisë nga reshjet atmosferike (i shprehur gjatë muajve qershor-shtator).
- Dëmtimi i shtratit të lumenjëve nga eksploatimi i zhavorrit, ku si rrjedhojë vjen deri te vërshimet.
- Devijimi i shtratit të lumenjve me qëllim të marrjes së ujit për ujitjen e tokave.

Toka (dheu)

- Zvogëlimi i sipërfaqes së tokës bujqësore nga ndërtimet dhe shfrytëzimi joracional i tokës ndërtimore, ku si pasojë ka pakësim të sipërfaqeve të gjelbërta.
- Ndotja e tokës nga veprimtaritë që gjenerojnë mbeturina (komunale, industriale, vendgrumbullimet e hekurit dhe varrezat e automjeteve). 10.20 ha tokë bujqësore e humbur nga mbeturinat (sipas PKMM).
- Ndotja e tokës nga veprimtaritë bujqësore (përdorimi i plehrave dhe i pesticideve).
- Erozioni i shkaktuar nga eksploatimi i zhavorrit dhe prerja ilegale e pyjeve.

Zhurma

- Kontribuesi kryesor i ndotjes është komunikacioni. Mungesë e mjeteve matëse dhe sistemit të monitorimit dhe të sistemit amortizues për zbutje të efektit të zhurmës në zonat e prekura.
- Mungesa e Planit të Veprimit dhe Hartës së Zhurmës.

Të përgjithshme

- Niveli i ulët i vetëdijes mjedisore.
- Pjesëmarrje e ulët e publikut në vendimmarrjen mjedisore.
- Mungesë e planeve lokale për zhvillimin e turizmit dhe promovimit të ekoturizmit.

- Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe OJQ-ve për mbrojtjen e mjedisit.
- Zbatim i pamjaftueshëm i VSM-së dhe VNM-së për planet, programet dhe projektet e nivelit lokal.
- Numri i vogël i inspektorëve për sektorin e mjedisit.
- Buxheti i limituar në sektorin e mbrojtjes së mjedisit
- Mungesa e kapaciteteve për qasje në fondet ndërkombëtare për mjedisin dhe kapaciteti i ulët absorbues.
- Infrastruktura e pamjaftueshme turistike – mungesa e rrugëve në disa zona, mungon shënjimi turistik, hartat, qendrat informative turistike etj.
- Mungesa e një plani lokal për ndryshimet klimatike.
- Mungesa e investimeve për projektet për zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes së ndryshimeve klimatike.

6.Prioritetet mjedisore për periudhën 2025-2029

Tabela 11. Prioritetet mjedisore për periudhën 2025-2029

Përshkrimi i prioritetëve kryesore mjedisore sipas sektorëve
Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre
- Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit në lagjet periferike të zonës urbane me qëllim të zvogëlimit të humbjeve. - Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha në zonën urbane. - Rregullimi i shtretërve të lumenjve në vendbanimet e rrezikuara nga vërshimet. - Ndërtimi i një rezervuari mbi fshatin Çabiq nga i cili do të furnizohen me ujë 11 vendbanime. - Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit në lagjet periferike të zonës urbane me qëllim të zvogëlimit të humbjeve. - Investimi në fabrikën e ujit në Klinë, si në aspektin kualitativ, ashtu edhe në atë kuantitativ; pra për eliminimin e turbullirave dhe rritjen e kapacitetit prodhues. - Monitorimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijes në bashkëpunim me ISHPK.

- Ndërrimi i gypit të furnizimit kryesor nga Burimi i Jarinës deri tek Stacioni i Pompimit.
- Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në vendbanimet perifeike si:
Grabç, Binxhë dhe Dranashiq.
- Në anën e djathtë të lumit Drini i Bardhë duhet të ndërtohet kolektori në të cilin duhet të shkarkohen ujërat e zeza të këtyre vendbanimeve: Stupë, Budisalc, Nagllavë, Krushevë e Madhe, Jagodë, Videjë, Deiq, Zajm, Dollovë, Pjetërq i Poshtëm, Pjetërq i Epërm, Drenoc, Dugajevë, Bokshiq, Grabanicë, Qeskovë dhe Këpuz.
- Ndërtimi i kolektorit kryesor në anën e majtë të lumit Drini i Bardhë në të cilin duhet të shkarkohen vendbanimet: Berkovë, Leskoc, Drashaniq, Zllakuqan, Grabç, Binxhë, Shtupel, Radulloc, Krushevë e Vogël, Gjurgjevik i Vogël, Klinë, Jashanicë e Epërme, Kërnicë, Jashanicë, Resnik, Jelloc, Siqevë, Dush, Pograxhë, Gjurgjevik i Madh, Dresnik, Dollc, Gremnik, Qupevë, Çabiq, Zabërgjë, Dobërdol, Ujmirë, Gllarevë, Përçevë, Sferkë, Dush i Vogël dhe Volljakë.
- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të kanalizimit për vendbanimet të cilat janë të kyçura në rrjetin e kanalizimit.
- Ndërtimi i gropave septike për vendbanimet të cilat nuk janë të kyçura në rrjetin kryesor.
- Ndërtimi i kolektorit kryesor për mbedhjen e ujërave të zeza në drejtim të impiantit të planifikuar nga MMPHI.
- Ndërtimi i impiantit në Caravik.
- Shtrirja e rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha (sipas prioritetit në vendbanimet që kanë probleme me vërshimet) dhe derdhja e tyre në shtretërit e lumenjve dhe përrockave në të gjitha vendbanimet rurale.
- Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha në zonën urbane.
- Ndërtimi i shtratit të lumit “Lumëbardhi i Pejës” në Drenoc dhe Grabanicë.
- Rregullimi i shtratit të lumit “Drini i Bardhë” – Volljakë.
- Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, lagjja “Arbëria”, Burim i Jarinës, Pograxhë.
- Ndërtimi i kanalit kullues nga Gryka e Jarinës në Dresnik-Arbëri
- Ndërtimi i sistemeve moderne të trajtimit të ujërave të zeza.
- Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ujërave.
- Definimi i Zonës së Mbrojtjes së Regjimit të Rreptë, Zonën e Mbrojtjes së Regjimit të Kufizuar si dhe Zonën e Mbrojtjes së Regjimit të Lehtë.

Ajri dhe zhurma
- Hartimi i strategjisë komunale për energji alternative. - Hartimi i planit të veprimit për shfrytëzimin e energjisë alternative në të gjitha objektet e infrastrukturës sociale, banimit kolektiv dhe objekteve të industries. - Hartimi i politikave për subvencionimin e shfrytëzimit të energjisë alternative nga objektet e banimit individual dhe afarizmit. - Hartimi i planit të mobilitetit të qëndrueshëm duke planifikuar edhe shtigje për çiklistë dhe për këmbësorë. -Pajisja e stacioneve të pompimit me pajisje për energji solare dhe transferim të të dhënave digjitale (GPRS). - Instalimi i Paneleve Solare në hapësirat e ndërtesave të Klinës: Sistemi PV dhe i Ngrohjes Solare. - Instalimi i të gjithë infrastrukturës së nevojshme për monitorimin e cilësisë së ajrit. - Hartimi i Planit të Veprimit për shfrytëzimin e potencialit për burime të ripërtërishme të energjisë, sidomos në zonat: Binxhë, Jashanicë, Siqevë, Dobërdol, Çabiq, Caravik, Zabërgjë, Gjurgjevik i Madh, Nagllavë, Pjetërq i Poshtëm, Bokshiq, Qeskovë, Dollovë, Këpuz, Volljakë, Qupevë, Gremnik, Dush, Sferkë, Përçevë etj. - Identifikimi i zonave të zhurmës/ndotjes akustike dhe rekomandimeve për intervenim.
Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut

-Programe trajnimi për fermerët dhe bujqit. -Program subvencionimi për investime në bujqësi, bujqësi intensive dhe blegtori. -Krijimi i Databazës Bujqësore. -Hartimi dhe implementimi i masave adekuate për revitalizimin e ekosistemeve të degraduara. -Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave erozive dhe të vërshimeve. -Hartimi i projekteve për rehabilitim të zonave, vijave dhe pikave të zeza të ndotura. -Krijimi i një sistemi/platforme për monitorimin e mbrojtjes së Tokës Bujqësore, (Kategoria I-IV) përmes respektimit rigoroz të kufijve të ndërtimit dhe parandalimit të ndërtimeve pa leje. -Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore. -Hartimi i Planit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Dëmeve nga Vërshimet. -Mbrojtja e tokës bujqësore dhe definimi i zonave ndërtimore dhe zonave tjera që kanë një shkallë të mbrojtjes (trashëgimia kulturore dhe natyrore)/
Menaxhimi i mbeturinave
-Vendosja e konteinerëve në të gjitha vendbanimet sipas kapaciteteve të nevojshme. -Ri-organizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave. -Ndërtimi i pikës së transferit të mbeturinave. -Riorganizimi i deponive egzistuese apo ndërtim i deponive të reja për mbeturina inerte. -Trajtimi i mbetjeve ashtore të shtazëve. -Pastrimi i 80% të sipërfaqes së tokës nga mbeturinat e ngurta, në baza vjetore. -Përdorimi i sistemeve të reciklimit në institucione publike dhe objekte të infrastrukturës sociale. -Politika stimuluese dhe kampanja promovimi.
Natyra dhe biodiversiteti

- Identifikimi i hapësirave që duhet të rregullohen ose të rehabilitohen në zonat publike të Klinës, duke përfshirë rrugët, parqet, sheshet, dhe zona të tjera.
- Identifikimi i zonave potenciale për të krijuar hapësira të reja publike, siç janë parqet, qendra komunitare ose zonat e rekreacionit.
- Melorizimi i sipërfaqeve pyjore (10-15 Ha).
- Identifikimi i vendgjuetive.
- Ndërtimi i vendgjuetive.
- Investime në infrastrukturë dhe kapacitete turistike.
- Ndërtimi i tri parqeve të reja publike.
- Ripyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara pyjore.
- Promovimi i destinacioneve turistike.
- Përkrahja dhe promovimi i sektorit të shërbimeve të ndërlidhura me turizmin.
- Përgatitja e broshurave dhe video-materialeve për promovim.
- Krijimi i Databazës Dixhitale të Aseteve Turistike dhe Potencialit Turistik.
- Krijimi i regjistrit dhe databazës së florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës.
- Hartimi dhe implementimi i masave adekuate për mbrojtjen e florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës.
- Identifikimi, inventarizimi, caktimi i kufijve të mbrojtjes për asetet e trashëgimisë kulturore.
- Hartimi i strategjisë komunale për mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore.
- Inventarizimi dhe Digjitalizimi i Inventarit të Trashëgimisë dhe Aseteve Kulturore dhe Natyrore për të gjithë territorin e Komunës së Klinës.
- Hartimi i Strategjisë së Integruar për Ruajtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore.
- Promovimi i vazhdueshëm dhe përkrahja e ndërmarrjeve turistike
- Organizimi i fushatave senzibilizuese për ngritjen e vetëdijësimit në popullsi për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
- Hulumtimi i monumenteve të natyrës për futje nën mbrojtje deri në vitin 2026.
- Sinjalizimi i monumenteve të mbrojtura deri në vitin 2026.
- Hartimi i Strategjisë Komunale për Zhvillim të Turizmit të Qëndrueshëm.
- Mbrojtja e trashëgimisë natyrore, e peizazhit të hapur dhe pyjeve nga ndërtimet, shkatërrimet e mëtejme dhe eksploatimet e palejueshme.

Të përgjithshme
- Parandalimi i efekteve mjedisore nga zhvillimet e reja negative. - Ngritja e vetëdijes mjedisore dhe nxitja e pjesëmarrjes shoqërore në vendimmarrjen mjedisore. - Fuqizimi i inspektoratit për implementimin e legjislacionit në fushën e mjedisit. - Rritja e buxhetit dhe investimeve për sektorin e mjedisit. - Përfshirja dhe integrimi i mbrojtjes së mjedisit në plane komunale dhe në strategji të tjera sektoriale që kanë ndikim në mjedis. - Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstytucional për mbrojtjen e mjedisit. - Hartimi i Planit Lokal për Ndryshimet Klimatike.

Tabela 12. Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2025-2029

Prioritetet	Aktiviteti/Veprimi	Buxheti Euro dhe burimi	Përgjegjësi për implemmentim	2025				2026				2027				2028				2029			
				1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
Mbrojtja e resurseve ujore dhe menaxhimi efikas i tyre	Monitorimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijes në bashkëpunim me ISHPK	15,000 Komuna	Komuna Hidrodrini DSHP																				
	Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit në lagjet periferike të zones urbane me qëllim të zvogëlimit të humbjeve	300,000 Komuna Donatori	Komuna Hidrodrini																				
	Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha në zonën urbane	300,000 Komuna Donatori	Komuna																				
	Rregullimi i shtretërve të lumenjve në vendbanimet e rrezikuara nga vërshimet	500,000 Komuna Donator	Komuna DSHP																				

[illegible]

[illegible]

[illegible]

domosdoshme të vlerësohet nëse janë arritur rezultatet e synuara. Komuna do të përqendrohet në vlerësimin e fushave të caktuara në lidhje me rëndësinë, efikasitetin, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.

<i>Tabela.13.Plani i monitorimit</i>					
	Prioritetet	Aktivitetet	Indikatorët e suksesit	Raportimi	Organizata përgjegjëse
1.	<i>Mbrojtja e resurseve ujore dhe menaxhimi efikas i tyre</i>	Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit në lagjet periferike të zonës urbane me qëllim të zvogëlimit të humbjeve	Rrjeti i ujësjellësit i përmirësuar në lagjet periferike dhe urbane	Gjashtëmuajor	Komuna Hidrodrini
		Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha në zonën urbane	Rrjeti i kanalizimit për ujërat e bardha i përmirësuar	Vjetor	Komuna
		Rregullimi i shtretërve të lumenjve në vendbanimet e rrezikuara nga vërshimet	Rreziku nga vërshimet i reduktuar	Vjetor	Komuna DSHP
		Ndërtimi i një rezervuari mbi fshatin Çabiq nga i cili do të furnizohen me ujë 11 vendbanime.	Rrjeti i ujësjellësit i kompletuar	Vjetor	Komuna DSHP DUMM
		Investimi në fabrikën e ujit në Klinë, si në aspektin kualitativ, ashtu edhe në atë kuantitativ, pra, për eliminimin e turbullirave dhe rritjen e kapacitetit prodhues.	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për furnizim me ujë të pijes-Rritja e kapacitetit me furnizim të ujit të pijes e përmirësuar, fabrika e ujit e ndërtuar	Gjashtëmuajor	Komuna Hidrodrini DSHP

		Monitorimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijes në bashkëpunim me ISHPK	Monitorim i vazhdueshëm	Mujor	Komuna Hidrodrini DSHP
		Ndërrimi i gypit të furnizimit kryesor nga Burimi i Jarinës deri tek Stacioni i Pompimit.	Kompletimi i të gjitha stacioneve të pompimit me sisteme solare i realizuar	Vjetor	Komuna
		Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në vendbanimet periferike si: Grabc, Binxhë dhe Dranashiq	Ujërat e zeza të grumbulluara si rezultat i ngritjes dhe zgjerimit të infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të zeza në vendbanimet e komunës	Vjetor	Komuna DSHP
		Në anën e djathtë të lumit Drini i Bardhë duhet të shkarkohen ujërat e zeza të këtyre vendbanimeve: Stupë, Budisalc, Nagllavë, Krushevë e Madhe, Jagodë, Videjë, Deiq, Zajm, Dollovë, Pjetërq i Poshtëm, Pjetërq i Epërm, Drenoc, Dugajevë, Bokshiq, Grabanicë, Qeskovë dhe Këpuz.	Rrjeti i kanalizimit në vendbanimet e kyçura të komunës i përmirësuar	Vjetor	Komuna DSHP
		Ndërtimi i kolektorit kryesor në anën e majtë të lumit Drini i Bardhë në të cilin duhet të shkarkohen vendbanimet: Berkovë, Leskoc, Drashaniq, Zllakuqan,	Ndërtimi dhe funksionalizimi i kolektorit kryesor	Vjetor	Komuna DSHP

		Grabc, Binxhë, Shtupel, Radulloc, Krushevë e Vogël, Gjurgjevik i Vogël, Klinë, Jashanicë e Epërme, Kërrnicë, Jashanicë, Resnik, Jelloc, Siqevë, Dush, Pograxhë, Gjurgjevik i Madh, Dresnik, Dollc, Gremnik, Qupevë, Çabiq, Zabërgjë, Dobërdol, Ujmirë, Gllarevë, Përçevë, Sferkë, Dush i Vogël dhe Volljakë			
		Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të kanalizimit për vendbanimet të cilat janë të kyçura në rrjetin e kanalizimit	Menaxhimi i ujërave të zeza	Vjetor	Komuna DSHP
		Ndërtimi i gropave septike për vendbanimet të cilat nuk janë të kyçura në rrjetin kryesor	Ndërtimi i kolektorit kryesor për mbledhjen e ujërave të zeza i realizuar	Vjetor	Komuna DSHP
		Ndërtimi i kolektorit kryesor për mbledhjen e ujërave të zeza në drejtim të impiantit të planifikuar nga MMPHI	Menaxhimi i ujërave të zeza	Vjetor	Komuna DSHP
		Ndërtimi i impiantit në Caravik	Ndërtimi dhe funksionalizimi i kolektorit kryesor	Vjetor	Komuna DSHP

		Shtrirja e rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha (sipas prioritetit në vendbanimet që kanë probleme me vërshimet) dhe derdhja e tyre në shtratet e lumenjve dhe përrockave në të gjitha vendbanimet rurale.	Shtrati i lumit i mbrojtur nga vërshimet	Vjetor	Komuna DSHP
		Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha në zonën urbane	Menaxhimi i ujërave të zeza	Vjetor	Komuna DSHP
		Ndërtimi i shtratit të lumit “Lumëbardh i Pejës” në Drenoc dhe Grabanicë	Vendosja e argjinaturave	Vjetor	Komuna
		Rregullimi i shtratit të lumit “Drini i Bardhë” – Volljakë	Shtrati i lumit Drini i Bardhë, Lumëbardh i Pejës, lumit Klina, i rregulluar për mbrojtje nga vërshimet	Vjetor	Komuna
		Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, lagjja “Arbëria”, Burim i Jarinës, Pograxhë.	Vendosja e argjinaturave	Vjetor	Komuna
		Ndërtimi i kanalit kullues nga Gryka e Jarinës në Dresnik-Arbëri	Kanali kullues i ndërtuar	Vjetor	Komuna DBPZHR

		Ndërtimi i sistemeve moderne të trajtimit të ujërave të zeza	Progres i vazhdueshëm	Vjetor	Komuna DSHP
		Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ujërave	Monitorim i vazhdueshëm	Mujor	ISHPK DSHMS Hidrodrini
		Definimi i Zonës së Mbrojtjes së Regjimit të Rreptë, Zonës së Mbrojtjes së Regjimit të Kufizuar, si dhe Zonës së Mbrojtjes së Regjimit të Lehtë.	Marrja e masave adekuate në terren, e realizuar	Vjetor	Komuna DSHP DUMM
2.	<i>Përmirësimi i cilësisë së ajrit</i>	Hartimi i strategjisë komunale për energji alternative	Cilësia e ajrit e përmirësuar si rezultat i hartimit të strategjisë komunale për energji alternative	Vjetor	Komuna
		Hartimi i planit të veprimit për shfrytëzimin e energjisë alternative në të gjitha objektet e infrastrukturës sociale, banimit kolektiv dhe objekteve të industrisë	Cilësia e ajrit e përmirësuar si rezultat i hartimit të planit të veprimit të energjisë alternative në objektet e infrastrukturës sociale, banimit kolektiv dhe objektet e industrisë	Vjetor	Komuna

		Hartimi i politikave për subvencionimin e shfrytëzimit të energjisë alternative nga objektet e banimit individual dhe afarizmit	Cilësia e ajrit e përmirësuar	Vjetor	Komuna
		Hartimi i planit të mobilitetit të qëndrueshëm duke planifikuar edhe shtigje për çiklistë dhe për këmbësorë	Hartimi i planit të mobilitetit për komunën e Klinës i realizuar	Vjetor	Komuna
		Pajisja e stacioneve të pompimit me pajisje për energji solare dhe transferim të të dhënave digjitale (GPRS).	Pajisjet e stacioneve të pompimit për energji solare të ndërtuara	Vjetor	Komuna
		Instalimi i Paneleve Solare në hapësirat e ndërtesave të Klinës: Sistemi PV dhe i Ngrohjes Solare	Cilësia e ajrit e përmirësuar	Vjetor	Komuna
		Instalimi i të gjithë infrastrukturës së nevojshme për monitorimin e cilësisë së ajrit	Pajisja me monitor për cilësinë e ajrit e realizuar	Vjetor	Komuna

		Hartimi i Planit të Veprimit për shfrytëzimin e potencialit për burime të ripërtërishme të energjisë, sidomos në zonat në Binxhë, Jashanicë, Siqevë, Dobërdol, Çabiq, Caravik, Zabërgjë Gjurgjevik i Madh, Nagllavë, Pjetërq i Poshtëm, Bokshiq, Qeskovë, Dollovë, Këpuz, Volljakë, Qupevë, Gremnik, Dush, Sferkë, Përçevë etj.	Hartimi i planit të veprimit i realizuar	Vjetor	Komuna
3.	<i>Reduktimi i zhurmës</i>	Identifikimi i zonave të zhurmës/ndotjes akustike dhe rekomandimeve për intervenim	Hartimi i hartës së zhurmës dhe listës së rekomandimeve i realizuar	Vjetor	Komuna DSHP
4.	<i>Ndryshimet klimatike</i>	Hartimi i planit lokal për energji dhe klimë	Plani lokal për energji dhe klimë i kompletuar	Vjetor	Komuna DSHP
5.	<i>Shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës dhe përmirësimi i cilësisë së dheut</i>	Programe trajnimi për fermerët dhe bujqit	Lista e trajnimeve të mbajtura	Vjetor	Komuna DBPZHR
		Program subvencionimi për investime në bujqësi, bujqësi intensive dhe blegtori	Dokumenti i hartuar i programit të subvencionimit	Vjetor	Komuna DBPZHR
		Krijimi i Databazës Bujqësore	Funksionalizimi i plotë i databazës	Vjetor	Komuna

		Hartimi dhe implementimi i masave adekuate për revitalizimin e ekosistemeve të degraduara	Hartimi dhe implementimi i masave për revitalizim të ekosistemeve i kompletuar	Vjetor	Komuna DUMM, DBZHPR
		Hartimi i projekteve për rehabilitim të zonave erozive dhe të vërshimeve	I realizuar	Vjetor	Komuna DUMM, DPBZHR
		Hartimi i projekteve për rehabilitim të zonave, vijave dhe pikave të zeza të ndotura	Hartimi dhe implementimi i projekteve të zonave erozive, pikave të ndotura	Vjetor	Komuna DSHP
		Krijimi i i një sistemi/platforme për monitorimin e mbrojtjes së Tokës Bujqësore (Kategoria I-IV) përmes respektimit rigoroz të kufijve të ndërtimit dhe parandalimit të ndërtimeve pa leje	Platforma e funksionalizuar	Vjetor	Komuna DI
		Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore	Hartimi i strategjisë dhe planit të Veprimit i realizuar	Vjetor	Komuna DBPZHR, MBPZHR

		Hartimi i Planit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Dëmeve nga Vërshimet	I realizuar	Vjetor	Komuna DSHP
		Mbrojtja e tokës bujqësore dhe definimi i zonave ndërtimore dhe zonave tjera që kanë një shkallë të mbrojtjes (trashëgimia kulturore dhe natyrore)	Moskalimi i kufijve ndërtimor	Vjetor	Komuna DUMM, DI
6.	<i>Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave</i>	Vendosja e kontejnerëve në të gjitha vendbanimet sipas kapaciteteve të nevojshme	Vendosja e kontejnerëve, e realizuar	Vjetor	Komuna, KRM-Ambienti
		Ri-organizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	Orari i ri , i organizuar	Vjetor	Komuna KRM
		Ndërtimi i pikës së transferit të mbeturinave	Funksionalizimi i pikës, i realizuar	Vjetor	Komuna KRM
		Riorganizimi i deponive egzistuese apo ndërtimi i deponive të reja për mbeturina inerte	Riorganizimi i deponive ekzistuese apo ndërtimi i deponive të reja	Vjetor	Komuna KRM Ambienti
		Trajtimi i mbetjeve ashtore të shtazëve	Trajtimi i realizuar	Vjetor	Komuna

		Pastrimi i 80% të sipërfaqes së tokës nga mbeturinat e ngurta, në baza vjetore	Pastrimi në baza vjetore i mbeturinave të ngurta, i realizuar	Vjetor	Komuna DBPZHR, MBPZHR
		Përdorimi i sistemeve të reciklimit në institucione publike dhe objekte të infrastrukturës sociale	I vazhdueshëm	Vjetor	Komuna
		Politika stimuluese dhe kampanja promovimi	Raport i punës mbi politikat dhe kampanjat, i realizuar	Vjetor	Komuna
7.	<i>Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit</i>	Identifikimi i hapësirave që duhet të rregullohen ose të rehabilitohen në zonat publike të Klinës, duke përfshirë rrugët, parqe, sheshet, dhe zona të tjera	Lista me lokacionet e hapësirave të identifikuara	Vjetor	Komuna DSHP
		Identifikimi i zonave potenciale për të krijuar hapësira të reja publike, siç janë parqet, qendrat komunitare, ose zonat e rekreacionit	Lista e lokacioneve të hapësirave të identifikuara	Vjetor	Komuna DSHP

		Melorizimi i sipërfaqeve pyjore (10-15 Ha)	Përfundimi i procesit të melorizimit	Vjetor	Komuna DBPZHR
		Identifikimi i vendgjuetive në territorin e komunës	Identifikimi dhe shënjimi i vendgjuetive	Vjetor	Komuna DBPZHR
		Ndërtimi i vendgjuetive	Vendosja e pajisjeve të nevojshme	Vjetor	Komuna DBPZHR
		Investime në infrastrukturë dhe kapacitete turistike	Irealizuar	Vjetor	Komuna DBPZHR
		Ripyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara pyjore	Përfundimi i procesit të ripyllëzimit	Vjetor	Komuna DBPZHR
		Promovimi i destinacioneve turistike	Promovimi i vazhdueshëm	Vjetor	Komuna

		Përkrahja dhe promovimi i sektorit të shërbimeve të ndërlidhura me turizmin	Përkrahje dhe promovim i vazhdueshëm	Vjetor	Komuna
		Përgatitja e broshurave dhe video-materialeve për promovim	Përkrahje dhe promovim i vazhdueshëm	Vjetor	Komuna, DUMM, MBPZHR, MMPHI
		Krijimi i Databazës Dixhitale të Aseteve Turistike dhe Potencialit Turistik	Krijimi i databazës i funksionalizuar	Vjetor	Komuna, MKRS
		Hartimi dhe implementimi i masave adekuate për mbrojtjen e florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës	Hartimi dhe publikimi i masave adekuate	Vjetor	Komuna
		Identifikimi, inventarizimi, caktimi i kufijve të mbrojtjes për asetet e trashëgimisë kulturore	Identifikimi, inventarizimi, caktimi i kufijve për mbrojtjen e asetëve të trashëgimisë kulturore	Vjetor	Komuna

		Hartimi i strategjisë komunale për mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore	Dokumenti i strategjisë komunale i kompletuar	Vjetor	Komuna
		Inventarizimi dhe Digjitalizimi i Inventarit të Trashëgimisë dhe Aseteve Kulturore dhe Natyrore për të gjithë territorin e Komunës së Klinës	I realizuar	Vjetor	Komuna
		Hartimi i Strategjisë së Integruar për Ruajtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore	Dokumenti i strategjisë komunale i kompletuar	Vjetor	Komuna
		Promovimi i vazhdueshëm dhe përkrahja e ndërmarrjeve turistike	I vazhdueshëm	Vjetor	Komuna

		Organizimi i fushatave sensibilizuese për ngritjen e vetëdijësimit në popullsi për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore	Ndërmarrja e fushatave sensibilizuese	Vjetor	Komuna
		Hulumtimi i monumenteve të natyrës për futje nën mbrojtje deri në vitin 2026	Dokumenti i strategjisë komunale i kompletuar	Vjetor	Komuna DUMM MMPHI IMMK
		Sinjalizimi i monumenteve të mbrojtura deri në vitin 2026	Sinjalizimi i monumenteve të mbrojtura i përfunduar	Vjetor	Komuna DUMM IMMK
		Hartimi i Strategjisë Komunale për Zhvillim të Turizmit të Qëndrueshëm	Dokumenti i strategjisë komunale i kompletuar	Vjetor	Komuna DKRS IMMK
		Mbrojtja e trashëgimisë natyrore, e peizazhit të hapur dhe pyjeve nga ndërtimet, shkatërrimet e mëtejme dhe eksplotimet e palejueshme.	Kompletimi i dokumentit të strategjisë komunale	Vjetor	Komuna MKRS IMMK

8.	<i>Rritja e vetëdijësimi dhe edukimit për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës</i>	Fushatë vetëdijësimi për mbrojtjen e ujërave	Publiku i vetëdijësuar për mbrojtjen e ujërave	Vjetor	Komuna
		Fushatë vetëdijësimi për mbrojtjen e mjedisit në shkolla të mesme dhe të ulëta	Nxënësit e vetëdijësuar për mbrojtjen e mjedisit	Vjetor	Komuna DKA
		Fushatë vetëdijësimi për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit	Publiku i vetëdijësuar për mbrojtjen e natyrës dhe diversitetit	Vjetor	Komuna
9.	<i>Fuqizimi i bashkëpunimit ndër institucional për mbrojtjen e mjedisit</i>	Ndarja e subvencioneve për organizatat e shoqërisë civile të sektorit të mjedisit	Projektet e organizatave të shoqërisë civile të zbatuara	Vjetor	Komuna
		Fuqizimi i zbatimit të VNM dhe VSM	Zbatimi i VSM dhe VNM në kuadër të planeve, programeve dhe projekteve komunale i fuqizuar	Vjetor	Komuna DUMM
		Fuqizimi i bashkëpunimit me gjykatat, prokurorinë dhe policinë e Kosovës për parandalimin e degradimit të mjedisit dhe natyrës	Bashkëpunimi me gjykatat, prokurorinë dhe policinë e Kosovës për parandalimin e degradimit të mjedisit dhe natyrës i fuqizuar	Vjetor	Komuna

10.	<i>Fuqizimi i kapaciteteve të komunës për mbrojtjen e mjedisit</i>	Rritja e numrit të inspektorëve të mjedisit	Inspektimi i mjedisit i fuqizuar	Vjetor	Komuna DI
		Rritja e buxhetit të komunës për mjedisin	Numri i projekteve të reja për mjedisin nga buxheti i komunës	Vjetor	Komuna
		Trajnimi i zyrtarëve të sektorit të mjedisit të komunës	Zyrtarët mjedisorë të komunës të trajnuar për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi	Vjetor	Komuna

9.Referencat dhe burimet e informacionit

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës (<https://askdata.rksgov.net/pxweb/sq/ASKdata/>)
- 2.AirQualityin Kosovo Air Quality Portal (rks-gov.net)
<http://www.kosovoairquality.com/secure/index2.html>.
3. ASK 2022, Vjetari Statistikor 2021
4. Raporti për gjendjen e natyrës 2010-2014, AMMK
5. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/>)
6. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 për komunën e Klinës
7. Ligji (2009/03-L-025) për Mjedis
8. Ligji nr. 02 / L-102 për mbrojtjen nga zhurma
9. Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale

10. Ligji nr.08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
11. Ligji nr. 03/L-233 mbi mbrojtjen e natyrës
12. Ligji nr. 08/L-250 për ndryshime klimatike
13. Ligji nr.03/L-153 për pyjet e Kosovës
14. Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës
15. Lista e Trashëgimisë kulturore për mbrojtje të Përkohshme Nr.110/2018 dhe Lista e TK për mbrojtje të Përhershme Nr.69/2016
16. Vlerat e Trashëgimisë Natyrore të Kosovës, MMPH/IKMN
17. Ndotja e ajrit në Kosovë, Masat dhe instrumentet e politikave të propozuara për të reduktuar ndotjen në sektorët kyç, AMMK, SEPA, IVL, 2023
18. Plani Hapësinor -Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Ujëvarat e Mirushës” 2013
19. Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë 2019-2021 për Komunën e Klinës
20. Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, Komuna e Klinës
21. Plani Regjional i Trashëgimisë 2012-2015 (Pejë, Klinë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë)
22. Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Klinës
23. Projekti për zhvillimin e kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës, MMPH/JICA
24. Projekti, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Cilësinë e Ajrit, ndryshimit të sjelljes dhe shërbimet e komunikimit: Azhurnimi i inventarit të emisioneve, MFK & AMMK 2021
25. Raport - Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorit në gjendjen mjedisore të lumenjve, AMMK 2022

26. Raport Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2021, AMMK 2022
27. Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2021, AMMK
28. Raporti i hotspoteve në Kosovë 2012
29. Raporti i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë për vitin 2020, AMMK 2021
30. Raporti i Performancës së KRU-2022, ARRU.
31. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Klinës 2010-2015
32. Raporti për gjendjen e mbeturinave komunale 2021, AMMK
33. Raporti për Gjendjen e Ujërave 2020, AMMK
34. Raporti Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2022, AMMK
35. Regjistrimi i Bujqësisë 2014, ASK
36. Regjistrimi i Popullsisë 2011, ASK
37. Sektori i biomasës drunore në Kosovë, Vështrim i integruar mbi kërkesën dhe ofertën për drurin si lëndë djegëse, FAO 2015
38. Statuti i Komunës së Klinës
39. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Klinës
40. Studimi i Ndotjes së Tokës Bujqësore (SNTB) në Kosovë, MMPH/GIZ 2015
41. Vlerësim, Popullsia e Kosovës, ASK 2021

**Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

REPUBLICA KOSOVA

08, 01, 2025

Njësia org. Unit Organ. Jed.	Numri Number	Shënimi Note

02-052-1034/25

**RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË KONSULTIMIT
PUBLIK PËR RREGULLOREN PËR TRANSPARENCË
TË KOMUNËS SË KLINËS DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR
TRANSPARENCË KOMUNALE 2025 – 2029**

Janar, 2025

HYRJE

Rregullorja për Transparencë e Komunës së Klinës përcakton rregullat që sigurojnë transparencë të punës së organeve komunale, kryetarit të komunës, drejtorive, kuvendit, trupave të kuvendit si dhe mekanizmave të tjerë ligjor, si dhe rregullat, parimet dhe format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha organet e komunës që ushtrojnë autorizime publike sipas ligjit.

Transparenca është veprimtari e hapur e organeve të komunës që siguron publikim, informim, qasje në dokumente publike dhe përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe punës së organeve komunale.

Më këtë rregullore parashihet edhe transparenca e punës së Kuvendit të Komunës, Informimi për mbledhjet e kuvendit dhe komiteteve, monitorimit elektronik i mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave, përdorimi dhe mirëmbajtja e sistemit të Teleprezencës, njoftimi për mbledhjet e Kuvendeve të Komunave për monitorim elektronik, pastaj parashihet edhe transparenca e ekzekutivit me publikimi i akteve të Komunës, publikimi i dokumenteve zyrtare dhe të tjera.

Plani i Veprimit për transparencë synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale llogaridhënëse dhe transparente, të hapur për qytetarë dhe shoqërinë civile në të gjitha proceset vendimmarrëse. Përmes Planit, do të promovohet koncepti i demokracisë së drejtpërdrejtë lokale, në mënyrë që politikëbërja të bazohet në argumente, fakte dhe të dhëna reale. Plani është dokument strategjik komunal, i hartuar në pajtim me orientimet e përcaktuara nga Strategjinë për Vetëqeverisje lokale dhe aktet juridike përcjellëse të nivelit qendror që promovojnë qeverisjen transparente.

Plani i Veprimit për Transparencë Komunale ka për qëllim t'i ofrojnë publikut qasje të lehtë në monitorimin dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikim të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Llogaridhënia dhe transparenca janë parime që përtej informimit, synojnë mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes komunale. Për këtë arsye, zotohemi që Komuna e Klinës me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin do të rris gatishmërinë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha kërkesave të qytetarëve për të qenë të angazhuar aktivisht në planifikimin dhe zhvillimin e politikave, për të siguruar që efektet e zbatimit të tyre të japin rezultatet e dëshiruara dhe afektojnë direkt interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

ECURIA E PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK PËR TRANSPARENCË TË KOMUNËS SË KLINËS DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË KOMUNALE 2025 – 2029

Kryetari i Komunës së Klinës në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës (Iniciuesi apo propozuesi i aktit), si dhe Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, duke respektuar UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MAPL) NR.04/2023 PËR ADMINISTRATË TË HAPUR NË KOMUNË, më vendim më numër protokolli 01 Nr. 030-35661/24, të datës 28.10.2024, kanë caktuar grupin punues në përbërje prej dhjetë të anëtarëve:

1. Vlora Tafili, Zyra për Informim, kryesuese,
2. Samije Gjergjaj, Zyra për Informim, anëtare,
3. Ahmet Berisha, Zyra për Punë të Kuvendit, anëtarë,
4. Labinot Morina, Zyra e Prokurimit Publik, anëtarë,
5. Rexhep Gashi, Inspektor, anëtarë,
6. Vitore Shala, Zyra për Barazi Gjinore, anëtare,
7. Antonije Selmanaj, Zyrtare e lartë për projekte, anëtare,
8. Adnan Zeneli, Zyrtar për Tatim në Pronë, anëtarë,
9. Rexhep Sejdiu, Zyrtar i lart në Arsim, anëtarë,
10. Vitore Zefi, Drejtoreshë në Qendrën Rinore “Ardhmëria”, anëtare.

